



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 3 TETOR 2017**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 03. OKTOBRA 2017. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2017**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare,
5. Interpelanca e kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP të LDK-së për ta informuar Kuvendin mbi akuzat publike të shfaqura ndaj ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikalo.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajane zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Razmatranje predloga-odluke o formiranju parlamentarnih komisija,
5. Interpelacija premijera, Ramush Haradinaj, na zahtev PG LDK-a, u cilju informisanja Skupštine o javnim optužbama prema ministru za poljoprivredu, šumarstvo i ruralni razvoj, Nenad Rikalo.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2017.

Në sallë janë të pranishëm 59 deputetë aktualisht, mund të vazhdojmë seancën.

Të nderuar kolegë,

Më lejoni, para se të fillojmë seancën plenare, do të kemi në dy raste nga një minutë heshtje.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Në shenjë nderimi edhe respekti kërkoj që të mbajmë një minutë heshtje për viktimat e krimit në Las Vegas, ku humbën jetën dhjetëra qytetarë amerikanë dhe u plagosën qindra të tjerë.

Me këtë rast shprehim dhimbjen dhe solidaritetin me familjet e viktimave dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, aleatit dhe mikut tonë më të mirë në botë.

Ju lus për një minutë heshtje, të ngrihemi në këmbë!

(Një minutë heshtje)

Nderim!

Kolegë të nderuar,

Do të mbajmë edhe një minutë heshtje. Dje u nda nga jeta albanologu i njohur kanadez, Robert Elsie. Elsie dha një kontribut shumë të madh në njohjen e gjuhës, kulturës, historisë shqiptare nëpër botë, me hulumtimet e tij shkencore. Ai na ka ndihmuar edhe vetë ne si komb që ta njohim më mirë veten tonë.

Në botën e shkencës ne kemi humbur një mik të madh të kulturës.

Ju ftoj që të mbajmë një minutë heshtje në nderim të tij.

(Një minutë heshtje)

Nderim!

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentare zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Ndërkohë, me aq sa di unë, kolegët deputetë kanë marrë kartela. Mexhide Mjaku- Topalli është lajmëruar. Urdhëro, zonja Topalli!

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Temën të cilën do ta trajtoj sot ka të bëjë me shëndetësinë.

Ministrin e Shëndetësisë e kemi këtu, lirisht mund të them se ka marrë në udhëheqje një ministri dhe po punon me përkushtim. E përgëzoj ministrin për tërë angazhimin që po e bën përpos brenda institucionit, po ashtu edhe në terren.

Të nderuar deputetë,

Një tetori shënon hapjen e fushatës ndërgjegjësuese të luftës kundër kancerit të gjirit.

Në këtë muaj operatorët e shumtë nga fushat e shëndetit bëhen pjesë e veprimtarive që kanë në qendër rritjen e ndërgjegjes së shoqërisë për kontrollin dhe parandalim e kësaj sëmundjeje.

Studentët e Fakultetit të Mjekësisë duhet të jenë pjesë aktive e këtyre aktiviteteve, ku secili do të duhej të shpalosë aftësitë e tij, të trajtojë me përgjegjësi pyetjet nga të pranishmit dhe kjo përvojë do të jetë e një rëndësie të veçantë.

Viteve të fundit kanceri i gjirit vazhdon të jetë si vrasës i madh në popullatë dhe është tepër shqetësuese, sepse shtimi i rasteve po konstatohet edhe te moshat e reja, nga mosha 25 deri 45 vjeç. Kjo sëmundje prek një në dhjetë gra.

Ndërgjegjësimi dhe parandalimi janë dy fjalët kyçe, të cilat lidhen ngushtë me faktor rrezikues, sepse kanceri i gjirit nuk është sëmundje që nuk më prek mua apo familjarët e mi. Përkundrazi, është një ndër patologjitë që prek një numër të madh grash. Andaj, me një kontroll periodike dhe diagnostikim sa më të hershëm, do të jetë më i lehtë procesi i kurimit.

Opinionet e grave pse nuk i realizojmë kontrollet në kohë, që i dëgjojmë shpeshherë janë: frikë nga diagnoza, mendimi i stereotipeve se nuk mund të më ndodhë mua, mosnjohje me faktorët rrezikues, mungesa e vlerësimit të simptomave në kohën kur shfaqet, e të tjerë.

Të mos e harrojmë edhe një fakt, se shëndeti ynë është i varur edhe nga mjedisi ku jetojmë, e një gjë të tillë e dimë se disa forma të shkatërrimit të mjedisit rrisin rrezikun për shëndetin, ndaj edhe mbrojtja e mjedisit duhet të bëjë pjesë në programet e mjekësisë parandaluese.

Pikërisht për këtë arsye kanceri i gjirit si dhe mjaft sëmundje të tjera kanë nevojë për një trajtim të kombinuar të profesionistëve nga disa fusha.

Qëllimi i ngritjes i kësaj çështjeje në Kuvend është që të shpërndajë informacionin për shëndetin dhe të rrisë ndërgjegjësimin për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit te grat dhe vajzat në gjithë botën.

Në fund do ta përmbyllja fjalimin tim me një fjali, duke i ardhur në ndihmë një gruaje që preket nga kjo sëmundje, i kemi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kolege deputete, në fillim, edhe kolegë të tjerë, kërkoni fjalën, në qoftë se e kërkon në emër të grupit parlamentar, janë pesë minuta, nuk e di a ke në emër të grupit apo në emrin tuaj, tre minuta.

Kemi kështu, Korab Sejdiu, LDK, Dardan Molliqaj, Lëvizja “Vetëvendosje”, po shkoj me radhë, Faton Topalli, Lëvizja “Vetëvendosje”, Bilall Sherifi, “Nisma”, Flora Brovina, PDK, Ahmet Isufi, AAK, Shkumbim Demaliaj, AAK, Bekim Haxhiu, PDK, bëj edhe pak kombinime në bazë të partive.

Atëherë Korab Sejdiu, pastaj le të bëhet gati Dardan Molliqaj.

KORAB SEJDIU: Të nderuar kolegë,

Një prej pikave në platformën me të cilën kam garuar si deputet ka qenë edhe qasja e qytetarëve në drejtësi dhe një problem shumë i madh sa herë që po ndërrohet administrata te ne është çështja e ngarkimit dhe e shkarkimit të stafit civil, emërimi dhe shkarkimi nëpër borde, e kështu me radhë.

Kohë më parë kishte edhe një shkarkim të disa personave nga bordet publike që unë pajtohem plotësisht që është një problematikë e veçantë në Republikën e Kosovës, ku emërimet bëhen

pothuajse në mënyrë të pastër në baza politike, jo në bazë profesionale ose edhe çështje të tjera, ndërlidhja sa i përket shkathtësive të menaxhmentit.

Por, njëkohësisht si tek emërimet, ashtu edhe te shkarkimet, veçanërisht me vendimin e Qeverisë, me të cilën janë shkarkuar, duhet të kihet parasysh edhe legjislacioni përkatës, pra të respektohen procedurat si në emërimet, ashtu edhe në shkarkime.

Lidhur me këtë vendimin në fjalë kemi pasur edhe reagimin e shoqërisë civile, ku edhe ata potencojnë që është bërë në kundërshtim me ligjin dhe, në fakt, ka pasur edhe ndërhyrje në kompetenca të këtij institucioni kur Qeveria ka shkarkuar të emëruarit në bordin e KOST-it.

Kështu që qëllimi im sot është që të inkurajohet kjo Qeveri që pikë së pari të respektojë në përpikëri çështjen e zbatimit të ligjit dhe procedurave, ndërsa për palët e dëmtuara, në këtë rast, i kisha inkurajuar që të shfrytëzojnë mjetet juridike, pasi që çfarëdo vendimi, qoftë i Qeverisë, qoftë i ndonjë organi tjetër të Administratës Publike që është në kundërshtim me ligjin, në qoftë se shfrytëzohen mjetet juridike, atëherë gjyqësori është dashur t'i shpallë ato absolutisht të pavlefshme.

Kështu që kjo ishte qëllimi i prononcimit tim me një inkurajim të fuqishëm që të mos fillohet dhe të mos vazhdohet me praktikën e deritanishme që të shfrytëzojmë militantizmin për mbushjen e bordeve, por në fakt, të fillojmë ta kthjellim pak edhe administratën, edhe e bordet publike. Faleminderit!

KRYETARI: Dardan Molliqaj e ka fjalën, le të bëhet gati Ahmet Isufi, në emër të grupit.

DARDAN MOLLIQAJ: Të dashur qytetarë,

Të nderuar deputetë të pranishëm në këtë seancë,

Më 29 gusht 2016, Adeja Batusha, Patrit Ademi, Astrit Dehari, Frashër Krasniqi, Atdhe Arifi dhe Egzon Halitaj ishin arrestuar me dyshimin për vepër terroriste, përkatësisht sulm ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Janë bërë më shumë se një vit, ku këta aktivistë janë mbajtur në paraburgime dhe arreste shtëpiake, pa asnjë dëshmi dhe pa asnjë provë, dhe procesi ndaj tyre po vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Si rezultat i një vepre krejtësisht të montuar, të cilën e kishim deklaruar me kohë, e që tash po vërtetohet nga të gjitha instancat vendore dhe ndërkombëtare, kemi humbjen e jetës së aktivistit Astrit Dehari.

Edhe përkundër faktit që Kuvendi i Republikës ka marrë një vendim që të ketë një hetim të jashtëm për këtë rast, Qeveria e kaluar nuk e realizoi një gjë të tillë, përkatësisht ish-ministrja Hoxha nuk e bëri një veprim të tillë, nuk e respektoi një vendim të Kuvendit të Kosovës me një arsyetim, për mua, aspak të qëndrueshëm, i cili thoshte që ekspertiza duhet të vijë nga vendi i Bashkimit Evropian. Me gjasë, për aq sa e kam përcjellë këtë rast, ky vendim ishte bërë për ta përjashtuar Shqipërinë nga një ekspertizë dhe sugjerimi i familjes Dehari dhe avokatit të familjes Dehari, zoti Tomë Gashi, ishte për një ekspertizë nga Zvicra, nga instituti i cili kishte bërë ekspertiza për vende shumë të rëndësishme dhe shumë vende problematike të rasteve të dyshimta të vrasjeve dhe kjo Qeveri, përkatësisht ajo e kaluara nuk bëri një veprim të tillë.

Lëvizja “Vetëvendosje”, aktivistët e saj, familja Dehari, qytetarët e Republikës së Kosovës presin veprim të menjëhershëm të kësaj Qeverie për të zbardhur një rast, i cili është skandaloz dhe i cili nuk po merr epilogun e duhur për shkak se ka pasur dhe ka ende qëllime politike mbrapa saj.

Duhet të dalë te shkasi për të cilën nuk e kam marrë fjalën sot, në emër të Grupit Parlamentar, për të ngritur këtë rast këtu. Ka të bëjë me provat dhe përgjegjësit e këtij rasti.

Siç e dini të gjithë, forenzika, në bazë të krejt materialeve që i ka trajtuar, ka treguar në raportin përfundimtar që asnjë e dhënë e aktivistëve tanë të akuzuar nuk përputhen me të dhënat që janë gjetur në rastin kur është bërë sulmi i Kuvendit.

Tutje, tash së fundi, ashtu si të gjithë ju e keni parë, edhe raporti i FBI-së, pas kërkesës së shtetit të Kosovës drejtuar saj, ka ardhur përfundimisht me një raport të saktë, i cili thotë: “Asnjë imazh i gjetur në kamerat, të cilat i ka ofruar prokuroria dhe njësi antiterror nuk përputhet me asnjë prej njerëzve që janë të dyshuar”, që përkatësisht për neve janë aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Një vit paraburgim, arreste shtëpiake, persekutime të komplet Lëvizjes “Vetëvendosje”, një rast që e kemi humbur një aktivist si Astrit Dehari, krejt këto institucione dëshmojnë që nuk ka asgjë në këtë çështje dhe vazhdon shteti, përkatësisht drejtësia në Kosovë, e kapur nga klani “Pronto”, të mos veprojnë, Qeveria e Kosovës nuk vepron.

Dhe, krejt në fund, për të gjithë ju që keni folur në këtë Kuvend për këtë çështje pres kërkimfalje ndaj aktivistëve tanë, pres kërkimfalje ndaj familjes Dehari dhe pres kërkimfalje ndaj Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe qytetarëve të saj, sepse e keni keqpërdorur një rast, për të cilin qysh në ditën e parë ju kemi thanë që s’ka asnjë provë, asnjë dëshmi dhe kështu po del. Nuk po e themi ne, po e thonë institucionet të cilat ju i keni kapur dhe po thonë institucionet ndërkombëtare, të cilat ju keni bërë kërkesë.

Krejt në fund, të gjithë dëshmitarët që ju i keni sajuar në këtë proces, gjatë procesit të gjykimit, të gjithë këta dëshmitarë njëzëri kanë deklaruar që kanë qenë të ndikuar dhe të urdhëruar nga Policia e Kosovës për të dhënë deklarata të tilla. Kjo nuk është fjalë që unë po e them, ju lutem, kërkonte procesverbalin e seancave të gjykimit dhe e shihni çka ka ndodhur.

Agjencitë, në këtë rast policia antiterror e ka montuar këtë rast me urdhër politik, për të cilin ata duhet të japin përgjegjësi.

A e dini që dëshmitari, i cili ka thënë se e ka shitur motorin nuk i ka identifikuar aktivistët tanë. Ka thënë se nuk mund t'i identifikojë, se nuk e di nëse janë aktivistë, madje nuk e ka identifikuar fare Astrit Deharin dhe përgjegjësinë për këtë do ta mbajnë të gjitha institucionet përgjegjëse, po edhe ju si krerë politik të këtyre organeve, të cilët e keni inskenuar këtë rast.

Pres që kjo Qeveri në kohë rekord, brenda javës, të lëshojë vendimin për të ardhur hetues ndërkombëtarë për rastin Astrit Dehari. Faleminderit!

KRYETARI: Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar.

AHMET ISUFI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kam fjalën për shprehjen e shqetësimit të qytetarëve të Anamoravës, Karadakut, Gollakut që është lënë pas dore, është lënë si "zorrë qorre" për Kosovën, për shkak se kemi të bëjmë me investime shumë të pakta të qeverive të kaluara.

Në këtë mandat konsideroj se është obligim i kësaj Qeverie që Kosovën ta shohin si një territor të tërë dhe të investojnë atje ku kanë nevojë qytetarët e Kosovës, e në veçanti në këtë pjesë që e kanë lënë të prapambetur.

Po ashtu, kërkesë jona është që autostrada, e cila tashmë është e paraparë të kalojë në atë zonë për t'i bashkuar edhe qytetarët, bashkëkombësit tanë në Bujanovc, Preshevë e Medvegje, bëjnë lidhjen dhe lëvizjen më të lirë të qytetarëve të asaj pjese.

Po ashtu kërkojmë që shtetasit, të cilët ende kanë mbetur pa shtetësinë në territorin e Kosovës, të larguar nga pjesa e territorit lindor, duhet të ketë angazhim të Qeverisë, në mënyrë që atyre t'u takojë statusi dhe shtetësia e barabartë me qytetarët e Kosovës.

Njëkohësisht është kërkesë e banorëve atje që të hapen dy pikëkalime kufitare, të cilat janë në Sfirçë që lidh popullatën me Medvegjen dhe po ashtu hapja e pikës kufitare në pjesën me

Kumanovën, ku lidhet, në mënyrë që të ketë një komunikim të drejtpërdrejtë të qytetarëve matanë dhe këndeje kufirit.

Prandaj, konsideroj se është obligim i kësaj Qeverie, me të gjitha investimet kapitale të drejtohet në këtë regjion, i cili vërtet nuk ka pasur një qasje të mirë nga qeveritë e kaluara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, nga “Nisma”, në emër të Grupit Parlamentar.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje, të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Zoti kryetar,

Duke pasur parasysh faktin se kjo pikë e rendit të ditës ka të bëjë me çështje të cilat nuk mund të hyjnë në rend të ditës dhe shqetësimet të cilat janë, megjithatë po e diskutoj shkurt, ndoshta ju të gjithë e dini që ...

KRYETARI: Më vjen keq, po u vërejt edhe tek unë, është problem teknik, sigurisht. Vazhdo, zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Më duket se u rregullua tash.

Duke pasur parasysh faktin tani po shkojmë drejt muajve të ftoftë, muajve të dimrit, një shqetësim për siguri, sidomos të fëmijëve dhe të njerëzve të moshuar, është shndërruar shumimi i pakontrolluar i qenve endacakë, është bërë një problem vërtet shumë serioz.

Duke pasur parasysh faktin që po hyjmë në muajt e ftoftë duhet të ndërmerren masa që kjo çështje të vihet nën kontroll. Janë lënë komunat në një mënyrë që me mundësitë e vogla, me kapacitetet e vogla që i kanë ta menaxhojnë këtë problem, të merren me këtë problem.

Mendoj që edhe ky Kuvend, edhe Qeveria e Kosovës e ka për detyrë që para se të kenë humbur jetë fëmijëve, jetë pleqve, jetë njerëzve, të merren masa që kjo çështje të vihet në kontroll.

Unë i kuptoj njerëzit që ecin me vetura, madje edhe të blinduara, që nuk u duket ky problem, po hyni pak në lëkurën e njerëzve, të cilët ecin këmbë nëpër Prishtinë e nëpër qytete të tjera të Kosovës, nëpër fshatra, se dikur qen endacakë kemi pasur vetëm nëpër qytete, tash kemi edhe nëpër fshatra.

T’i kuptojmë problemet që i kanë njerëzit e thjeshtë, njerëzit e zakonshëm në këtë vend, të cilët nuk mund të mbrohen nga ta, për arsye se kanë nevoja të përditshme për të dalë në rrugë, të shkojnë në shkollë, te mjeku, në shitore, gjithkund tjetër.

Mendoj që është urgjente para se të hyjmë në muajt e ftohtë, ku ata pastaj bëhen edhe më agresivë, që të ndërmerren masa, një plan edhe Qeveria, nëse ka nevojë edhe ligji shpejt të amendamentohet që të trajtojë këtë çështje në bashkëpunim me të gjitha grupet e interesit, sidomos shoqatat që mbrojnë të drejtat e kafshëve, të bëhet një amendamentim adekuat me rrethanat në të cilat gjendemi, sepse sado që jemi për respektim të normave, standardeve evropiane, jeta e njeriut megjithatë ka prioritet.

Mendoj që kjo shoqëri duhet të ketë kapacitete që së paku nga invadimi i qenve endacakë të mbrohet, nëse jo nga invadime të tjera.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Emilija Rexhepi, pa grup parlamentar.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedniče Parlamenta!

Poštovani premijeru naše države,

Uvaženi ministri,

Poštovani kolege poslanici,

Pre nego što dam moju sugestiju za Ministarstvu Infrastrukture, želim da se zahvalim našem premijeru na pristupu i položaju manjinskih zajednica u ovoj novoj Vladi na prostoru kojeg nam je dat, manjinske zajednice su ustavne kategorije. Mi imamo zakonske regulative koje se odnose na prava i zaštitu svih manjinskih zajednica u ovom parlamentu i prosto, i juče što je od nekih poslanika ovde sa ovom govornicom iznešeno je za svaki vid uvredljivo, ponižavajuće, jer mi smo ustavne kategorije, živeli smo, živjećemo sa svima ovde zajedno, deleći sve probleme i izazove sa kojima se naša država suočava.

Međutim, ne dozvoljavamo vređanja na nacionalnoj osnovi, ne dozvoljavamo vređanje jezikom sa kojim mi koristimo, ali pre svega želim da uputim još jednu pozitivnoj, odnosno pozitivizam našem premijeru za našu buduću opštinu Rečane, zato što je uvrćena u paketu sa svim drugim Albanskim budućim opštinama koji će doći u paketu na glasanje u ovom parlamentu.

Ono što ja bih želela da isteknem kao goruči problem Bošnjačke zajednice poštovani ministre za infrastrukturu, jeste regionalni put Prizren-Rečane-Prevelac, nailazi zimski period i mi se suočavamo sa velikim problemima sa sigurnošću i bezbednosnom stanju svih naših stanovnika koji putuju oko 15 okolnih sela su u opštini Prizren i dolaze i koriste taj regionalni put i pripadnici drugih zajednica, odnosno pripadnici drugih država svih naših građani tako da svih onih koji su se kitili sa onim projektom tunela milionskom cifrom na prošlim izborima, znam da Ministarstvo za Infrastrukturu ima samo 200 hiljada obezbeđenih finansijskih sredstava, želim da ih demantujem, a apelujem na ministra da utiče sa svojom razvojnom politikom da u što skorijem vremenskom periodu obezbedi veću sumu novca i zajedno sa opštinom Prizren radimo na tom projektu. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Danush Ademi, le të bëhet gati Zenun Pajaziti, Faton Topalli dhe Shkumbin, nuk di a mund të arrijmë deri te ti se jemi gati kah fundi.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Desha ta ngre një shqetësim, para se të bëhet vonë.

Në vitet e kaluara të gjithë kemi qenë të njoftuar, edhe deputetët, edhe ish-ministrat, sepse në disa komuna kemi pasur raste shumë të rënda, kemi pasur fëmijë që kanë vdekur edhe nga të ftohtit.

Po në këtë Kuvend unë e kam ngritur një shqetësim për ndërtimin e shtëpive për ato familje, e vazhdimisht i njëjtë shqetësim përsëritet, ne jemi duke pritur edhe këtë vit.

Kërkesa ime nga kjo Qeveri e re është që ta ketë parasysh tash me kohë, të mos na përsëriten prapë ato raste, të cilat kanë nevojë, veç kanë filluar muajt e dimrit dhe kërkojmë që së paku t'i ketë parasysh ato familje, të cilët gëzojnë asistencë sociale, të ndihmohen me kohë, sepse me të vërtetë kemi një shqetësim nga ata dhe ata vazhdimisht trokasin në zyrat tona dhe kërkojnë ndihmë po nga tash. Edhe pse shumë shpejt do të kemi rishikimin e buxhetit, kërkoj nga të gjitha ministrat që të jenë të njoftuara me kohë, sepse familjet e varfra, të cilët ne i përfaqësojmë, të komunitetit tonë ashkali si dhe të tjerët, të marrin një mbështetje me kohë jo kur të vijë buxheti për votim të kalohet sa më shpejt.

Ne kemi dorëzuar po në këtë Kuvend projektin, i cili ka qenë urgjentisht për 150 shtëpi për komunitetin ashkali që unë i përfaqësoj. Ai nuk e kishte marrë miratimin nga ky Kuvend për disa vota, ku e njëjta kërkesë prapë do të përsëritet, sepse qytetarët tanë kanë nevojë, do ta bie edhe një incizim që ta lëshojmë këtu në këto kamera dhe të gjithë ta shohin se si jeton komuniteti ynë dhe me çka merremi ne për çdo ditë, sepse kërkesa ndoshta është e tepërt e vazhdimisht ne e përsërisim.

Kërkoj nga të gjitha grupet parlamentare që urgjentisht ta bëjmë një vizitë nëpër komunitete dhe ta shikojmë me çka ballafaqohet komuniteti ynë në të gjitha komunat.

Unë mendoj që Ministria e Kthimit, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale si dhe të gjitha ministrat e kanë obligim që një herë e përgjithmonë ta ndihmojmë këtë shtresë të ulët, sepse për çdo vit përsëritet e njëjta kërkesë, por asgjë nuk po kemi mundësi të bëjmë.

Unë mendoj që edhe kryeministri do ta ketë parasysh shqetësimin tonë, sepse me të vërtetë është kërkesë që ka nevojë komuniteti ynë, sidomos për ndërtim dhe të ndihmohen në këto raste tash ato familje të cilët kanë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Më vjen keq. Fjala për Faton Topalli, le të përgatitet Zenun Pajaziti. Faton, t'i nuk e përcakton rregullin, a do ta marrësh fjalën a jo? Salih Salihu.

SALIH SALIHU: Faleminderit!

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dua të ngre një shqetësim të qytetarëve të komunës së Vitisë, të cilët po ndihen të diskriminuar nga Qeveria qendrore.

Komuna e Vitisë vazhdimisht nga secila Qeveri që nga paslufta është lënë anash pa u përfshirë në asnjë projekt të rëndësishëm kapital.

Së fundit, padrejtësia më e madhe që po u bëhet qytetarëve të Vitisë është mospërfshirja e komunës së Vitisë në projektin e autostradës "Arben Xhaferi" Prishtinë-Hani i Elezit.

Me këtë projekt komuna e Vitisë edhe nga Qeveria e mëparshme, edhe nga Qeveria e fundit e Isa Mustafës u diskriminua dy herë.

Diskriminimi i parë ishte se komuna e Vitisë nuk u përfshi fare nga autostrada, pra autostrada nuk preku fare territorin e komunës së Vitisë që të jetë më afër qytetarëve të saj dhe tash po diskriminohet për së dyti herë, ku Vitia nuk ka kycje, madje as në pikën më të afërt në Gërlicë, që i bie me territorin e komunës së Ferizajt.

Po qytetarët e saj për të kyçur në autostradë duhet shkuar edhe 5 kilometra larg në drejtim të Kaçanikut, për të kthyer mandej për Prishtinë.

Këtë problem e kam ngritur vazhdimisht mbi pesë herë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke iu drejtuar ish-ministrit të Infrastrukturës, zotit Zharku dhe ish- kryeministrit, zotit Mustafa, por ata nuk patën vullnet të bëjnë këtë gjë, duke u përgjigjur vazhdimisht me fjalët se do ta shqyrtojmë mundësinë.

Tani punimet në pikën e Gërlicës gati janë përfunduar dhe shihet qartë se Vitia nuk ka kycje në Gërlicë.

Prandaj, i bëj thirrje qeverisë aktuale që urgjentisht të marrë për bazë shqetësimet e qytetarëve të Vitisë dhe të fillojë puna për t'i realizuar kycje komunës së Vitisë në pikën më të afërt, në fshatin Gërlicë.

Komuna e Vitisë nuk është një vendbanim i vogël, por është një qytet që ka rreth 40 fshatra përreth, ka rreth 60 mijë banorë, ka rreth 8 mijë automjete të lehta dhe të rënda, pronarët e të

cilave paguajnë taksa për buxhetin e Republikës së Kosovës, prandaj edhe ata me të drejtë duan të jenë të barabartë me të gjithë qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zenun Pajaziti e ka fjalën.

Zonja Hykmete, nuk e ka përmendur emrin tënd, veç në qoftë se nuk e kam dëgjuar. Salih, a e ke përmendur emrin e zonjës Hykmete? Vazhdo, edhe nuk ka të drejtë në replikë. Jo, të keni parasysh, kur përmendët emri, do të bëj shkelje të Rregullores, për arsye se po përdoret kjo për ta sulmuar tjetrin. Do t'ia jap fjalën, edhe atij që përmendet gjithmonë. Do ta thyej Rregulloren me vetëdije të plotë, publikisht po e them. Sa herë i përmendet emri dikujt, të njëjtit do t'ia jap fjalën që t'i kundërvihet po pati guxim.

Urdhëro, Zenun Pajaziti, fjala për ju!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit!

Nëse do të vazhdoja si parafolësit e mi, normalisht që ishte dashur të vazhdoja për punën e fushatës, por mendoj që po flas për një çështje që ka të bëjë me etikën, e që pikërisht do të duhej të mos bëhej kjo, të mos shfrytëzohet foltorja e Parlamentit për fushatë elektorale.

Sot mua personalisht ma ndreqi këtë punë Ahmet Isufi, faleminderit, Ahmet, është një zë i mirë për Gjilanin që ka ardhur në Kuvend, besoj që do të punojmë bashkë në atë drejtim.

Unë dëshiroj të shtroj një çështje, në mandatin e kaluar kam qenë koordinator i një grupi joformal në Parlament për transparencë parlamentare dhe kemi bërë disa punë në bashkëpunim me NDI-në, OSBE-në dhe të tjerët. Kemi nxjerrë një propozim që ka të bëjë me etikën, me kodin e etikës.

Mendoj, zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Që është mirë urgjentisht të ndërrohet Rregullorja e Punës së Kuvendit ose brenda kësaj Rregulloreje të miratohet një kod i veçantë për etikën.

Ne nuk mund të sillemi indiferent me krejt çka ka ndodhur që një vit në Parlament, me sjelljet dhe gjuhën parlamentare. Kjo që ka ndodhur ose po ndodh edhe këto ditë po ashtu nuk mund të na bëjë indiferent. Kurrë më keq nuk ka qenë imazhi i politikanëve në Kosovë, ne duhet të kujdesemi të gjithë njëjtë, barabartë për këtë çështje. Kemi përgjegjësi para qytetarëve dhe mendoj që duhet të ndalen këto.

Nuk jam prej njerëzve pesimistë, por nuk po shoh ditë të mirë në këtë drejtim për të gjithë ata që mendojnë që me dhunë t'i qërojnë hesapet dhe të ndajnë drejtësinë në këtë vend.

Po ashtu dëshiroj të mos e lë pa e theksuar atë që e dëgjova këtu për një çështje të drejtësisë nga kolegu i “Vetëvendosjes”. Po vazhdon, po si sot kurrë më parë, është atakuar drejtësia. Kërkoj nga ministria e Drejtësisë dhe nga institucionet e Drejtësisë, e di që ka kompetenca të kufizuara, por ministri duhet të jetë një lloj arbitri mes kësaj çka po ndodh në Parlament edhe nga ajo që duhet të ndodhë atje ku duhet të ndahet drejtësia.

Sot nuk kemi dhënë mesazh të mirë, sa më shpejt institucionet përgjegjëse duhet të japin informata më të mira për këtë rast dhe për raste të tjera. Nuk mund të lejojmë të abuzohet kaq rëndë me drejtësinë në këtë vend, nuk ndahet drejtësia në Parlament, drejtësia ndahet nga institucionet që ne u kemi dhënë përgjegjësinë dhe këto përgjegjësi janë të ndara.

Besoni, nëse vazhdohet kështu, vendi nuk do të shohë ditë më të mirë. Unë i lus deputetët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ahmet, ta ka përmendur emrin, e kam dëgjuar. A ka përmendur emra të tjerë, kolegë deputetë? Atëherë dalim prej kësaj pike.

Ahmet, ta ka përmendur emrin, a do të flasësh?

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Unë e përmenda një shqetësim të qytetarëve të atij regjioni, ka të bëjë edhe me bashkëkombësit tanë matanë kufirit dhe është diçka krejt njerëzore, unë nuk jam në fushatë, as s’jam pjesë e angazhimit lokal atje, prandaj nuk është mirë të keqpërdoret emri. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri i Republikës së Kosovës e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Kolegë deputetë,
I nderuar kryetar i Kuvendit, kryesues të Kuvendit, nënkryetarë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Media,
Qytetarë,

Të sqaroj që në çdo kërkesë të Parlamentit do të përgjigjem, edhe unë, edhe Qeveria. Ka pasur një përjashtim për seancën që shkoj, arsyet i kam thënë dje, s’dua t’i përsëris. Po ka bërë përjashtim ajo që ka qenë rast ndryshe mendoj, edhe thellë besoj, edhe ju e dini që është përjashtim ajo e djeshmja.

Unë dëgjova disa tema, të gjitha me peshë, me rëndësinë e vet, u konsultuam me kolegët ministra. Ne çdo shqetësim që e ngritin deputetët ose grupet parlamentare, por që arrin te ne edhe në forma të tjera, duam të përballemi me këto shqetësime, s’duam t’i lëmë në pakufi temat e të

mbesin vetëm diskutime dhe pa epilog. E kam dëgjuar shqetësimin për kyçjen në drejtësi ose qasjen në drejtësi. I dëgjoja disa shqetësime të tjera të gjuhës fyese, pastaj dëgjoja shqetësimin e qenve endacakë, e ka shprehur edhe kryetari i Prishtinës. Sot besoj për këtë temën e qenve endacakë do të marrin vendim të vepror, pra të shohim si ndodh veprimi në Qeveri, e nuk i kam të sakta krejt procedurat, por do të bëjmë përpjekje në procedura të shpejta dhe në kohën e duhur të vepror.

Për të mos i ik peshës së temës të rastit Dehari, tani më i famshëm, i njohur si rasti “Dehari”, por që lidhet edhe me rastin tjetër që është në proces gjyqësor të sulmit në Kuvend, ne nuk kemi materie, ne Qeveria, domethënë i kemi disa detyra që lidhen me organet e drejtësisë, por një nga këto detyra që e përshpejton këtë proces ne e kemi aprovuar me propozim të ministrit në mbledhjen që shkoi. Njëkohësisht, unë s’dua tash ta bëj të njëjtin veprim që të bëj, ta quaj “presion” ose “ndërrhyrje në drejtësi”, por për mua është e papranueshme, cilido rast që zgjatet pa kufi. Duhet të ketë epilog në drejtësi, një drejtësi e vonuar është drejtësi e mohuar, mendoj që këtu kemi edhe raste të tjera në sistemin tonë gjyqësor që shkojnë në pakufi. Mirë është të ketë epilog, është interes i të gjithë neve, edhe këtu ju siguroj që sa i përket Qeverisë, pra vetëm ajo që s’është detyrë që ne nuk e bëjmë, se pushtetet janë të ndara dhe kemi rënë dakord ashtu, në sistemin tonë parlamentar, por çdo aspekt i Qeverisë do të vijë në shprehje që këto procese të marrin epilog, pra të përmbillen çka është pjesë jona. Vetëm që s’mund të shkojmë të bëjmë pjesën e prokurorit, e gjyqtarit, se atëherë nuk e dimë a është në rregull.

Çdo kërkesë që vjen, do të trajtohet me respekt. Edhe një herë, së pari duke i shprehur ngushëllime e keqardhje familjes Dehari, që edhe i njoh personalisht. Pastaj, shqetësimi i kyçjes në autostradë, u cek në Viti. Mua ma ka thënë edhe kolegu im atje në Viti, po ish një shqetësim i shumë lokaliteteve në këtë autostradën “Arbën Xhaferi”. T’ju them të drejtën, duhet parë, duhet biseduar me ata që janë vendimmarrës, me Ministrinë e Transportit, me punëkryerësin dhe të shohim si mund të bëhet një ristudim, se kemi vështirësi edhe në Rrugën e Kombit, pra në autostradën “Ibrahim Rugova”, edhe atje janë disa vështirësi, ku kyçja është bukur e limituar. Do ta shqyrtojmë këtë, por nuk mund të japim një përgjigje të saktë sot.

Një lutje për deputetët, lutje jo vetëm për pozitën. Unë do të kthehem prapë sot, kam pyetje parlamentare tash me radhë dhe interpelancë. Nëse ekzistojnë praktikatat që t’i bashkojmë temat që lidhen me kryetarin e Qeverisë, pra jo sot, sot nuk po insisto, por në të ardhmen, edhe Sekretariati na kishit ndihmuar që të mund t’i kryejmë detyrat që po presin, shumë prej të cilat u cekën edhe këtu. Pra, sot unë përgjigjem në pyetjet parlamentare dhe kthehem më vonë për interpelancë. Do të ishte një praktikë e mirë nëse do të mund t’i bashkojmë temat e qeverisë ose që lidhen me qeverinë që gjithkush t’i kryejë detyrat e veta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar tetë pyetje parlamentare.

Deputeti Dardan Molliqaj ka pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

DARDAN MOLLIQAJ: Nuk është në rregull, kryetar, që s'na e dhe fjalën se vetë premtove që do të na japësh fjalën kur adresohet. Ai nuk më tha Dardani, por tha kolegu nga "Vetëvendosja".

E vërteta është që u lajmërua Zenun Pajaziti, sepse është bashkëfajtor, sepse Luan Keka e Fatos Makolli kur janë emëruar në njësitin antiterror ky ka qenë ministër, e i ka dërgua aty, janë njerëz të PDK-së, e mban përgjegjësi, thonë, vetë lajmërohet. Por, po kaloj te pyetja:

Zoti kryeministër, në njërin nga tubimet tuaja me qytetarët keni theksuar se liberalizimi i vizave do të përshpejtohet me formimin e Komisionit për demarkacionin, i cili tashmë edhe ka ndodhur, dhe keni thënë saktësisht: "Unë nuk shoh periudhë më të gjatë se 3 muaj nga momenti i nisjes së punës për liberalizim". Pra, tre muaj prej që fillon Qeveria e Republikës së Kosovës. A mund të tregoni se a mund t'i qëndroni këtij zotimi për liberalizim të vizave, se sipas pikëpamjes time, nuk është e mundur edhe nëse ecim në ato afate për të cilat keni folur, apo deklaratimet e fundit që jeni duke i bërë kanë të bëjnë prapë vetëm me çështje elektorale, sepse jemi në zgjedhje lokale.

A do të kërkonti falje në këtë Kuvend nëse liberalizimi i vizave nuk bëhet brenda tre muajve, ashtu qysh keni premtuar dhe po premtoni prapë?

KRYETARI: Kryeministër, fjala është për ju.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Po i mësoj procedurat, më falni se nuk po i kam të qarta a duhet menjëherë përgjigjja apo... Unë e kam marrë edhe një shkresë me këtë pyetje dhe, kështu është gjendja. Do të thotë, kufiri është në Çakorr dhe në Kullë, është edhe do të mbesë, është temë që Kosova e di, duhet një komision i ri për t'i kryer procedurat që i takojnë, ta vërtetojë këtë.

Liberalizimi i vizave është temë që është ndërlidhur, përpos reformave në rend dhe ligj, si dhe në çrrënjosjen e korrupsionit, reformave të tjera administrative që janë përfshirë në MSA, por që janë nxjerrë në agjendën reformuese evropiane, ndryshe thonë "ERA", ka 22 veprime. Ne mund të jemi më vonë me demarkacionin, pra mund të vonohemi, mund të mos ta kemi zgjedhjen, për shkak se Kosova s'i ka 2/3 për versionin e tashëm të votës, pra kjo mund të çalojë, por është në proces. Pra, ka filluar një proces i kësaj teme, ndërsa mund të avancohemi më shumë në MSA-

në. Nëse MSA-ja dhe detyrat që kanë dalë janë më të avancuara, mund të mjaftojë kjo, pra mundet, në këtë kohë, për një vlerësim pozitiv për liberalizim të vizave.

Koha prej tre muajsh për temat që i kam cekur për të dyja është ende opion, një vonesë është shkaktuar edhe me vonesën e krijimit të institucioneve, pra vonesa dymujore ose sa ka ndodhur 3 muaj, dhe kjo ngecje e ka shkaktuar edhe një vonesë, mirëpo është opion, po ju them është opion ende që në afat të tillë kohor të vijë përgjigjja për liberalizim. Kemi bërë përpjekje në këtë kohë që kemi filluar, pra po themi se karta jonë për të fituar liberalizimin është agjenda evropiane e Kosovës, edhe ministria tani e Integritetit, njëkohësisht takimet ndërministrorë edhe me të gjitha delegacionet e tjera janë intensive në zbatim. Po e përdorim formulën që e kemi përdorur dikur për standardet për Kosovën, pra jemi intensivisht në zbatim të këtyre.

Nëse duhet të kërkoj falje për një të paarritur, edhe e bëj, mirëpo ende mbaj shpresë që do të marrim lajmin e duhur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit. Ka pyetje deputeti prapë. Dardan Molliqaj e ka fjalën.

DARDAN MOLLIQAJ: Sa kuptova, njëfarë gjysmëkërkimfalje ndodhi dhe kjo është mirë të mos keqpërdoret tash për zgjedhjet lokale. Po e kam tutje që po më shqetëson në kuadër të kësaj çështje, zoti Kryeministër, është që e keni premtuar arbitrazhin për çështje të demarkacionit, diçka të tillë ti e ke kundërshtuar bashkë me ne sa ke qenë në opozitë, si zgjidhje të problemit të demarkacionit. Në fjalimet tuaja të fundit nuk je duke e përmendur Bjelluhin, je duke e përmendur Çakorin dhe Zhlebin, por jo Bjelluhin. Kështu që a keni hequr dorë prej asaj pjese dhe si e shpjegoni çështjen e arbitrazhit tani, të cilin e ke kundërshtuar shumë gjatë me vendosmëri.

KRYETARI: Kryeministër, fjala për ju!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Do të thotë, zona që po flasim dhe parimi i ndarjes së kufirit janë majat e larta, domethënë nga Çakori, nga Kulla dhe majat e larta. Zona e Bjelluhës përfshihet në pjesën e këtjme, pra pjesa e Majës edhe këtj dhe nuk shoh një dallim. Ne nuk kemi precizuar krejt vijën asnjëherë maje në maje, por kontesti është i hapur në dy rrugë. Pra, akset rrugore në atë që vjen prej Plave dhe në atë që vjen prej Rozhajës, ato kanë mbetur tregues.

Tani shikoni, arbitrazhi si temë. Procedurat mes shteteve ose standardet e zgjidhjes së një teme, unë nuk i shpik sot, por ajo që është në kompetencë tonën si qeveri, jemi duke e bërë. Do të thotë, është ndërruar një komision, ka filluar punën një komision tjetër, i ka duart e lira, pra besoni, dhe e ka përkrahjen e të gjithë Kabinetit qeveritar, edhe të partnerëve të koalicionit që ta gjejnë të vërtetën. Ne presim, pra të gjeturat, nuk mund të prejudiojmë si do të veprojmë që

tani, pra presim të gjeturat, kur i kemi, do t'i diskutojmë së bashku. Por ju e dini qysh është vota ime personale për këtë version: është “jo” edhe mbetet “jo”.

KRYETARI: Deputeti Dardan Molliqaj ka pyetje për ministrin Pal Lekaj.

DARDAN MOLLIQAJ: Zoti Lekaj, kur u arrestua kryetari i partisë tuaj, tash kryeministër, në Francë, me fletarrestim të lëshuar nga regjimi i Serbisë, pati deklaruar se “Lista serbe janë vogëlsira që mësuesit i kanë në Beograd, se këta janë një grup banditësh që duken si politikanë të dirigjuar tani nga Qeveria e Serbisë dhe të njëjtit duhet të largohen nga qeveria”.

Zoti Lekaj, a mendoni që ende Lista serbe është e dirigjuar nga Qeveria e Serbisë, që janë banditë, që duhet larguar nga Qeveria e Kosovës, apo keni ndërruar ju?

KRYETARI: Zoti Pal Lekaj, ministër, fjala për ju.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuar kryeministër,
Ministra,
Deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
I nderuar deputet, mik Dardan Molliqaj.

Sot jam përballë qytetarëve si ministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, jam i emëruar për t'u marrë me punë praktike në shërbim të qytetarëve dhe nëse ke ndonjë pyetje që ka impakt pozitiv për qytetarët e Kosovës, unë jam këtu. Por, për respekt që kam dhe kemi obligim ndaj deputetëve, edhe po të përgjigjem në këtë pyetje.

Ndryshe, sa herë që të cenohet sovraniteti, por edhe sa herë të cenohen ata, të cilët na mundësuan këtë që ne sot jemi në Parlament, që janë luftëtarët e lirisë, unë çdo herë do ta kem të njëjtin mendim, qofshin subjekte politike, qofshin individë, qofshin njerëz që ndikojnë negativisht në shtetin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe një herë po kërkon pyetjen ta plotësojë, Dardan Molliqaj.

DARDAN MOLLIQAJ: E para, zoti Lekaj, ti nuk je përfaqësues teknik i Qeverisë, ne nuk kemi qeveri teknike, ti je deputet i zgjedhur, tash ministër i një partie politike, je nënkryetar partie, me sa e di unë dhe qëndrimet tuaja nuk janë veç të ekspertit. Ne nuk kemi ministër ekspert, bile nuk e dimë që ke ndonjë afinitet në fushën që po e drejton, përkundrazi, me sa e di unë ti je mjek.

Pra, a po do të të pyesim për shëndetësi tash, nëse është çështja e ekspertizës. Për mua është problem që ky ndërrim kaq i madh i kursit politik, pra nuk ka qëndrueshmëri politike, dhe me këtë kurs na do të kemi aventura të kësaj qeverie dhe unë po pres që ju o t'i mbani qëndrimet e njëjta, ose ndërrimin e qëndrimeve që e keni bërë tash, edhe për çështje të tjera, të tregoni, të thoni për shkak të këtyre rrethanave e kemi ndërruar. Ose, cila është e vërteta, sipas mendimit tënd, për shkak të dëshirës të jesh në Qeveri po i përpini krejt ato që thotë populli se "i keni pështyrë".

Po, është vendim juaji, por mirë që po e pranoni edhe publikisht që kjo...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti ministër, prapë dëshiron të përgjigjet.

MINISTRI PAL LEKAJ: Prapë më duhet të jem i qartë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka saktësuar që kush mund të jetë pjesë e Qeverisë, cilat të drejta janë kushtetuese dhe asgjë më pak dhe asgjë më shumë nuk kemi vepruar. Por për hir të qytetarëve çdoherë kam qenë në të mirën dhe në shërbim të qytetarëve, në çdo kohë, edhe atëherë kur disa e kanë parë prej televizorit luftën, edhe atëherë kur është dashur t'i shërojmë luftëtarët e lirisë, edhe tani jam pjesë e sistemit që punoj çdo minutë që t'i shërbej vendit tim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Frashër Krasniqi ka pyetje për ministrin Nenad Rikalo.

FRASHËR KRASNIQI: Shpresojmë që ministri Rikalo nuk do të vazhdojë të sillet kështu edhe gjatë interpelancës, pra t'u përgjigjet akuzave dhe dëshmive të qytetarëve nëpërmjet ikjes dhe fshehjes, sepse ishte më herët këtu, por doli qëllimisht pak para se t'i bëj pyetje.

Zoti Rikalo, sidoqoftë unë po e bëj pyetjen për hir të qytetarëve të Kosovës, të cilëve u kam premtuar se do ta bëj këtë pyetje. Qytetarët e lagjes "Dardania" kanë dhënë dëshmi që ju keni bërë tortura dhe dhunime gjatë luftës. Jo vetëm këta qytetarë, ka edhe qytetarë të tjerë, të cilët kanë deponuar dëshmitë e tyre edhe në prokurori, por i kanë thënë edhe publikisht. Ju, zoti ministër, keni deklaruar që keni bërë një jetë të qetë dhe keni pasur raporte të mira me fqinjët tuaj. Për ne është e paqartë atëherë pse fqinjët tuaj, ish-fqinjët tuaj të lagjes "Dardania" i kanë këto ankesa, pse nuk po bëhen këto ankesa ndaj asnjë përfaqësuesi tjetër të komunitetit serb, sepse ne nuk kemi problem me komunitetin serb, nuk kemi problem me serbët që jetojnë në Kosovë, por pse pikërisht me ju po kanë problem?

Cili ka qenë roli juaj gjatë luftës së fundit në Kosovë? Nuk keni dhënë asnjëherë përgjegjësi, nuk keni treguar asnjëherë cili ka qenë roli i familjes suaj gjatë kësaj lufte dhe çka nënkuptoni ju me frazën që e keni thënë që keni bërë jetë të qetë gjatë vitit '99 në kohën kur ndaj shqiptarëve po

ushtrohej represion i përmasave të spastrimit etnik. Çka nënkupton për ju ‘jeta e qetë’? A përfshihet në ‘jetën e qetë’ edhe torturat, edhe rrahjet që banorët ju akuzojnë se i keni bërë gjatë kësaj kohe në lagjen “Dardania”? Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri i Republikës, zoti Ramush Haradinaj, dëshiron të përgjigjet.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Në fakt, nuk dola për përgjigje, por ne ishim bërë gati për interpelancë dhe e lirova ministrin, kishte takim me një ambasador të caktuar dhe e lirova unë, nuk e dita që do të ketë pyetje për të, tani. Pasi ishim bërë gati që në këtë temë, kur është interpelanca, nëse është në shërbim të pyetjes unë mund të jap një mendim, nëse jo, e lëmë kur është interpelanca, por e lirova unë ministrin në këtë rast. Më falni!

KRYETARI: Deputeti Frashër Krasniqi dëshiron ta plotësojë pyetjen.

FRASHËR KRASNIQI: Zoti Haradinaj, mua më vjen shumë keq që në vazhdimësi jeni duke e arsyetuar ministrin Rikalo dhe kjo nuk po ndodh vetëm në këtë seancë, por po ndodh prej që kanë filluar akuzat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Për mua është befasi jo e këndshme që ju, zoti Ramush Haradinaj, po i dilni në krah, përkundër akuzave të qytetarëve, në vazhdimësi një ministri, ndaj të cilit rëndojnë akuza serioze. Në vend që ta shkarkoni këtë ministër, sepse keni kërkuar në kohën sa kemi qenë në opozitë shkarkimin e Jablanoviqit, kemi protestuar bashkë, edhe me ju, edhe me qytetarët e Republikës së Kosovës, ndërsa sot për shkak që nëpërmjet këtij ministri dhe ministrave të tjerë të Listës serbe e keni siguruar pushtetin, po i dilni në mbrojtje në vazhdimësi.

Kjo është me të vërtetë për keqardhje, sepse nuk ka kurrfarë justifikimi për ikjen nga pyetje, edhe nëse ju nuk e keni ditur, zoti Rikalo e ka ditur që do t’i bëhet pyetja, ka mundur që të mos ikë. Shpresoj që ikja...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Ne jemi në fillim, e disa procedura të Kuvendit po i mësojmë, pra nga kjo anë. Unë vetëm andej jam ulur, prej atje kam ditur, por prej kësaj pjese po i mësoj. Kjo që thashë është e vërtetë, pra e lirova, e sikur kam liruar edhe ndonjë tjetër për disa detyra që janë, pra s’e kam ditur që do të ketë pyetje nga një deputet, sepse unë e shoh këtë pyetjen tuaj si përsëritje të interpelancës. Nëse ka interpelancë për pak, e di se i është dedikuar atij, por unë mendova që aty do të konsumohet kjo temë.

Prapë, nëse është në shërbim të Parlamentit jo vetëm ta thërrasim, po mund të kyçet në pjesën time, por nuk po jap shpjegime për të, por vetëm qëllova këtu dhe ju dhashë shpjegime si ka ndodhur. Pastaj, shikoni, politikëbërja dhe temat e tjera janë proces, i kuptoj.

KRYETARI: Deputeti Slavko Simiq ka pyetje për ministrin Flamur Sefaj.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

S obzirom da ministar Unutrašnjih Poslova Kosova g. Sefaj, nije prisutan na ovoj sednici, sigurno da nije korektno da mu postavljam i pitanja, ostavljajući pitanja na narednoj sednici. Hvala!

KRYETARI: Deputetja Shqipe Pantina ka pyetje për ministrin Pal Lekaj.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Ministër Lekaj, më 6 shkurt të këtij viti, do të thotë para 8 muajsh, unë i kisha shtruar të njëjtën pyetje ministrit të atëhershëm Zharku, që ka të bëjë me licencimin e linjave të transportit publik për në aeroportin e Prishtinës.

Në atë kohë ai pati deklaruar se kjo çështje do të zgjidhej shumë shpejt, bile brenda ditësh. Megjithatë, ende nuk ka linja të autobusëve as nga Prishtina, po as edhe nga qytetet e tjera. Kur ju mendoni se do ta rregulloni çështjen e transportit publik për në aeroportin e Prishtinës?

KRYETARI: Ministri Pal Lekaj e ka fjalën.

MINISTRI PAL LEKAJ: E nderuar deputete zonja Pantina, Faleminderit për pyetjen, unë jam mishëruar me këtë problem dhe para qytetarëve të Republikës së Kosovës zotohem që brenda këtij muaji do të kryhet ai problem që është në të mirën e qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, a dëshiron ta plotësosh pyetjen? Ka plotësim pyetje nga deputetja. Urdhëro!

SHQIPE PANTINA: Sot është data 3 tetor, kështu pati deklaruar edhe ministri Zharku, zoti Lekaj, pas një muaji shpresoj që nuk do të kem nevojë ta bëj të njëjtën pyetje.

KRYETARI: Edhe një herë ministri dëshiron ta plotësojë përgjigjen.

MINISTRI PAL LEKAJ: Unë nuk do të ndalem në atë çka ka bërë Qeveria e kaluar apo ministri, por dallimi mes nesh dhe ish-qeverisë është saktësia në kohë dhe në përfundim të projekteve. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Arbërie Nagavci ka pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

ARBËRIE NAGAVCI: Zoti kryeministër, në komunikatën e lëshuar nga Divizioni për Komunikim Publik në MASHT, më 25 shtator 2017, njoftohet, citoj: “Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqeri Bytyqi, ka marrë vendim për shkarkimin e Bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe ushtruesit të detyrës së drejtorit të kësaj agjencie. Këtë vendim ministri Bytyqi e ka marrë pas kërkesës së kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, me të cilin kryeministri ka kërkuar edhe fillimin e menjëhershëm të procedurave për përzgjedhjen e bordit të ri dhe drejtorit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit. Kryeministri Haradinaj këtë kërkesë e ka bërë duke arsyetuar se procesi i akreditimit në arsimin e lartë është përcjellë me parregullsi serioze, ndërsa ka kërkuar nga ministri që procesi i ri të rezultojë me përzgjedhjen e njerëzve me ekspertizë të duhur në sektorin e arsimit, etike dhe profesionale.

Zoti kryeministër, a mund të na njoftoni pse janë shkarkuar përnjëherë të gjithë anëtarët e Bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në mesin e të cilëve kishte edhe anëtarë ndërkombëtarë, ekspertë të arsimit të lartë që vlerësohen nga komuniteti akademik ndërkombëtar. Në komunikatë thuhet se shkarkimi është bërë pas kërkesës suaj, me arsyetim se procesi i akreditimit është përcjellë me parregullsi serioze. Në lidhje me këtë, a mund të na tregoni se a ka pasur një hulumtim dhe një analizë të punës dhe performancës të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Nëse ka pasur një vlerësim të performancës, kush e ka bërë këtë, cilat janë gjetjet, gjegjësisht shkeljet apo parregullsitë dhe çfarë është ndërmarrë apo do të ndërmerret për të përmirësuar këto parregullsi dhe pse gjithë këto parregullsi nuk janë bërë publike? Po ashtu, ju lutem, na njoftoni kur keni planifikuar të raportoni në këtë Kuvend në lidhje me vendimin tuaj, pasi në Ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, në nenin 7, pika 5, parashihet se: “Nëse më shumë se 1/3 e anëtarëve të bordit zëvendësohen për çfarëdo...”

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar deputete,
Vlerësimi është kështu: gjendja në arsimin e lartë përgjithësi nuk është mirë, ndërsa disa vështirësi janë shfaqur më shumë te institucionet e arsimit privat, arsimit të lartë. Diskutimet publike vazhdojnë me vite, edhe qëllimi i këtij shkarkimi nuk është diskriminimi i ndonjë kuadri, apo edhe privilegj i dikujt tjetër. Të jeni të sigurt, nuk kemi emra të parathënë kush vjen, nuk është bërë për këtë motiv. Shprehja e një papajtueshmërie me një gjendje, një momentum i ri në atë gjendje, ky është qëllimi. Kemi marrë përgjegjësitë për sektorët veç e veç, kemi pasur edhe

raste të veprimit të këtillë të shkarkimit të komisioneve ose bordeve, jo për shkak që të sjellim ndonjë kolegë të partive, por për shkak të një momentumit që është më se i nevojshëm dhe të një porosie të qartë që s'pajtohem me gjendjen që është.

Pra, kjo është e vërteta e kësaj që ka ndodhur. Kuptohet, për raportim në çdo kohë kur e parashohin procedurat, edhe kjo nuk është një vlerësim vetëm i vlerave të individëve ose kush janë ata në këtë agjenci, por ky është një vlerësim i gjendjes në sektor, nuk është një gjendje në rregull. Nëse ju pajtoheni që është gjendja e mirë në arsimin e lartë, në institucionet e arsimit të lartë privat, atëherë bisedojmë a është a s'është, por ky është vendimi. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Pyetje shitesë a keni, zonja Nagavci? Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Zoti kryeministër, pajtohem pothuajse të gjithë për gjendjen e vështirë të arsimit jo vetëm në arsimin e lartë, por ju nuk u përgjigjet në asnjërën nga pyetjet që unë parashtrova. Pra, cilat janë gjetjet dhe a ka të bëjë kjo, në fakt, edhe me mosakreditimin e kolegjeve private? Mendoj se zgjedhja e bordit të ri do të japë përgjigje në shumë pyetje dhe uroj që kjo të mos jetë politike ashtu sikurse duket që është.

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shikoni, gjendja është jo e mirë në plot sektorë. Ne tani mund t'i mbyllim sytë, mund të bëjmë akomodime, mund të bëjmë plot veprime, por njëri nga veprimet që e shënon një nisje ose një ndryshim, është edhe ndërrimi i atyre që janë përgjegjës, ose që kanë qenë përgjegjës.

Tani po të kishim një shkop magjik e kishim ndërruar ndoshta krejt Kosovën, por në disa situata s'kemi qare pa vepruar. Nuk është bërë për asgjë tjetër, por për një nisje të re, për një kualitet, për një garanci që ata fëmijë të Kosovës që shkojnë nëpër këto universitete, e që unë s'kam ndonjë qëndrim negativ dhe i mirëpres edhe institucionet e arsimit të lartë privat, edhe të gjitha institucionet e arsimit të tëra niveleve private, mirëpo s'guxojmë të lejojmë, ta zëmë, një gjendje e cila s'i përgjigjet misionit që ka arsimit i lartë. Jemi deklaruar të gjithë në të kaluarën që misioni i arsimit është zënia e dijes, tani nuk them se secili nga ta është merituar dhe vetëm ata janë merituar për një gjendje të këtillë, por duhet të veprojmë nga diku e duhet të jemi bashkë në këto veprime, nëse e kanë për qëllim, pra po them edhe një herë, rregullimin e një çështjeje kaq të ndjeshme, e cila do ta kërkojë përkrahjen e të gjithë neve.

Asnjë vendim s'do t'i bie tamam secilit, edhe çdo vendim që e marrim mund të ketë edhe kundërshtime, mund të ketë papajtueshmëri ose vërejtje, por edhe të mos marrim vendime e të

presim në pakufi që gjendja do të rregullohet vetë, nuk e dimë si do të ndodhë. Pra, qëllimi im në këto raste nuk është fare i drejtuar te ata, por është te tema. Ne kemi tema që po na rëndojnë, duhet t'i trajtojmë këto tema, kështu ka ndodhur, ju lutem.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hykmete Bajrami ka pyetje për ministrin Besim Beqaj.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit! Edhe unë po e bëj thjesht një devijim për shkak se më herët u dha një dezinformatë. Komuna e Vitisë, zoti deputet Salihu, ka qasje në rrugën "Arbën Xhaferi", këtë vendim e ka marrë Komuniteti ndërmintor. Ministër, ta keni vëmendjen këtu, më 26 maj të vitit 2017 unë e kam vendimin dhe pas pak do ta bëj publik në rrjetin social Facebook.

Komuna e Vitisë ka realizuar për mandatin katërvjeçar 19 milionë investime kapitale, prej të cilave vetëm 8 kanë qenë të ndara si buxhet i Komunës së Vitisë dhe komplet të tjerat kanë qenë nga ministritë e linjës, kështu që aspak nuk është e vërtetë që është anashkaluar.

Tani, i nderuar ministër Beqaj, ministria juaj është e re, e cila u krijua me qeverisjen Haradinaj. Ne kemi marrë programin 2017 - 2021, në bazë të asaj çfarë shkruhet aty, ju keni kompetenca dhe objektiva që sot janë të mbuluara nga institucione të tjera dhe ne si deputetë, por edhe si qytetarë dhe bizneset e vendit ende nuk e dimë fushëveprimtarinë e ministrisë suaj, si dhe buxhetin që ju keni në dispozicion. Ajo çfarë neve na intereson është që saktë se si do t'i ndani detyrat dhe përgjegjësitë, e keni edhe ministrin e Tregtisë dhe Industrisë këtu të pranishëm me agjencinë "KIESA", e cila mbulon komplet fushën e ndërmarrësisë dhe të inovacionet kur flisni, ajo fushë komplet mbulohet sot nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, sepse krejt çka flitet aty, diku rreth 80% flitet për fushën e TIK-ut dhe një fond të TIK-ut.

Na tregoni, ju lutem, sa do të jetë buxheti i ministrisë suaj? Cili do të jetë staffi? Cilat do të jenë detyrat dhe përgjegjësitë, si do të harmonizoheni me agjencinë KIESA, a do të ketë punësime të reja për ministrinë tuaj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Bajrami,

Të falënderoj shumë për pyetjen e bërë, sigurisht që inovacioni dhe ndërmarrësia janë dy çështje jashtëzakonisht të rëndësishme në kohën kur flasim për rritje të konkurrueshmërisë dhe

përkrahjes më të fuqishme që duhet të bëhet për sektorin privat. Ne kemi prezantuar qartë në program se cilat janë kompetencat e ministrisë, por do ta përsëris për juve, për deputetët, por edhe për qytetarët edhe një herë.

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do të hartojë, do të zbatojë politika strategji dhe legjislacion në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave mbështet, menaxhon çështjet administrative financiare dhe buxhetore të ministrisë. Përfaqëson Qeverinë e Kosovës dhe bashkëpunon me entitetet ndërkombëtare për sektorë të inovacionit dhe ndërmarrësisë dhe përkrah aktivitetet në hulumtim dhe zhvillim duke e lidhur me avancimin social, ekonomik, shkencor dhe teknologjik në Republikën e Kosovës.

- Bën koordinim ndërqeveritar për zhvillimin e ndërmarrësisë dhe inovacionit dhe krijon trupa koordinues në mes të Qeverisë dhe sektorit privat për inovacion dhe ndërmarrësi.

- Negocion dhe zbaton projekte me donatorë, institucione financiare, ndërkombëtare dhe partnerë të tjerë në lidhje me instrumentet financiare në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë.

- Bashkëpunon me komunitetin kombëtar për zhvillim ekonomik, bashkëpunon me universitetet, me shoqërinë civile, me komunitetin e teknologjisë informative, komunitetin e biznesit, donatorë për themelimin e qendrave rajonale të inovacionit dhe inkubatorit të biznesit. Në bashkëpunim me komunitetin e biznesit identifikon, përkrah dhe ofron trajnime profesionale për ndërmarrësit dhe ndërton një sistem gjithëpërfshirës për mbështetje dhe zhvillim cilësor të ndërmarrësisë;

- Propozon strukturimin dhe udhëheq programet, fondet për inovacion dhe ndërmarrësi;

- Harton politika dhe programe që mbron përkrah dhe stimulon zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me fokus në eksportet e tyre, me synim punësimin e të rinjve dhe ngritjen e kapaciteteve për femrat ndërmarrëse, duke siguruar rritje të punësimit dhe zhvillim ekonomik; dhe

- Propozon politika për rregullimin e tregut të brendshëm, masa fiskale dhe jofiskale në funksion të zhvillimit të sektorëve të inovacionit dhe ndërmarrësisë, si dhe ofron përkrahje institucionale në realizimin e projekteve me interes strategjik në fushën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Normalisht, ofron bashkëpunim institucional në drejtim të zhvillimit të zonave ekonomike me shërbim të zhvillimit të inovacioneve dhe ndërmarrësisë. Për më tepër, kjo ministri do të jetë bartëse e Fondit për Inovacion dhe Ndërmarrësi, fond i cili në bashkëpunim me donatorët do të kalojë shumë prej 20 milionë eurosh dhe do të fokusohet prej fazës së para inkubimit, inkubimit, zhvillimit të ndërmarrjes, plasimit të tyre në treg dhe do të koncentrohet në përkrahje

të të gjitha ideve inovative, të cilat kanë të bëjnë me të rinjtë, me gratë dhe do t'i përkrahë bizneset ekzistuese në fushën e hulumtimit dhe zhvillimit.

Kjo do të jetë fushëveprimi. Buxhetin tanimë e kemi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zonja Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Faleminderit për përgjigjen, por prapëseprapë nuk u përgjigjët. Në fakt, e gjithë fushëveprimtaria juaj që ka të bëjë me ndërmarrjet sot është në kompetencën e Agjencisë KIESA. Si do ia bëni me këtë agjenci? Do e merrni Agjencinë në Ministrinë e Ndërmarrësisë dhe Inovacionit apo çfarë do të bëni?

Të gjitha këto objektiva, gjithë këtë fushëveprimtari e ka Agjencia KIESA. Mungesa e agjencisë ka qenë mungesë e buxhetit, e cila normalisht ka qenë si rezultat i kufizimeve buxhetore që kemi pasur. Përndryshe, ka qenë shumë më mirë që të forcohen kapacitetet e KIES-ës, që ne e kemi paraparë forcimin e kapaciteteve në kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitin 2017/2021, se sa të dublifikohe të gjitha këto. Prapë nuk na tregove se çka me buxhetin, sa është?

Në fakt, ju treguat, por nuk u dëgjua. Sa do të jetë buxheti i ministrisë suaj për këtë vit dhe për vitin 2018?

KRYESUESI: Zoti Beqaj, e keni fjalën.

BESIM BEQAJ: Zonja deputete, faleminderit edhe një herë për pyetjen shtesë!

Dua të ju them që KIESA nuk ka rekorde të mira as Ministria për Tregti dhe Industri, sa i përket ndërmarrësisë, projekte të cilat kanë qenë jashtëzakonisht të pakta dhe projekte që nuk kanë pasur mbështetje financiare, shihet edhe në raportin e Auditorit të Përgjithshëm se ato mjete janë ndarë në mënyrë jotransparente, do të thotë aq pak mjete ka pasur, sa që ato janë ndarë në mënyrë jotransparente dhe joefektive për biznesin. Por, këtë mund ta shihni në raportin e Auditorit të Përgjithshëm. Nuk po flas unë si Besim, por po flet raporti i Auditorit.

Në lidhje me këtë, po e them edhe një herë, ministria është ministri e re, do të ketë mbi 50 të punësuar, do të jetë një institucion bazik, i cili do të komunikojë me të gjitha institucionet relevante, duke bërë koordinimin ndërinstitucional sa u përket inovacioneve dhe ndërmarrësisë. Prandaj, ato gjëra që kanë të bëjnë me ndërmarrësinë dhe inovacionin do të jetë në Ministrinë për Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe kjo do të jetë dera e hapur e biznesit dhe unë ju bëj ftesë sot të

gjithë ndërmarrësve, të gjithë novatorëve, të gjithë atyre që kanë ide, jo vetëm për të prur inovacione, por edhe ata që kanë ide për ta rritur prodhimin, për ta përmirësuar shërbimin, për t'i bërë... le t'i adresohen Ministrisë për Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe do ta kenë përkrahjen dhe mbështetjen, edhe financiare, edhe për trajnime, edhe për eksport, edhe për zhvillim dhe hulumtim, por edhe për përkrahje për përmirësimin e produkteve të veta, sepse kemi nevojë që ekonomia jonë të marrë rrugën e mbarë, siç duhet, në kuptimin e sektorit privat dhe fuqizimit ekonomik të vendit, duke krijuar vende të reja të punës.

Ne nuk besojmë në asnjë rrethanë, që vendet e punës do të krijohen nga institucionet, ne përmes këtyre fondeve do t'u mundësojmë atyre qasje në rrugët zhvillimore. E thashë, buxheti do të jetë mbi 20 milionë duke marrë parasysh që sot kemi shumë donatorë që kanë treguar interes për të dhënë fonde të përbashkëta dhe bashkë me fondin i cili do të ndahet nga Buxheti...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë zonja Hykmete Bajrami, deputetja. Pyetje për ministrin Bedri Hamza. Zonja deputete, e keni fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

Fillimisht i përgjigjem zotit Beqaj.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në emër të Qeverisë së Kosovës mandatin e kaluar e ka marrë çmimin në Stamboll si qeveria më e mirë në mbështetje të ndërmarrësisë dhe këtë kemi qenë të nominuar nga sektori privat.

Raporti i Auditorit i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është ndër tri raportet më të mira që ka Qeveria qendrore. Nuk është mirë me dezinformua. E treguat për çfarë e keni formuar ministrinë, për t'i punësuar 50 militantë të PDK-së, asgjë tjetër. Thatë, buxheti 20 milionë prej donatorëve. Ku donatorët? Cili donator ka me të dhënë para? Ne kemi me të mbajt përgjegjës!

Tani i nderuar, ministër Hamza,

KRYESUESI: Na fal pak, Hykmete, se e shkele Rregulloren. Tash edhe unë po e shkel.

HYKMETE BAJRAMI: S'e shkele unë Rregulloren, e kam minutazhën time.

KRYESUESI: Zoti Beqaj ka të drejtë të përgjigjet në akuzë.

HYKMETE BAJRAMI: Nuk është akuzë, është kundërpërgjigje. Raportin e auditorit s'e ka lexuar asnjëherë. S'e ka lexuar Raportin e Auditorit, është ndër tri raportet më të mira të nivelit qendror.

KRYESUESI: Mirë, mirë, qe edhe ky po do të flasë.

HYKMETE BAJRAMI: Po, mos të del se nuk është...

BESIM BEQAJ: Sa i përket raportit të auditorit unë kam pasur para vetes raportin e vitit 2016 dhe thotë kështu: “Agjencia për nxitjen e investimeve KIESA, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është vlerësuar jotransparente në procedurat e dhënies së subvencioneve nga zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka gjetur raste, kur ka kontrata për subvencione të cilat janë nënshkruar para zotimit të mjeteve. Qëllimi i këtij subvencioni ka qenë organizimi i panairit dhe normalisht, marrëveshja është nënshkruar pasi që është realizuar. Dhe, ka edhe shumë e shumë gjëra të tjera, që janë të përcaktuara”.

Pra, nuk po flas vetëm nga mendja e shëndoshë, por po flas nga Raporti i Auditorit. Unë nuk jam auditor. Ne e kemi një auditor i cili është përgjegjës Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe po e them edhe një herë, ky vend ka nevojë të marrë rrugën e mbarë, sa i përket zhvillimit të ndërmarrësisë dhe Qeveria është e përkushtuar me fonde të mjaftueshme dhe donatorë të cilët kanë treguar gatishmëri për një udhëheqje transparente, për një udhëheqje të pastër, për një udhëheqje e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë do t’i adresojë nevojat e ndërmarrësve. Dhe në këtë drejtim Ministria për Inovacion dhe Ndërmarrësi do të jetë shumë e gatshme dhe shumë e përgatitur që në bashkëpunim edhe me juve, deputete, por edhe me deputetët tjerë po edhe me qytetarët e ndërmarrësit, me të gjithë ata që kanë interes për ta çuar vendin përpara, të bashkëpunojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Hykmete, nëse ke edhe diçka për zotën Beqaj, pastaj e ke këtë pyetjen, se e shkelëm tash...

HYKMETE BAJRAMI: Zotit Beqaj!

Edhe në vitin 2016 Raporti i Auditorit i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, prapë po e them, është ndër tri raportet më të mira në nivel qendror dhe këtë duhet ta pranoni. Për herë të parë në histori të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në mandatin tim subvencionet janë dhënë përmes konkurseve me shpallje publike. Kemi Rregullore për ndarje të subvencioneve dhe janë përcjellë të gjitha.

Tek financimi i panaireve kanë qenë njëburimore, për shkak se ka qenë Oda Ekonomike e cila ka organizuar panairin dhe nuk ka pasur konkurrencë, nuk ka pasur tender për të konkurruar dikush tjetër, sepse ka qenë Oda, e financon, merre ose lëre.

Kështu që, mos u merr me ato gjëra, sepse është debati humbur. Tregove, Ministria jote ka për qëllim me i punësua 50 militantë të PDK-së, bizneset fatkeqësisht në këtë mandat nuk kanë me ditë a me shkua te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, te minis...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Veç kontrollin e naftës, interesant, s'po mundeni asnjëherë, asnjë ministër me e bë. Kontrolli i naftës që hyn në Kosovë është i pakontrolluar dhe i pakontrollueshëm nga asnjëri që ka udhëhequr ministrinë përkatëse. Zoti Beqaj edhe një herë e ke një minutë dhe vazhdojmë.

BESIM BEQAJ: Faleminderit!

Zoti kryesues, unë edhe një herë për hir të qytetarëve, jo për hir sepse deputetja e din. Unë vetëm e lexova raportin e Auditorit të Pavarur, i cili është institucion zyrtar që bën auditimin dhe gjetjet të cilat janë të përcaktuara brenda kompetencave të tij për institucionet të cilat ai auditon. Pra, nuk jam duke folur përmendësh, është një raport i Auditorit, i cili thotë se ka pasur jotransparencë të ndarjet e subvencioneve në Ministrinë për Tregti dhe Industri dhe nuk është punë e imja. Unë e thash një të gjetur, të cilën ju do të duhej ta shpjegoni tek Zyra e Auditorit, jo tek ne. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Bajrami, tani e keni pyetjen për ministrin Bedri Hamza.

HYKMETE BAJRAMI: Fillimisht, për raportin e auditorit, është publik mund ta lexoni gjithsecili. Zoti Haliti, ju nuk keni të drejtë të bëni komente dhe ta keqpërdorni foltoren prej aty ku po e kryesoni Kuvendin. S'kemi mundur të vemi kontroll,

KRYESUESI: Unë jam deputet dhe jam i interesuar, saktë me e ditë sa evazion fiskal ka Kosova nëpërmjet kontrabandës së naftës në Kosovë.

HYKMETE BAJRAMI: ...a e dini pse? Sa evazion fiskal? Unë... Merre fjalën, del fol, mos m'i merr minutat.

KRYESUESI: Ke qenë ministresh dhe asnjëherë s'ke arritur ta kontrollosh naftën.

HYKMETE BAJRAMI: Kontrollin e naftës e keni ju. Trego kah e ke rrjedhën e pasurisë? Kah je bërë milioner. Kontrollin e naftës e keni ju, unë e kam pru ligjin këtu edhe nuk e keni përkrahur ligjin. E kemi kaluar kompetencën e kontrollit të cilësisë te Doganat. Andaj mos bën...

KRYESUESI: Ti ke qenë ministre...

HYKMETE BAJRAMI: Kam qenë ministresh, ligjet është dashur t'i aprovojë ky Parlament.

KRYESUESI: Të lutem, ndalja mikrofonin!

(Ndërprerje nga regjia)

Ke qenë ministresh, përgjegjësia është e jotja. Nëse unë do të isha ministër me siguri se do të mbaja përgjegjësi. “Ju”, mos fol në shumës. Mos fol se ti, ti... unë mund të të akuzoj ty, ti mua s’mundesh, se s’kam pasur kurrë në dorë, sa i përket asaj, prandaj ke kujdes. S’ka nevojë me akuzua pa fakte.

Unë jam i interesuar me e ditë, pse s’e keni kontrolluar qarkullimin e naftës së keqe në Kosovë dhe kontrabandën e naftës në Kosovë? Ka qenë detyrë e jotja, të lutem! E ke pyetjen për zotin Hamza, vazhdoni.

HYKMETE BAJRAMI: Zoti Haliti, unë jam përgjegjës për çdo minutë që kam qenë ministre e Tregtisë dhe Industrisë. Kontrabanda kontrollohet nga Doganat. Njerëzit e juaj i kanë udhëhequr Doganat me vite dhe ju e dini kush ka bërë kontrabandë dhe në xhepat e kujt kanë rrjedhur paratë nga kontrabanda. Të njëjtit po kthehen në institucione prapë, kështu që mos akuzoni. Unë e kam kaluar cilësinë e naftës nga operatorët privatë tek Doganat e Kosovës, tek institucionet, pasi i kemi shkapur ato.

Kështu që, tash po filloj me pyetjen.

KRYESUESI: Atëherë, paske qenë në bashkëpunim me Doganën. Meqenëse, Dogana është e jotja, e jona, po thua prapë shumës...

HYKMETE BAJRAMI: Doganat pasi që i kemi ç’kapë, ministri i Financave i ka ç’kapë Doganat.

KRYESUESI: Atëherë, paskemi bashkëpunuar unë e ti bashkë. Në fakt, unë kurrë s’të kam qenë as në ministri, as s’të kam kërkuar ndonjë nder me ma bë personalisht.

HYKMETE BAJRAMI: Nuk ke të drejtë të bësh komente. Absolutisht s’ke të drejtë me bë komente.

KRYESUESI: Me ata që i ke bërë pazaret, me ata që i ke ndarë pazaret, qiti. Eh...

HYKMETE BAJRAMI: Je deputet sikurse unë. Absolutisht nuk kam bërë asnjë pazar. Jam e pastër. Kur të doni akuzoni, janë institucionet, çoni atje. Nuk është e vërtetë. Kështu që dihet, në Kosovë dihet kush bën kontrabandë.

Zoti Hamza, pika 2 e nenit 16-a të Ligjit për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës thotë: “Buxheti i përgjithshëm për realizimin e pagesës

së pensionit të veteranit luftëtar të UÇK-së shfrytëzohet tërësisht gjatë vitit dhe për këtë destinimi nuk mund të kalojë 0,7% të bruto-produktit vendor në vit”.

Ju kohëve të fundit keni thënë që i keni ndarë mjetet, i keni gjetur mjetet për ndarjen e pensioneve për veteranët, atëherë pyetja është që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdo, vazhdo bëje pyetjen. Ia ke dërguar që dy javë e ka lexuar ky, po hajt...

HYKMETE BAJRAMI: Pyetja është: A do e respektoni Ligjin për plotësim dhe ndryshim të Ligjit të veteranëve gjatë plotësim ndryshimit të Ligjit të Buxhetit për vitin 2017 dhe njëkohësisht, a do të respektohet ky ligj në Ligjin e Buxhetit të vitit 2018?

KRYESUESI: Zoti ministër Hamza, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit kryesues, nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Shumë e nderuar deputete, zonja Bajrami,

Po. Ministria e Financave gjatë draftimit të Projektligjit të Buxhetit për vitin 2017, të rishikimit, po edhe gjatë draftimit të Ligjit të Buxhetit për vitin 2018 do ta respektojë në tërësi Ligjin nr. 05/L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mirëpo, zonja Bajrami, i referoheni nenit 16/a, pikës 2 të këtij Ligji, po ky nen 16/a e ka edhe paragrafin 3, po e citoj: “Skema e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni zbatohet pas kategorizimit përfundimtar, ndërsa në paragrafin 3, pika 1, thuhet se deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranit luftëtar të UÇK-së skema pensionale zbatohet siç është e paraparë me Ligjin bazik.

Prandaj, ministria e financave në këtë rast ka vepruar shumë drejtë, që e ka gjetur fondin dhe i ka mobilizuar fondet për t’ua kryer pagesën një kategorie më të vlefshme në shoqëri për t’i realizuar të drejtat që ua ka dhënë Ligji. Ndërsa, ka qenë i padrejtë buxhetimi apo nënbuxhetimi për këtë kategori, jo në bazë të ligjit aktual në fuqi, po në bazë të disa ligjeve dhe disa neneve, që pritet të vijnë dhe nuk ka ndodhur. Ne si Ministri e Financave, derisa të ndodhë kategorizimi përfundimtar do ta bëjmë buxhetimin në bazë të ligjit aktual në fuqi.

Po, edhe një çështje. Nuk është mirë, që kjo kategori me bo pyetje çdo ditë kur e realizojnë të drejtën e vetë. Kur ata i kryejnë obligimet ndaj institucioneve tjera që i kanë. Prandaj, duhet me

qenë korrekt, ne do ta zbatojmë ligjin dhe deri sa të është ligji në fuqi ne mund të pajtohemi ose të mos pajtohemi me një nen, por jemi të detyruar me e zbatua edhe ligjin në fuqi. Ka qenë obligativ për të krijuar fonde të mjaftueshme për pagesat e kësaj kategori. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e keni fjalën për pyetje shtesë, në qoftë se keni.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, ministër! Edhe unë nuk e vura në pyetje se a duhet t'i marrin veteranët pensionet apo jo, thjesht pyetja ishte "A do të respektohen ligjet të cilat janë në fuqi?"

Faleminderit për përgjigjen!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Po, zonja deputete, do të respektohet ligji dhe në funksion të zbatimit të ligjit ne i kemi siguruar diku edhe rreth 26 milionë euro shtesë për pagesat e kësaj kategorie, e cila thash se ka dhënë shumë për këtë vend edhe realisht nuk ka pasur nevojë kjo të ndodhë hiç, se është dashur në fillim të vitit me i pas fondet aty ku duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që koha, ose pyetjet e shtruara për ministra përkatës janë shtruar.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet nga seancat konstituive, të mbajtura më 3, 4, 10, 14 dhe 24 gusht, 10 shtator 2017 dhe të seancës së jashtëzakonshme, të mbajtur më 9 shtator. A ka dikush vërejtje? Nuk ka.

Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancës konstituive të mbajtur më 3, 4, 10, 14, 24 gusht dhe më 7 shtator 2017, dhe të seancës së jashtëzakonshme, të mbajtur më 9 shtator 2017.

I kisha lutur deputetët që janë jashtë salle të hyjnë në sallë, sepse kemi:

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

Siç e dini, partitë politike kanë dorëzuar, ose kanë caktuar, sipas formulës tradicionale të ndarjes së komisioneve. E dini që emrat e deputetëve mund të ndryshojnë sipas vendimeve të grupeve parlamentare në periudhën kohore sa zgjatë legjislatura sipas interesave të grupeve parlamentare

dhe është një votim më shumë formal në seancë, se sa ndonjë çështje e cila do të jetë problematike.

Sidoqoftë, edhe pak ta jap fjalën, Memli. Po besoj se e kemi kuorumin e duhur. Ne po diskutojmë pra, se janë paraqitur dy veta për diskutime.

Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 15, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit dhe në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2017 ka vendosur që seancës plenare t'ia propozojë propozim-vendimin për formimin e 14 komisioneve parlamentare.

Grupet parlamentare i kanë propozuar emrat e deputetëve për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të komisioneve parlamentare për formimin e 14 komisioneve parlamentare. Propozim-vendimi për formimin e 14 komisioneve parlamentare u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit. Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me grupet parlamentare e ka përgatitur dhe Kuvendit i ka propozuar për miratim emërtimin, numrin dhe strukturën e komisioneve parlamentare.

Nëse, dëshiron dikush të diskutojë në emër të grupeve parlamentare? Grupi parlamentar “Vetëvendosje”, zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka dërguar emrat në komisionet parlamentare, të gjitha komisionet parlamentare, vetëm se për shkak të zgjedhjeve lokale i kemi edhe dy vende të paplotësuara dhe sigurisht që pas përfundimit të zgjedhjeve lokale do t'i dërgojmë edhe këto emra.

Sa i përket propozimit për shmangie të Rregullores, a është tash? Po e them qëndrimin e grupit parlamentar. Për ne, së pari është i papranueshëm fakti se si ka dështuar ndryshimi i Rregullores së Kuvendit. Në mungesë të Rregullores së re të Kuvendit ne po detyrohemi që të bëjmë shmangie të Rregullores, sepse ju e dini që duhet të ketë amendament për të ndryshuar Rregulloren e Kuvendit. Mirëpo, po ndodh që me mocione të tilla ta shmangim Rregulloren për t'i bërë 14 komisione parlamentare.

Vetëm po dua të them, që është bërë një punë e madhe në Rregulloren e punës së Kuvendit, por ende, sot e kësaj dite, nuk dihet se kush ka qenë bllokues i Rregullores së re të Kuvendit. Ndoshta është mirë që kjo të theksohet, sepse Komisioni për Legjislacion dhe nën-komisioni për mandate është edhe zoti Zemaj këtu, ka bërë një punë megjithatë të mirë në këtë draft-rregullore.

Si “Vetëvendosje” e kemi kundërshtuar numrin e anëtarëve të komisioneve, që është bërë tash, është propozimi që të bëhen 11 anëtarë në komisionet funksionale. Për ne është shpenzim i

papranueshëm dhe i panevojshëm në fakt, që komisionet t'i kenë tash 11 anëtarë vetëm për shkak të akomodimit të interesave individuale përbrenda komisioneve parlamentare.

Zonja Dërguti, që është nënkryetare e Kuvendit e ka kundërshtuar si të tillë, mirëpo ka qenë e vetmja që e ka pasur votën kundër, dy paskan qenë edhe Kujtim Shala. Po më vjen mirë, që paskan qenë dy vota kundër, mirëpo megjithatë janë mbivotuar nga deputetët e Koalicionit qeverisës dhe a e dini pse? Sepse, ju s'keni pasur ku t'i çoni njerëzit e juaj. Keni pasur shumë probleme për komisionet parlamentare dhe pastaj për t'i kënaqur apetitet e secilit që ka pasur kërkesa dhe ambicie të sëmura, ju jeni detyruar tash të bëni shpenzime shtesë të buxhetit, për t'i rehatuar njerëzit në komisionet parlamentare.

Sigurisht, se kjo është e papranueshme për Lëvizjen "Vetëvendosje", por meqë kjo kërkon 2/3-at e deputetëve, domethënë të Kuvendit, sigurisht që ne do ta votojmë vetëm për qëllimin që të mos bllokojmë formimin e komisioneve parlamentare. Mirëpo, duhet ta dinë qytetarët se përse e kemi bërë. Fakti që jeni ndarë në tri grupe parlamentare është i qartë, mirëpo kjo është vetëm barrë shtesë për buxhetin e shtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Interpretim interesant. Të gjithë deputetët duhet obligativisht të jenë anëtarë të një grupi parlamentar, të paktën, të një komisioni parlamentar, më falni. E ka kërkuar fjalën në emër të Lidhjes Demokratike, s'është paraqitur askush. Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së kryetari i grupit, zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës unë kërkoj që para votimit të bëhet vetëm një ndryshim, një përmirësim ndoshta, ne e kemi 1 ndërrim të vendeve të dy deputetëve tonë, nëse është në pajtim me Rregulloren që para votimit t'ju them. Dhe, kërkojmë që në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacione dhe Ndërmarrësi, në vend të deputetit Bekim Haxhiu të vendoset deputeti Abdyl Salihu, ndërsa deputeti Bekim Haxhiu ta zëvendësojë deputetin Abdyl Salihu, në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Faleminderit! Kjo është e vetmja.

KRYESUESI: Faleminderit! E pranueshme, është çështje e lehtë. Ka dikush, është paraqitur zoti Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Poštovani predsjedavajući,

Poštovani narodni poslanici,

Ja sam i juče govorio. Na žalost nisam imao prilike da pred puno poslanika govorim, zbog verovatno razloga... imali su nekih važnih poslova, ali to što sam juče govorio danas ću samo da konstatujem.

Naime, kada su u pitanju komisije danas sam kao i većina poslanika dobio predlog za članove komisije. Ono što sam želeo da vam skrenem pažnju, sam juče rekao da nevećinske zajednice, odnosno srpska zajednica je ustavna kategorija. I ja nisam na izbore izašao kao poslanički klub nego kao predstavnik srpske zajednice. Isto upućujem kritiku i predstavništvu Skupštine Kosova kada pravi dogovore vezano za komisije ja poštujem pravilo za većinsku zajednicu da ostaje Pravilnik vezano za potrebu za poslaničkim klubom, kada je u pitanju nevećinska zajednica to nije potrebno.

Naime, imate Ustav. Ja verujem da vi dobro znate, ako ne znate ja ću i da vam kažem ko je član. Znači srpska zajednica, njihovi predstavnici doduše, su obavezni da budu... imaju zagantovana mesta u institucijama, pogotovo u komisijama u kojima se odlučuje o srpskoj zajednici.

Da budem iskren, ja sam očekivao da će moje kolege iz Srpske Liste imati malo više takta i da će od 14 komisija da nađu prostora za 10-g srpskog predstavnika, da nemam potrebe da tražim da se putem ustava to moje pravo iskoristi. Ali dobro, ovo je isto pokazatelj i namere kako će da se u budućnosti ponašaju. Znači, tražim samo da se ispoštuje ono što piše u Ustavu. Znači predstavnici naših građana, u ovom slučaju predstavnici nevećinskih zajednica, odnosno srpske zajednice imaju pravo da budu deo komisija, ne kao posmatrači, ne kao poslanici drugoga reda nego kao punopravni poslanici.

Zato vas molim da ovo ispravite. Ja ću stalno da vas pominjem vezano za ovo a ima još puno stvari koje ste uradili loše, ali ja sam juče skrenuo pažnju za ovo. Ja vas molim da ovo uzmete u obzir. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesues!

Përshëndetje, deputetë të nderuar!

Shfrytëzoi rastin prej kësaj foltoreje t'i falënderoj të gjithë votuesit, të cilët na kanë sjellë këtu! Prandaj, kemi obligim ndaj tyre.

Unë e kam marrë këtë listë, në të cilën është përgatitur ky propozim dhe sigurisht nuk pajtohem për arsye se ne nuk kemi fare të përfshirë në këtë listë. Dhe, mendoj që si deputet duhet me pas shansin. Propozimi im, nëse këtu diskutohet dhe rishqyrtohet kjo listë, është në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ose në Komisionin për Zhvillim Ekonomik dhe Infrastrukturë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Salihu. Paska dalë Salih Salihu, zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e kam para vetes këtu këtë propozim-vendimin për krijimin e komisioneve të përhershme. U përpoqa me e shikua pak me kujdes. Përnjëherë shoh se te pika e parë, domethënë te pjesa e parë, pika b, është Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim - 12 anëtarë.

Është njëfarë loje që shihet këtu. Të gjitha komisionet kanë 11 anëtarë ose 10 anëtarë, këtu janë 12 anëtarë. Për të plotësuar kërkesën kushtetuese 1/3-a, 1/3-a ... po ajo çka është interesant është edhe ndryshimi i gjuhës nga komisionet tjera. Këtu thotë: “nga komuniteti serb, nga komuniteti serb... “edhe ishte e drejtë vërejtja e zotit Petroviq, kush e përfaqëson vetëm komunitetin serb këtu, pse nuk është Lista serbe. Ajo është një grup parlamentar, mund të futet, por nëse thuhet “komuniteti serb”, duhet të jenë edhe të tjerët tjerë domethënë edhe grupi i zotit Petroviq. Edhe e dyta, pse ky komision t’i ketë 12 anëtarë? A është e vërtetë se vetëm plotësohen dëshirat për disa numra, që nuk është e domosdoshme, mund t’i ketë atëherë 9 anëtarë dhe gjuhësisht të mos përkthehet në këtë mënyrë, të bëhet në këtë mënyrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në rregull, atëherë në vazhdim po votojmë Propozim-vendimin për formimin e 14 komisioneve parlamentare, kryetarët, zëvendëskryetarët dhe anëtarët e tyre.

Sipas rregullave bëjmë votim elektronik. Në sallë janë të pranishëm 95 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 85 deputetë, për janë 82 deputetë, kundër 2, ka abstenuar 1. Faleminderit!

Kuvendi e miratoi Propozim-vendimin për formimin e 14 komisioneve parlamentare për Legjislaturën VI.

Sidoqoftë, unë mendoj që nuk rehatim të deputetëve në komisione, ata kanë obligime, por mendoj se formula nuk është e përshtatshme për kohën dhe mënyrën se si është i konfiguruar Parlamenti i Kosovës dhe për të ardhmen, unë mendoj se ne duhet ta ndryshojmë këtë formulë, se s’është as kushtetuese, as me rregulloren e Kuvendit, që të zbatohet domosdoshmërisht “formula spanjolle” e ashtuquajtur e kohës së UNMIK-ut. Pra, duhet me ia përshtat numrin e komisioneve edhe deputetëve që janë në Kuvend edhe fuqisë parlamentare normalisht, të grupeve parlamentare.

Me kërkesë të kryeministrit të Republikës së Kosovës, meqenëse i miratuam edhe komisionet, unë e jap një orë pauzë dhe seanca fillon në orën 13:00, që është - Interpelanca e kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendi, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,
Po fillojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Interpelanca e kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta informuar Kuvendin mbi akuzat publike të shfaqura ndaj ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotit Nenad Rikalo

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, për ta informuar Kuvendin mbi akuzat publike të shfaqura ndaj ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë.

Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit me kohëzgjatje prej 10 minutash dhe në mbyllje të debatit deri në 5 minuta, neni 44, pika 7 e Rregullores së Kuvendit.

Në bazë të nenit 44, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, kryeministri Ramush Haradinaj e paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash.

Koha e ndarë për diskutim sipas grupeve parlamentare dhe të deputetëve pa grup parlamentar është, si në vijim:

Lëvizja “Vetëvendosje”, 32 deputetë, 48 minuta,

Grupi Parlamentar i LDK-së, 27 deputetë, 40,5 minuta,

Grupi Parlamentar i PDK-së, 24 deputetë, 36 minuta, minus 6,5 minuta të ndarë për kryeministrin bëjnë 29,5 minuta,

Grupi Parlamentar i Listës serbe, 10 deputetë, 15 minuta, minus 3 minuta për kryeministrin, i ka 12 minuta,

Grupi Parlamentar i AAK-së, 9 deputetë, 13,5 minuta, 2,5 minuta për kryeministrin, 11 minuta,

Grupi Parlamentar “Nisma”, 6 deputetë, 9 minuta, minus 1,5 minuta për kryeministrin, do të thotë 7,5 minuta.

Grupi Parlamentar “6+”, 6 deputetë, 9 minuta, minus 1,5 minuta për kryeministrin, 7,5 minuta,

Pa grup parlamentar janë 6 deputetë, 9 minuta.

Unë shpresoj që do ta kemi një debat të arsyeshëm, por po ashtu shpresoj që Komisioni për Rregullore të Kuvendit dhe për Legjislacion do t'i shohë praktikën e kuvendeve e parlamenteve tjera sa i përket interpelancës si funksionon në vende tjera dhe do të ishte mirë që ta amendamentojmë pikën e Rregullores që ka të bëjë me interpelancën, sepse vërtet askund nuk ka asnjë praktikë të tillë çfarë e kemi ne.

Atëherë e ftoj deputetin, zotin Avdullah Hoti, që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, si propozues i interpelancës, ta marrë fjalën. Zoti Hoti, i keni 10 minuta.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

Në bazë të nenit 65.9 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe nenit 44, paragrafi 1, të Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka thirrur në interpelancë parlamentare kryeministrin Haradinaj.

Ai është thirrur për të dhënë sqarime për akuzat publike për maltretim dhe torturim të qytetarëve shqiptarë, të ndodhur në vitet e paraluftës, të ngrehura ndaj anëtarit të Kabinetit të tij, ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikalo.

Në kërkesën për ta thirrur kryeministrin në interpelancë, ne jemi nisur nga parimi se institucionet e Republikës së Kosovës duhet të udhëhiqen: nga njerëz me duar të pastra, nga njerëz që nuk kanë rënë ndesh me ligjin, aq më pak, dhe asnjëherë, nga njerëz që akuzohen për dhunë e torturë ndaj qytetarëve të Kosovës.

Ne konsiderojmë se duhet hetuar dhe sqaruar deklaratat publike të banorëve të lagjes “Dardania” në Prishtinë.

Këta qytetarë kanë shfaqur hapur dyshime se ky ministër i Qeverisë Haradinaj, dhe anëtarë të familjes së tij, gjatë viteve të okupimit dhe të masave represive të Millosheviqit ndaj shqiptarëve të Kosovës, kanë fyer, kërcënuar dhe përdorur dhunë ndaj qytetarëve shqiptarë.

Këto dyshime e meritojnë trajtim adekuat ligjor.

Këto dyshime bartin përgjegjësi politike për këtë ministër dhe për kryeministrin.

Si një popull që ka vuajtur shumë nga represioni dhe gjenocidi, populli i Kosovës nuk meriton që në Qeverinë e vet të ketë persona ndaj të cilëve ka akuza të tilla publike.

Sigurisht, ne e respektojmë parimin e presumimit të pafajësisë përderisa nuk vërtetohet vepra.

Por, në rastin konkret kemi të bëjmë me veprime, ndaj të cilave populli i Kosovës është shumë i ndjeshëm, duke qenë se vetë ka vuajtur nga represioni dhe gjenocidi.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon përgjigje nga Qeveria se si janë trajtuar deklaratat e qytetarëve që kanë ngrehur këto akuza publike.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ju rikujtoj dhunën e shfrenuar ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës pas fyerjes që ish-ministri Jablanoviq kishte bërë ndaj nënave gjakovare.

Deklarata e ish-ministrit Jablanoviq sigurisht se ishte e pamatur dhe e papranueshme për një politikan që mban post publik.

Ajo deklaratë u përdor si shkas nga opozita e atëhershme, përfshirë këtu kryeministrin e tanishëm, për t'i sulmuar institucionet e vendit.

Ish ministri Jablanoviq kishte kërkuar falje për gjuhën që e kishte përdorur.

Megjithatë, ky deklaram nuk mjaftoi dhe kryeministri Mustafa e shkarkoi atë.

Por, në rastin në fjalë të ministrit Rikalo, pavarësisht akuzave publike, ky ministër vazhdon të jetë pjesë e Kabinetit qeveritar.

Fakti që kryeministri nuk ka marrë ende veprime për këtë rast e reflekton pafuqinë e tij në vendimmarrje, si rezultat i varësisë së plotë nga grupimi politik prej nga vjen ky ministër.

Kjo gjithashtu reflekton degradimin institucional dhe krijon pasiguri te qytetarët ndaj Qeverisë së vet.

Mbi të gjitha, mosveprimi i kryeministrit në këtë rast përbën fyerje për qytetarët, përbën fyerje ndaj të gjithë atyre që mund të jenë maltretuar, sharë e fyer nga ministri Rikalo, nëse vërtetohen akuzat.

Siç mund të jeni në dijeni, më 18 shtator 2017, mediet informuan se zonja Fexhrije Beqiri, e cila jeton në lagjen "Dardania" në Prishtinë, mund ta kujtonte ende fytyrën e Nenad Rikalos.

Sipas medieeve, familja Beqiri tash e disa dekada jeton në katin e shtatë të një ndërtese në "Kurritz" të "Dardanisë". Në katin e njëjtë, numër 45, sipas saj jetonte dikur edhe Nenad Rikalo.

Gjithçka që mund të kujtojë zonja Beqiri lidhur me ministrin Rikalo, që atëherë ishte i ri, janë torturat dhe maltretimet që ai bënte ndaj banorëve shqiptarë.

Djali i saj, Festimi, deklaroi se ende i ka të freskëta përzjetimet për dy skena të torturave nga Rikalo. Njëra skenë përfshin drejtimin e armës ndaj babait të tij, tashmë të ndjerë.

Të gjithë ata që kanë pranuar të flasin para medieve, e kujtojnë ministrin Rikalo gjatë luftës të veshur me uniformë.

Banorët e kësaj ndërtese ishin shokuar kur e kishin parë Rikalon të renditur në mesin e ministrave të Qeverisë Haradinaj.

Të nderuar deputetë,

Këto janë akuza jashtëzakonisht të rënda. Janë akuza që shkojnë shumë më larg se sa një fyerje verbale e ish-ministrit Jablanoviq.

Si reagim ndaj këtyre akuzave, kryeministri Haradinaj deklaroi se në bazë të informatave të Prokurorisë së Shtetit, të AKI-së dhe Policisë, ministri Rikalo nuk ka qenë i përfshirë në veprime të tilla.

Megjithatë, disa ditë më vonë, më 26 shtator 2017, kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi deklaroi: “Prokuroria e Shtetit e ka hapur procedurën penale, pas informacioneve të marra në medie, por ende nuk kemi nxjerrë ndonjë aktvendim për nisje të hetimeve”.

Pra, po flasim për deklaramë kontradiktore.

Deklarimi i ngutshëm i kryeministrit ishte më tepër shfajësues. Ai ka zgjedhur t’u besojë më shumë deklaramëve të ministrit të tij, se sa qytetarëve të një ndërtese të tërë.

Ajo që është dashur të bëjë kryeministri është kërkesa e tij urgjente për hapje të hetimeve nga organet e rendit, e jo deklaramë të ngutshme shfajësuese.

Ajo që është dashur të bëjë kryeministri është shkarkimi i menjëhershëm i ministrit Rikalo deri në qartësimin e akuzave nga organet kompetente. Asnjërin nga këto veprime nuk janë ndërmarrë nga kryeministri Haradinaj.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh këtë situatë të krijuar, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në përputhje me nenin 44, paragrafi 4, pika (d), të Rregullores së Kuvendit, i fton deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta votojnë mocionin, si në vijim:

1. Kryeministri ta shkarkojë menjëherë ministrin Rikalo.
2. Institucionet kompetente, në përputhje me ligjet në fuqi, t'i hetojnë akuzat e ngrehura nga banorët e lagjes "Dardania" në Prishtinë ndaj ministrit Rikalo.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju falënderoj për vëmendjen dhe ju ftoj që, pas debatit që mund të kemi në vijim, ta përkrahni këtë mocion në nderim të atyre qytetarëve që, në rast se vërtetohen akuzat, mund të jenë maltretuar, rrahur, fyer e sharë nga ministri Rikalo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti!

Tani ftoj zotin kryeministër Ramush Haradinaj, që ta paraqes qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me çështjen e shtruar për interpelancë. Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të nderuar,

I nderuar zoti Hoti,

Grupi Parlamentar i LDK-së, që jeni parashtrues të kërkesës për interpelancë sot dhe që e keni shtruar çështjen, e cila u ngrit më herë edhe nga një koleg deputet, por e prita momentin që ta trajtojmë tani në interpelancë.

Po e lexoj një përgjigje të shkruar, e pastaj do të jemi këtu gjatë ditës.

Do të thotë, menjëherë pas njoftimeve publike, shqetësuese pra, për mundësinë që ministri i Bujqësisë, zoti Rikalo, të ketë qenë i involvuar keqtrajtimet gjatë luftës, si kryeministër i Republikës së Kosovës kam kërkuar informacione zyrtare nga mekanizmat përgjegjës dhe kam marrë përgjigjet, si vijon:

Pra, përgjigjet edhe shkresat zyrtare i kam në këtë fajl, por po ju citoj prej tyre çka kanë thënë një nga një.

Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë (DIA) e Ministrisë së Punëve të Brendshme është përgjigjur kështu: Nuk ka raste të raportuara në sistemin informativ të Policisë së Kosovës. Tash s'kemi rast të raportuar në sistemin informativ.

Nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kam marrë këtë përgjigje, kërkesa ka qenë e imja: Në lidhje me kërkesën e parashtruar sot ju informojmë se në databazën e Prokurorisë

Speciale të Republikës së Kosovës nuk evidentohet asnjë shënim apo rast që ka të bëjë me informacione që po qarkullojnë për personin Nenad Rikalo.

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, ata fillimisht shpjegojnë, kur ka të thëna ose informata të karakterit të tillë, ne i dorëzojmë në Prokurorinë e Shtetit dhe thotë kështu: AKI nuk ka dorëzuar ndonjë informatë në Prokurorinë e Shtetit për veprën e dyshuar, krime lufte, të raportuar në medie për personin Nenad Rikalo.

Përveç këtyre, një informatë e ka dhënë edhe Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut. Sipas KMLDNJ-së, në buletinet për vitet 1999-2000-2001 nuk ka ndonjë dëshmi, deklaratë apo provë që e inkriminon Nenad Reikallon për dhunë ndaj shqiptarëve në periudhën e luftës 1998-1999.

Pra, reagimi im nuk ka qenë me nguti, por ka qenë obligim për të reaguuar. Pra, kur kanë dalë lajmet shqetësuese që një pjesëtar i Kabinetit mund të ke qenë, ose i ka kryer këto vepra, unë e kam kryer detyrën zyrtare dhe u kam kërkuar informatë qëndrim zyrtar, mekanizmave të vendit.

Në përputhje me këto të gjetura, gjendja është kështu si është sot, dhe kjo gjendje si e këtillë nuk është e krijuar nga unë, ose nga njëri nga ne, por është gjendje e sistemit tonë, e cila konfirmon si vijon. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, zoti Sveçla e ka fjalën. Nëse nuk doni të jua ngatërroj emrat dhe t’ia merrni minutazhin njëri-tjetrit, është mirë ta bëni renditjen dhe minutat sa t’ia lë secilit deputet. Nëse doni, nëse jo, ju e dini që ka mundësi t’i shpenzoni minutat tjerët.

XHELAL SVEÇLA: Të nderuar qytetarë,
Dje folëm se çfarë lloj Qeveria tash në Kosovë është krijuar bashkë me Listën serbe dhe rrjedhimisht peng i Serbisë për hir të pushtetit.

Por, jo vetëm me kaq, por edhe për ta dyshuar për krime lufte ministrin e Bujqësisë, Nenad Rikalo.

Tashmë janë lajmëruar rreth 20 dëshmitarë, të cilët janë marrë në pyetje nga hetuesia, apo kanë dëshmuar në Prokurori për të bërat e Nenad Rikalos. Disa nga këta dëshmitarë edhe publikisht në medie i kanë përshkruar ngjarjet rrëqethëse nëpër të cilat ata kanë kaluar për shkak të dhunës,

torturës e maltretimeve të Nenad Rikalos së bashku me të dyshuar të tjerë, pjesëtarë të njësiteve të operacioneve speciale.

Të gjithë dëshmitarët deklarojnë se Nenad Rikalo gjatë kohës së bombardimeve në vazhdimësi është parë me uniformë ushtarake, me kapelë të kuqe e shiritin e kuq në krah, e kallashin e tij në supe.

Ata banorë të lagjes “Dardania” apo studentë që kanë jetuar andej, në dëshmitë e tyre, ndër të tjera, përmendin edhe thyerjet e lokaleve, si për shembull të marketit “Hana”, banesat, garazhet e veturat e shqiptarëve në “Dardani”.

Po ashtu, ata përmendin se si Nenad Rikalo bashkë me Nenad Marinković, me kamion kanë shpërndarë armatim për serbët, banorë të “Dardanisë”.

Ai njihet edhe për gjuajtjet e tij në ajër, ku ende janë predhat e kallashnikovit të tij në strehën e ndërtesës.

Gjithnjë sipas dëshmimeve të dëshmitarëve, Nenad Rikalo ka qenë pjesë e bandave që ka rrahur shqiptarët mbi “Kurriç”, duke verifikuar etnicitetin e kalimtarëve të rastit nëpërmjet pyetjeve të kota, nëse nuk u përgjigjen mirë serbisht, ka pasuar dajakun.

Unë tash dëshiroj që ta lexoj një dëshmi të dëshmitarëve, meqenëse ata nuk kanë pasur mundësi të jenë të pranishëm këtu:

“Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,
Juve që ju votuam që të jeni zëri ynë.
Po e adresojmë këtë lutje apo kërkesë te ju nëpërmjet deputetit të Lëvizjes ‘Vetëvendosje’.

Deklaratat tonë në lidhje me rastin e Nenad Rikalos, të cilat janë publikuar nëpërmjet medieve, janë më se të vërteta dhe do të ndërmarrim secilën rrugë ligjore që të zbardhet e vërteta në fjalë.

Ne u deklaruam me plot përgjegjësi dhe jemi dëshmitarë të krimeve të Rikalos.

Dhunuesit nuk kanë as nacionalitet, as përkatësi kombëtare, apo fetare. Dhunuesit dhe kriminelët e përfaqësojnë vetveten dhe ashtu shpresoj të trajtohet ky rast pa pasur përfitime apo dëmtime partiake, apo nxitje e urrejtje ndërmjet nesh që sot e gëzojmë lirinë në shtetin tonë.

Rikalo, që sot e keni ministër të Bujqësisë, në vitin 1998 u përkiste grupeve kriminale që dhunonte, maltretonte e dëbonte shqiptarë.

Paramilitarët dhe kriminelët tjerë i furnizonte me armatim për të kryer krime ndaj popullatës civile. Ne nuk duam që ky, i cili në vitin 1998 na ka dhunuar, tash të na përfaqësojë.

Një kriminel i shtetit nuk na jep ndjenjën e pavarësisë e as të lirisë, por na jep ndjenjën e dhunës, frikës dhe regjimit.

Andaj, deputetë të nderuar, të cilët sot këtu jeni zëri ynë, zëri i dëshmitarëve okularë, zëri i atyre që u përdhunuan, masakruan e u dëbuan.

Kërkojmë nga ju t'i i dilni Zot këtij vendi e të na dilni zot neve që kemi pa tmerrin me sy nga Nenad Rikalo. Ta shkarkoni ministrin e Bujqësisë, Nenad Rikalo, dhe njëherësh kërkojmë nga Prokuroria e Republikës së Kosovës që për një hetim pa ndikim politik, po për hir të lirisë që sot e gëzojmë, ta fuqizojmë atë liri më shumë duke zbardh rastin që fshehët që 17 vjet.

Në emër të dëshmitarëve, sinqerisht Blindi Zymi dhe Vllaznim Beqiri”.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme të dihet nëse ka pasur deklarata kontradiktore të këtyre dëshmitarëve. Siç e përmenda edhe më herët, janë rreth 20 prej tyre.

Deklarimet e tanishme të tyre përputhen dhe dëshmojnë se Nenad Rikalo ka qenë pjesë e krimit.

Përveç dëshmive të dëshmitarëve, tashmë ka edhe dëshmi materiale për përfshirjen e familjes së tij në aktivitete policore ushtarake me qëllim spastrimin etnik të Kosovës nga shqiptarët.

Ndër to është lista e 159 oficerëve të mobilizuar në organizatën bazë “Dardania”, Prishtinë. Babai i tij Radoslavi është i 129-ti, e edhe të dhënat, si adresa e numri i telefonit, përputhen me vendbanimin e atëhershëm të tyre.

Po ashtu, sipas dëshmitarëve, ka edhe dëshmi materiale, si fotografi, maska e thikë që i janë dorëzuar Policisë Ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

I ftoj ata të cilët i kanë pranua që të lajmërohen në Prokurori dhe t'i dorëzojnë ato, apo të tregojnë se ku i kanë dorëzuar ato.

Ndoshta këtu do të mund t'i ndihmonte drejtësisë Kadri Veseli me SHIK-un e tij të famshëm, i cili dje, për të kërcënuar shqiptarët, e kishte plot gojën me prova. Normalisht që është përgjegjësi primare e instrumenteve të shtetit t'i sigurojnë ato prova, në mënyrë që Nenad Rikalo, jo vetëm të shkarkohet nga Qeveria, por edhe të burgoset e të dënohet nga gjykatat tona.

Po ju përkujtoj se vetëm me dëshmitarë e pa prova janë dënuar vëllezërit Kiçina, është dënuar komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Sylejman Selimi, ka mbajtur burg Sami Lushtaku, e shumë ushtarë të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kjo i bie që drejtësia është një për shqiptarët, e tjetër është për serbët. Dikush është në burg, e dikush ministër.

Unë e kam një pyetje për prokurorin e Shtetit: A është marrë Nenad Rikalo në pyetje lidhur me dëshmitë e banorëve të lagjes “Dardania”?

Po ashtu, unë e kam një pyetje për ministrin Nenad Rikalo: A ka qenë babai i tij, Radosllav Rikalo, pjesëtar i organizatës bazë të quajtur “Dardania” në Prishtinë, të oficerëve ushtarakë rezervë, si dhe përgjegjës i pikën nën “Kurriz”, ku janë disklokuar tanket gjatë bombardimeve.

Kryeministri Haradinaj ka deklaruar se e kanë siguruar Prokuroria e Shtetit, AKI-ja dhe Policia e Kosovës se ministri Rikalo nuk ka qenë i përfshirë në ato veprime siç kanë dëshmuar banorët e lagjes “Dardania”.

Pyetja është: A ka përfunduar procesi i verifikimit, që do të thotë se hetuesia e Prokuroria po bëjnë punë kot, apo deklarata juaj e parë ka qenë vetëm lajthitje për opinionin?

Tash Nenad Rikalo duhet të përgjigjet për këto akuza para drejtësisë, ose Ramushi duhet siguruar që kjo të ndodhë, në të kundërtën zoti Haradinaj duhet të japë dorëheqje, se edhe ashtu me deklaratimet e tij është bërë dorëzan për të. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj, e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E para, motivi që i shtyn disa për ta mbrojtur të drejtën e viktimës është me siguri i ndershëm, por nuk besoj që të gjithë janë këtu për t’i mbrojtur viktimat, se kur janë dënuar këta komandantët jeni gëzuar dhe keni festuar.

E dyta, zoti i nderuar Sveçla dhe ju të tjerë, nëse duam të luajmë me fjalë luajmë, por ditën kur ka ndodhur ngjarja unë kam qenë në detyrë, i kam pyet ata që janë në detyrë. Ju tregova më herët kush janë, institucionet një nga një, edhe te Prokuroria zotëri i nderuar. Reshat Millaku, kryeprokuror, e shpjegon gjendjen atë ditë qysh është. Njëkohësisht edhe AKI-ja. Nëse këto doni t’i vini në pikëpyetje dhe të më quani mua avokat të dikujt, atëherë i hapim letrat, po këta që po flasim ia kishin zënë banesën këtij pas luftës dhe ia kishin marrë do para për t’ia lëshuar banesën. Nëse bash po doni, nuk jam avokat i askujt. Besoni, kurrë nuk kam folur me këtë për këto sende, por edhe ne jemi shqiptarë, na dhembin këto tema, prandaj kemi pyet dikah. Kurrë në jetë nuk e kam folur me të asnjë fjalë për këtë temë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, pasi po doni, po minutat i llogariten partisë suaj.

XHELAL SFEÇLA: Zoti Haradinaj, është insinuatë shumë e keqe që ne jemi gëzuar kur janë arrestuar komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ne e kemi dëshmuar shumë shpesh se jemi kundër këtyre arrestimeve. Edhe vetë votimi ynë kundër Gjykatës Speciale, e cila është e drejtuar drejtpërdrejtë në ndëshkimin apo etiketimin e luftës çlirimtare, e dëshmon këtë.

Për sa i takon asaj familjes, ju keni kontakt drejtpërdrejtë me Prokurorinë dhe me hetuesinë, prandaj ju kisha kërkuar të pyesni për numrin e saktë të dëshmitarëve dhe për atë çfarë thash më herët, nëse u përputhen dëshmitë atyre apo jo, se këtu nuk bëhet fjalë për një familje, e cila mund të mos e ketë uzurpuar banesën e tij, por bëhet fjalë për dëshmi të shumë banorëve e studentëve të lagjes “Dardania”, të cilët kanë pranua të dëshmojnë edhe para institucioneve që ju i udhëhiqni.

KRYESUESI: E do prapë fjalën, zoti kryeministër? Bën, se ti ke të dejtë sa herë të duash të diskutosh. Zoti Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Nuk besoj që dikush këtu nuk do ta dijë të vërtetën, të pakën në këtë sallë. Nuk i dhemb askujt e vërteta, dhe nëse për këtë keni dilema, unë nuk di si t’i heq ato.

Mirëpo, është e vërtetë që kur janë dënuar komandantët me radhë, varësisht prej përkatësisë partiake, ose prej momentit politik, nuk kanë qenë qëndrimet e dinjitetshme ndaj tyre. Kemi dëgjuar edhe akuza këtu në këtë sallë, unë kam qenë deputet, ndaj komandantëve, qysh janë kështu-ashtu, dhe nuk besoj që jam kah them diçka të re të paktën për këtë temë.

Njëkohësisht, sa i përket gjykatës, vota juaj dhe e imja nuk dallon, besoj e mbani në mend. E kemi pasur një votë. Mirëpo, edhe në momentin e sotëm unë jam për të vërtetën, cilado qoftë, e vërteta është e mirë. Ne kemi qenë dhe jemi pala e viktimizuar në luftën e Kosovës, kemi aq shumë dhimbje, të gjithë e dimë cilat janë. Unë kam qenë edhe subjekt i persekutimit të shumë natyrave, nuk dua të marr rolin e prokurorit, unë s’dua të bëhem prokuror, viktimizimi i dikujt për ndonjë qëllim të caktuar. Nëse nuk është e vërtetë, e dini në çka kalon, të paktën ne shqiptarë jemi, nëse e vërteta është ajo që është, të gjithë e respektojmë, por nuk ka nevojë që të bëjmë yrysh, ta viktimizojmë kurrkënd pa e ditur çka jemi duke bërë.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i LDK-së, kush e do fjalën? Zoti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Të gjithë ju të pranishëm,

Është e qartë që si ligjvënës, mbi të gjitha si përfaqësues i qytetarëve të vendit, jemi të detyruar ta mbrojmë interesin e përgjithshëm të qytetarëve për një vend ku sundon rendi dhe ligji dhe kjo nuk ka dilemë. Kërkesat për të kaluarën, edhe individuale, edhe grupore, por edhe ajo etnike, sigurisht që u takon organeve të drejtësisë dhe të sigurisë, të cilat kanë detyra të qarta sipas Kushtetutës dhe ligjit.

Interesi ynë i përgjithshëm është të kemi qeveri me duar të pastra, pa marrë parasysht grupet, ato politike dhe domosdoshmërisht jemi si vend që duhet të flasim edhe për ato etnike. Asnjëherë deri më tani sidomos, po flas në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk kemi shfaqur ndonjë tendencë qoftë ndaj individit apo ndaj grupit politik. Ajo që ka qenë shqetësuese dhe që nuk do të doja që të merrte as analogji, as konotacion politik, sepse ne i kemi të freskët veprimet opozitare ndaj një ish-ministri për një gjuhë arrogance dhe fyese të përdorur, por këtë analogji nuk do ta përdorë grupi politik Lidhja Demokratike e Kosovës, as të dëmtojë qeverinë, as të gjuajë gaz molotov, as të thërrasë në protesta, por të kërkojë drejtësi dhe të kërkojë verifikim të kaluarën e ministrit Rikalo, që sot për ko incidencë është ulur afër jush, në vend të zëvendëskryeministrit. Sigurisht kjo tregon edhe atë çështjen që ne po e flasim kështu, jo vetëm për të krijuar besueshmërinë e partneritetit të koalicionit, por varësinë që e keni nga ky grup politik për ta mbajtur qeverinë në pushtet, dhe kjo nuk ka dilemë.

Në aspektin ligjor, ne i kemi dëgjuar deklaratat e qytetarëve, nuk është një, po të ishte një çdokush, çdo individ, besoj që nuk do të ishte në lajthitje që ta vërë në kontest apo ta bëjë një deklaram publik nga një individ. Janë dhjetëra banorë, të moshave të ndryshme, të rinj dhe të vjetër që e flasin të njëjtën ngjarje, e bëjnë të njëjtin përkrahim për të njëjtin individ, për të njëjtën familje, për të kaluarën e tyre, sepse ata që kanë jetuar në Prishtinë, sidomos gjenerata e studentëve '96, '97, '98, pa dashur të bëjmë ndarje regjionale, ka qenë vështirë që dikush, një student të deklarojë që është i komunës së Deçanit apo i Drenicës dhe këtë e dinë të gjithë nëpër çka kanë kaluar.

Ka qenë shumë vështirë, sidomos t'i thuash që po studioj Fakultetin Juridik nëse je përballur me një individ, i cili supozohet që është pjesë e atyre grupeve, apo dhe me policë dhe paramilitarë serbë. Dhe, kjo është ajo që ne po kërkojmë që qeveria të jetë e dinjitetshme, institucionet tona të jenë me duar të pastra, pa marrë parasysht se për kënd dhe si po apostrofohet. Deklaratat e kryeministrit se janë zyrtare, mund të jenë të vërteta, janë të vërteta, edhe për mendimin tim ligjor, por ato janë në momentin kur ju i keni kërkuar, jo në momentin kur dëshmitarët kanë shkuar dhe kanë deklaruar, jo në momentin kur policia dhe prokuroria ka marrë urdhër ligjor për të filluar hetimet. Ne tash duhet të marrim përgjigje se ku kanë shkuar, cila është e vërteta? Unë personalisht dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës është shumë i interesuar që ta dijë të vërtetën, pa dashur të shkaktojë asnjë dilemë, as rreth individit, as qeverisë, as Grupit Parlamentar etnik serbë që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Dhe, kjo është ajo që po kërkojmë, për këtë arsye kemi kërkuar interpelancë. Të mos i përziejme temat, tregoni kush është ky individ? Pse është në përbërjen qeveritare? Le të tregojë Grupi Parlamentar serb pse ky gjendet si ministër, pse deri sot nuk ka pasur asnjë akuzë ndaj asnjë personi nga komuniteti, as nga ministri për rrahje, maltretime, sulme ndaj shqiptarëve etnikë në Republikën e Kosovës. Një lagje e tërë fol për veprimet e këtij njeriu, jo një individ, jo një pjesëtar i një partie politike. Studentët që pretendohet që janë rrahur nga ky janë nga Dukagjini, kanë emër, kanë mbiemër, emrat e tyre janë në organet e drejtësisë. Anëtarë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fatkeqësisht, kjo është publike dhe unë e thërras edhe një herë Prokurorinë e Shtetit, sepse ju është e kot t'ju thërrasim në këtë moment, se mbroni interesa të tjera, është shumë e vërtetë, është edhe e arsyeshme nga ana juaj, por i thërras organet e drejtësisë ta thonë fjalën e vet sa më shpejt dhe ta qartësojnë pozicionin e ministrit Rikalo: a është e vërtetë apo nuk është e vërtetë që ky si person në moshën çfarë e ka pasur, në rrethana çfarë ka kaluar Kosova ka rrahur, ka maltretuar studentë shqiptarë? Mund të ketë dëshmi edhe për banorë edhe për bëma të tjera që i përmendën edhe kolegët të tjerë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Memli Krasniqi.

Zoti Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Edhe një herë, që të kemi njëfarë qartësie, e vërteta është interes i të gjithë neve, e nëse ajo e vërtetë që mund t'i besojmë ndonjëherë nëse vjen, atëherë ne flasim për një situatë tjetër. Në gjendjen e sotme unë e kam bërë atë që e kam vlerësuar se është e asaj kohe menjëherë. Pra nuk kam pritur për kurrgjë tjetër, por menjëherë kam kërkuar çka ka, a ka diçka dhe kam këtë gjendje. Bazuar në këtë unë nuk po predikoj që mund të ketë dëshmi ose po thonë pikëpamjet e tyre ose brengat e tyre për këtë temë që janë të një partie, nuk thashë ashtu dhe nuk mendoj që mund të jenë të një partie, kushdo qofshin. Vetëm ka një situatë interesant, analogjia e ministrave, ne mund të supozojmë edhe të jetë edhe të mos jetë, nuk është thelbi aty në këtë rast.

Ne nuk po duam as të tregojmë një mënyrë tjetër të punës, as nuk po duam të kopjojmë çka ka ndodhur në të kaluarën, por Parlamenti i vendit dhe ata që janë njerëz që marrin vendime për Kosovën në tërësi, të paktën ne s'guxojmë të bëjmë gabime të tilla çfarë kanë ndodhur mbi ne në të kaluarën. Unë vetëm prej kësaj ruhem. Mbi ne ka pasur, ta kanë bërë me gisht dhe është ditur, ajo koha që po flasim, unë s'po dua të bëhem i njëjtë, pra këtë s'dua ta bëj dhe kur ka situata të kështilla, këtë ekuilibër, meqë kemi marrë përgjegjësi, do ta ruaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Minutazhin e partisë e ke. Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Pajtohem plotësisht, zoti kryeministër, me këtë çka po thoni. Gjithçka çka po kërkon Lidhja Demokratike e Kosovës është ta shkarkoni këtë ministër, t'i jepni hapësirë

drejtësisë ta thotë fjalën e vet. Dhe, kjo do të duhej të ishte për çdo ministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës, por këtë nuk mund ta bëni, sepse Qeveria nuk është me duar të pastra, njerëz janë pjesë të aktakuzave për krime dhe për korrupsion.

KRYESUESI: Zoti Zemaj, ju e dini që askush s'ka imunitet, as deputetët, as ministrat për t'u thirrur nga drejtësia, kështu që është mirë ta keni parasysh këtë. Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Çfarëdo akuze që ndërlidhet me kohën e luftës në Kosovë, veçanërisht me ushtrimin e dhunës dhe me krimet e mundshme kundër qytetarëve civilë, duhet të shqyrtohet hollësisht.

Në këtë drejtim nuk bën përjashtim askush, pavarësisht përkatësisë etnike, pozitës sociale apo publike, apo çfarëdo statusi tjetër. Por, në një shtet ligjor kjo është përgjegjësi e organeve të hetuesisë dhe të rendit dhe ligjit. Në rastin konkret jemi njoftuar me iniciativën e kryeministrit për të kërkuar informacione nga të gjitha organet relevante dhe me konkludimet që ka prezantuar më herët dhe që prezantoi edhe sot se në rastin e ministrit Rikalo nuk ka informacione për veprime antiligjore të kryera gjatë luftës. Ne theksojmë se kushdo që ka dëshmi dhe informata për çfarëdo veprimesh të kundërligjshme, veçanërisht që lidhen me periudhën e luftës, duhet t'i ofrojnë ato para organeve përkatëse dhe nga deklaratimet që dëgjova nga kolegët, kjo paska ndodhur dhe ne i mirëpresim.

Zoti Rikalo, siç jemi njoftuar edhe nga deklaratat e tij, ka qenë i involvuar në jetën publike në Kosovë gjatë gjithë periudhës së pasluftës, qoftë si aktivist i shoqërisë civile, qoftë si përfaqësues politik në KQZ gjatë dy mandateve, tani edhe si ministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Domethënë, ky nuk është shfaqur sot në publik, por gjatë gjithë këtyre viteve, siç ka deklaruar vetë, ka bashkëpunuar me shumë njerëz që janë aktivë edhe sot në politikë dhe që janë pjesë e këtij Kuvendi. Por për çudi asnjë akuzë ndaj tij nuk qenka bërë deri në ditët pas emërimit të tij si ministër në Kabinetin Haradinaj.

A domethënë kjo që akuzat ndaj tij janë të motivuara nga lufta politike brendashqiptare, apo vërtet ka bazë për këtë, për këtë s'duhet dhe s'mund ta paragjykojmë sot, do të ishte shumë e padrejtë. Por, besojmë që çfarëdo hetimi për deklarime tashmë publike duhet të bëhet jashtë politikës nga organet e drejtësisë, sepse askush, në asnjë mënyrë, nuk duhet të jetë mbi ligjin, as ministrat, as deputetët, as çfarëdo individ, çfarëdo qytetari i vendit tonë. Pra, në parim ne jemi të qëndrimit se askush nuk mund të jetë pjesë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nëse ka qenë i

përfshirë në çfarëdo krimi apo veprime antiligjore ndaj qytetarëve të vendit tonë dhe nëse diçka e tillë dëshmohet, kryeministri duhet të marrë masa të menjëhershme.

Por, po ashtu para kësaj besojmë se një përfundim të tillë mund dhe duhet ta nxjerrin vetëm organet kompetente të drejtësisë dhe sundimit të ligjit. E kemi dëgjuar deklarin e kryeprokurorit të shtetit, që ka qenë publik se do të fillojë hetimin për akuzat e ngritura në publik dhe se do të intervistojë dëshmitarët potencialë dhe shpresojmë se ky proces do të konkludohet sa më shpejt. Kjo është e nevojshme edhe për shmangur keqpërdorimin politik që mund t'i bëhet kësaj çështjeje. Po ashtu, ne jemi dëshmitarë se në vendin tonë janë kryer procese gjyqësore edhe kundër ushtarëve dhe udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe shumë prej tyre janë dënuar me dëshmi shumë problematike dhe të kontestueshme, bile edhe pa akuza për pjesëmarrjen në dhunë, por vetëm me akuza për prezencë fizike gjatë rasteve të deklaruara si të tilla.

Dhe, ne pavarësisht qëndrimeve tona personale, politike, partiake, e kemi pranuar këtë drejtësi dhe nëse tashmë e kemi pranuar këtë standard të drejtësisë, atëherë i njëjti duhet të vlejë për secilin dhe nuk besoj që ka ndonjë njeri këtu në këtë Kuvend që e konteston një qëndrim të tillë. Prandaj, e ritheksoj se ne u japim mbështetje organeve të drejtësisë për të përmbyllur sa më parë një hetim profesional dhe për të nxjerrë të vërtetën që e sqaron përfundimisht çështjen e ngritur në këtë interpelancë të sotme dhe duke ftuar secilin që të shmanget nga tentimi për të keqpërdorur politikisht për luftën tonë të brendshme politike këtë çështje, e cila meriton një trajtim më serioz se kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe, kush e do fjalën? Zoti Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani predsedavajući Skupštine,

Poštovane kolege poslanici,

Poštovani premijeru i članovi Vlade, dame i gospodo,

Danas ovde po ko zna koji put na ovom mestu je tema nešto što ne bi smelo da bude tema skupštinskih rasprava. Kažem ne bi smelo, jer se radi o čisto političkoj temi, koje izaziva podeljenost među narodima na Kosovu, tema koja služi kao potreba predizbornoj kompaniji, jer oni koji su pokrenuli nemaju ideju o tome kako Kosovo treba da se ekonomski razvija, šta treba da se uradi da svi građani Kosova žive bolje, i ono što je najvažnije, kako da neko konačno prihvati da Srbi treba da budu ravnopravni građani Kosova i da se na Srbe ne upire prstom i na nas kao njihove predstavnike.

Ovde danas postavljam pitanje svima nama poslanicima: Gospodo poslanici, jesmo li mi poslanici Skupštine ili smo mi sudije, tužioc, policija? Da li je ovo mesto na kome treba da

donosimo zakonske regulativu u cilju boljeg života ili ovo mesto na kome će se Srbi napadati, Srbima suditi, Srbima osuditi i Srbe optuživati.

O čemu ovde danas govorimo? O kakvom apsurdu u biranje prstovima na nekoga zašto je Srbin, isto ono upiranje kao što je učinjeno sa Bogdanom Mitrovićom samo što se Bogdan hteo da se vrati svojoj kući.

Kakvo društvo vi gospodo pokrećite ovo pitanje danas želite da i izgradite na Kosovu. Dokle planirate da se bavite temama poput ove. Ovo je tema bez teme, o tome se danas dešava na ovo mesto.

Bili smo fizički napadani, prstenu je nasilje gde god je za to imalo mogućnosti, šta je sledeće, šta posle suzavca, šta posle čupanja za kosu naše kolegice, šta posle verbalnih napada, jer vidite vi o kakvoj apсурdnoj temi mi govorimo ovde.

Odgovor na pitanje znam, a isto tako i znam da vi nikada odgovor na ovo nećete imati. Želim da se obratim svim građanima Kosova danas zbog toga što u poslednje vreme Srpska lista etiketira kao neko ko želi da opstruiše rad ovih institucijama u kojemu radimo. To je potpuno iste kao da pljujemo u vis, mi ne želim da opstruišemo rad ovih institucija, mi smo jedno od najodgovornijih poslanička grupa u ovoj Skupštini. Imate gospodo arhivu Skupštine, možete da vidite i da pogledate da li smo nekada bili protiv onoga što je opšte dobro za sve građane Kosova. Nikada, želim da vam kažem isto da nijedna politička partija, politička grupacija ne može individualno da uradi za bolje sutra na Kosovu ništa, bolje sutra za Kosovo i kosovsko društvo možemo da uradimo samo zajedno, samo zajedno možemo sve, i što pre prihvatimo tu činjenicu, da samo zajedno možemo sve, onda ćemo krenuti za bolju budućnost i biće bolje za sve naše građane.

Juče smo imali ovde izlaganje kolege iz LDK koji i kaže da razmišlja da li će danas da glasa za ratifikaciju sporazuma koji građanima Kosova donosi 75 miliona €. Ja vas molimo gospodo, molimo vas sve da se uzdignemo i za individualnih interesa, političkih interesa i da zajedno počnemo bolju budućnost Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, Sasha! Grupi Parlamentar i AAK-së, ju minutazhin e juaj sa herë të doni mund ta shfrytëzoni. Zoti Avdullah Hoti e ka fjalën, replikë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

I nderuar deputet,

Kërkesa e Grupit tonë Parlamentar ka qenë dhe mbetet e thjeshtë: të sqarohen akuzat publike që qytetarët e lagjes “Dardania” kanë bërë ndaj një anëtari të Kabinetit qeveritar. Nuk është vendi këtu për të dhënë leksione për mënyrën se si duhet të funksionojë shoqëria kosovare, atë që e

thoni ju, ne e kemi tejkeluar në qershor të vitit '99, kur shoqëria e Kosovës i ka hapur dyert për ju dhe për të gjitha komunitetet për t'u integruar në institucionet e Kosovës.

Nuk është tema e sotme kjo, as mos mbani leksione se si Lidhja Demokratike është deklaruar për marrëveshjen IPA. Të gjithë e dimë rolin e secilit grup parlamentar këtu në Kuvend. Leksione të tilla për neve janë të papranueshme, interpelanca është e thjeshtë, e vlerësoj fjalën e kryeministrit dhe të deputetëve të tjerë që ne të koncentrohemi në temë, të japim sqarime në temë, të shohim mandej a do të votohet mocioni, të cilin ne e prezantuam si grup parlamentar. Pra, pyetja është e thjeshtë, kërkesa jonë është e thjeshtë që ky anëtar i Kabinetit të shkarkohet përderisa nuk qartësohen akuzat publike të banorëve të sot janë gjallë.

U tha në këtë foltore nga njëri prej deputetëve që janë dënuar komandantë, ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës vetëm me akuza verbale, pa asnjë dokument. Akuza që janë bërë publike, ata njerëz sot jetojnë atje në Dardani, ne kërkojmë nga kryeministri të japë përgjigje se çfarë veprimesh janë ndërmarë në këtë drejtim, sepse nuk është e udhës t'u nxirren deputetëve qëndrimet dhe letrat e AKI-së, se s'ka pasur AKI-ja letra as për Jablanoviqin, as për plot të tjerë, por akuzat publike kur janë thënë, janë hetuar deri në fund dhe janë marrë masat e duhura.

Ne kemi vendosur standard në qeverinë e kaluar, duke mos lejuar asnjë anëtar të Kabinetit të jetë në Qeveri, ndërkohë që ka rënë ndesh me ligjin ose ka akuza publike as për korrupsion, e lëre më për krime ndaj njerëzimit, prandaj ju kisha lutur që të koncentrohemi në atë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Isufi, e keni fjalën.

AHMET ISUFI: Të nderuar kolegë deputetë!

I nderuar kryeministër,
Kryesues i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,

Ne e kemi një sintagmë që zakonisht e përdorim: "Askush mbi ligjin", prandaj pavarësisht nga bindjet politike, nga përkatësia nacionale, nga ajo që ka të bëjë me zhvillimin e strukturave në Kosovë, nuk duhet t'i shmanget ligjit. Por, po ashtu kisha dashur që kjo interpelancë e thirrur vërtet të ketë motivin e saktë, të qartë, të kthjelltë se është thirrur për të ndriçuar diçka që është obligim i organeve të drejtësisë në Kosovë.

Të gjithë ata qytetarë që disponojnë të dhëna, jo vetëm në rastin konkret, por ne konsiderojmë se është bërë shumëçka në Kosovë ndaj popullatës civile, të nxirren para drejtësisë dhe të dënohen të gjithë ata që kanë mundur të bëjnë veprime jashtëligjore dhe kriminale. Por, një porosi e kam si deputet i Parlamentit të Kosovës, edhe si kolegë, çdo tentim për t'i dhënë ngjyrim politik më shumë e mjegullon se sa që mund ta nxjerrë të vërtetën e sheshtë. Dhe dijeni një gjë se askush më shumë se ata që kanë luftuar për të drejtën dhe të vërtetën nuk është i interesuar që vërtet në

Kosovë të ndodhë ajo që është dashur të ndodhë qysh më herët, të gjitha krimet që kanë ndodhur të sqarohen dhe shoqëria e Kosovës të ndjehet e shkarkuar nga ngarkesat emocionale, të cilat i ka shkaktuar okupatori gjatë luftës. Dhe, në fund, po ju them se më së miri është që asnjë tendencë politike, përkundrazi t'u lihet organeve të drejtësisë, ta thonë fjalën e vet, të thirrura dhe të krijuara edhe nga ky Kuvend i Republikës së Kosovës, që e ka për detyrë të mbrojë Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, të veprojnë organet dhe ta zbardhin rastin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “Nisma”, Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje, të nderuar qytetarë!

Kolegë të nderuar,

I nderuar kryesues,

Do të përpiqem të jem më i shkurtër për faktin se kemi një minutazh më të shkurtër që t'ia lë ndonjë deputeti tonë mundësinë të thotë ndonjë fjalë.

Ajo që dua të them në këtë foltore është se tash kemi dy situata: kemi situatën e para denoncimeve, para deklaratave publike të banorëve, për të cilën kryeministri e ka kryer detyrën e vet. Ka marrë informacione nga të gjitha organet kompetente se a ka apo nuk ka diçka të asaj natyre të raportuar. Deri këtu, ka pasur për detyrë kryeministri të sqarojë për anëtarin e tij të Kabinetit dhe e ka sqaruar. Tani e kemi një situatë tjetër, kemi një situatë tjetër kur hyhet në punë në momentin nga kur banorët, qytetarët e lagjes “Dardania” kanë raportuar për ato që i kanë raportuar lidhur me ministrin Rikalo dhe unë do të shqetësohesha nëse nga këtu prapë ndërhyjnë kryeministri, se më kjo s'është punë e kryeministrit, nuk është punë as jona.

Nga ky moment është çështje e sistemit të drejtësisë, se si do t'i qaset kësaj çështje, se si do t'i trajtojë provat dhe a do të arrijë të ndërtojë një aktakuzë nga të gjitha provat, nga të gjitha dëshmitë që do të mblidhen. Unë gjithashtu, ngre zërin fort kundër gjithë atyre që thonë “ku ishin deri tash”. Mos u tallni! Askush nuk ka të drejtë askujt t'i tregojë se deri kur ka pasur afat të denoncojë cilindo keqpërdorim apo cilindo krim që ka mundur ta bëjë ajo? Por kjo nuk e bën Rikalon fajtor. Sigurisht, nuk e bën derisa nuk ka përfunduar i tërë procesi që e ka deklaruar edhe prokurori se ka filluar ndaj tij procesi i hetimeve, procesi i verifikimit dhe pastaj procesi i aktakuzës dhe i gjyqësisë.

Ky Parlament ka një detyrë që të respektojë rregullat kushtetuese dhe ligjore. Nëse një ministër, një deputet i dënuar vazhdon të qëndrojë këtu, deputetët e kanë për detyrë ta shkarkojnë nëse ai nuk shkon vullnetarisht. Ndërsa, nëse një qeveri, një mazhorancë e mban një njeri, për të cilin ka dyshime, për të cilin mund të ketë edhe aktakuza, ajo mazhorancë mban kosto politike, mos u mërzitni ju për atë mazhorancë, pastaj ajo e paguan kosto politike. Pra, të dallojmë kostot ligjore nga ato politike. Ne jemi të gatshëm ta mbajmë koston politike si mazhorancë dhe t'i japim rast drejtësisë, shans drejtësisë për ta zbardhur. Por, hiqni dorë nga kjo logjikë qoftë e skadencës,

sepse krimet, sidomos ato që kryhen gjatë luftës nuk kanë afat skadence, asnjë krim, por sidomos ato nuk kanë afat skadence dhe në të njëjtën kohë të mos e shndërrojmë Parlamentin në gjykatë, ku shpallim njerëz fajtor edhe nëse ato denoncime, ato akuza janë të vërteta, le t'ua lëmë organeve përgjegjëse ta thonë fjalën e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Bilall! “6+” a dëshiron dikush të flasë? Jo! Në rregull! Atëherë, po vazhdojmë me deputetët e paraqitur sipas radhës, fjalën e ka zoti Kurti.

ALBIN KURTI: Të dashur qytetarë të Republikës!

Deputetë të Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Ministri i Bujqësisë, zoti Nenad Rikalo, është akuzuar me dëshmi publike nga disa banorë të lagjes “Dardania” të Prishtinës se ka ushtruar dhunë ndaj shqiptarëve gjatë kohës së okupimit dhe të luftës në Kosovë.

Mësuam se kryeministri aktual u është drejtuar institucioneve kosovare për të mësuar të vërtetën mbi këto dëshmi të banorëve të lagjes “Dardania”. Mirëpo, e vërteta nuk mund të jetë zyrtare, por qytetare. E vërteta nuk mund të jetë shtetërore, por popullore. Jo tri institucione, por 20 njerëz janë këtu si dëshmitarë, në rast se fillon e kur të fillojë procesi gjyqësor kundër zotit Rikalo, atëherë këto tri institucione do të mund të thirreshin si dëshmitarë të mbrojtjes, por jo tash. Tash i kemi 20 qytetarë të Kosovës të cilët kanë dëshmuar dhe me ato duhet të merremi.

Së dyti, paramendoni sikur këto tri institucione të Kosovës, AKI-a, Policia e Kosovës ose Prokuroria e shtetit të kishin thënë “Po, ne kemi aso të dhënash që inkriminojnë zotin Rikalo”. Kjo do t'i rrëronte ato si institucione. Pra, zoti Haradinaj u ka bërë një pyetje këtyre tri institucioneve, të cilës nëse këta nuk do t'i përgjigjeshin negativisht do ta rrënonin vetveten. Me këtë pyetje sugjестive të kryeministrit këto tri institucione janë ndodhur në situatën e konfliktit të interesit. Ato nuk kanë mundur të mos përgjigjen negativisht.

Së treti, pse barrën e provës për zotin Rikalo ta marrë Qeveria, kryeministri dhe këto tri institucione, pse jo zoti Rikalo? Pse nuk do të duhej që ai ta marrë barrën e provës, por Qeveria dhe kryeministri. Në Kosovë ka pasur gjenocid. Disa thonë ka pasur tentim gjenocidi, por është vështirë ta gjesh dallimin midis gjenocidit dhe tentim-gjenocidit, secila është më e keqe se tjetra. Janë vrarë mbi 10 mijë civilë dhe janë dhunuar mijëra gra vetëm në luftën e fundit, ndërkohë që paraprakisht kishim një okupim njëshekullor. Një dekadë në vitet e 90-a ishim në apartheid klasik. Ne kemi shpallur pavarësi, mirëpo pa vetëvendosje, pa dekolonizim. Unë besoj që kjo është thelbi i problemit.

Në vitin 1962, kur Algjeria ka fituar pavarësinë nga Franca, nëse nuk do të bëhej dekolonizimi 1/5-a e Algjerisë, një territor sa Franca prapë do t'i përkiste Francës, sepse francezët i kanë pasur

tapitë mbi tokën. Nuk ka pasur dekolonizim në Kosovë pas pavarësisë, prandaj i kemi gjithë këto probleme. Kemi një Pavarësi të themeluar në të ardhmen, integrimi evropian, e jo në historinë tonë.

Për bindjen time të fuqishme, në mënyrë që të kemi paqe, stabilitet, demokraci, drejtësi, është e domosdoshme që së paku çdo serb i cili është në moshën mbi 36 vjeçare e do të bëhet ministër, ai ta ketë barrën e provës kur bisedon me kryeministrin, që të tregojë se ku ka qenë në vitet 98/99. E jo kur të dëshmojnë 20 qytetarë kryeministri të shkojë e të pyes tri institucione, të cilat po të thoshin “Po, edhe ne kemi dëshmi të tilla.” do të shkatërroheshin si institucione. Më kuptoni? Pra, është e domosdoshme, që barra e provës të jetë te zoti Rikalo, edhe politikisht edhe publikisht.

Dhe jo vetëm kaq, unë besoj që edhe nëse ndonjë serb nuk ka bërë asgjë, padyshim që është legjitime edhe të pyetet se a di dikë që ka bërë diçka, se edhe nëse di dikë që ka bërë diçka e nuk tregon, kjo është prapë pjesë e krimin. Nuk po dua t’i fajësoj serbët në përgjithësi, absolutisht jo. Është e padrejtë të thuhet që nëse dyshon për një serb ke dyshuar për të gjithë serbët. Ne shqiptarët nuk jemi të gjithë njëjtë, kemi veprime, qëndrime e sjellje të ndryshme. Po ashtu, edhe serbët nuk janë të gjithë të njëjtë. Unë para një jave kam takuar një serbe nga Beogradi. Edhe ajo ka qenë gjatë bombardimeve të NATO-s në Kosovë, e ka emrin Natasha Kandiq. Nuk i barazojmë ne të gjithë serbët. Serbët janë të ndryshëm edhe shqiptarët janë të ndryshëm. Veçse, nuk është mirë tash që nëse dyshon për një serb të akuzohesh se ti po fajëson të gjithë serbët. Jo, duhet të bëjmë dallime. Njerëzit kanë përvoja, veprime, mendime e qëndrime të ndryshme dhe ashtu duhet t’i trajtojmë. Për shkak se janë të ndryshëm, nuk guxojmë t’i trajtojmë njëjloj.

Për bindjen time, se çfarë po ndodh aktualisht vjen edhe nga faqja 10 e programit, përkatësisht e parimeve programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku thuhej se me Serbinë kemi një histori tragjike të marrëdhënieve. Ky barazim është i pafalshëm edhe për ndonjë ndërmjetës ndërkombëtar. Edhe ndonjë ndërmjetës ndërkombëtar po të thoshte që kemi histori tragjike shqiptarët dhe Serbia, do të duhej të pasohej me kritikën tonë. Nëse këtë ia bëjmë ne vetvetes, atëherë mund të them që pikërisht ky barazim midis shqiptarëve dhe Serbisë është tragjik. E unë besoj, që për shkak të kësaj qasjeje, të barazimit midis shqiptarëve dhe Serbisë, ne në Kosovë pastaj i kemi planet e rrezikshme prej decentralizimit etnik e deri te Gjykata speciale. Pra, është e pafalshme në parimet programore fjalia “Kemi histori tragjike të marrëdhënieve të ndërsjella...”, thuajse ka ndodhur ndonjë farë aksidenti. Nuk guxojmë ne ta barazojmë vetveten me Serbinë, por vuajtjet e humbjet që i kemi pasur në Kosovë.

Unë besoj që zoti Rikalo tashmë është vërtetuar, është verifikuar, por këtë e ka bërë Vuçiqi, as AKI-a, as Policia e Kosovës, as Prokuroria e Kosovës, sepse nuk ka mundësi që ata të vendosin që Lista serbe duhet të shkojë me zotin Haradinaj në Qeveri dhe të mos i verifikojnë ministrat që do të jenë aty. Ne e dimë që marrëveshja Thaçi-Daçiq e vitit 2013 dhe dakordimi për datën e

zgjedhjeve më 3 nëntor të vitit 2013, aso kohe zgjedhje lokale, aty është formuar Lista serbe. Dialogu i Brukselit midis Thaçit dhe Daçiqit e pat formuar Listën Serbe, se përpara ka qenë SLS-ja. Aty u pat formuar Lista serbe. Dhe, sot nuk mund të prisni që do të ketë ministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës i pa verifikuar, jo nga institucionet tona, por i paverifikuar nga Vuçiqi. E kur e marrin Ministrinë e Bujqësisë, që është tejet e rëndësishme, se bujqësia ka një element të sovranizimit, është marrëdhënia e njeriut me tokën, edhe në fjalimin tim paraparak pata shpjeguar qysh pikërisht Çubrilloviqi në '45-tën bëhet ministër i bujqësisë, reformat agrare, kolonializmi... krejt janë të lidhur me Ministrinë e Bujqësisë dhe me sektorin e bujqësisë. Ky nuk ka mundur të jetë i paverifikuar. Prandaj, unë them sot që ky me të vërtetë është i verifikuar, por jo prej nesh. Është i verifikuar prej Beogradit dhe për ta vërtetuar një gjë të tillë është edhe fakti, që nëse s'gaboj, është i vetmi ministër i cili abstenoj për programin qeverisës. Ky nuk e ka mbështetur programin qeverisës të kryeministrit Haradinaj.

Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë, që ky ka një mbështetje shumë të fuqishme. Ky e ka luksin, ky e ka komoditetin që të qëndrojë në Qeveri edhe kur s'e aprovon programin qeverisës. Më kuptoni? Prandaj, unë besoj që është e domosdoshme që të zhvillohen hulumtimet dhe të bëhen hetimet dhe është e padrejtë që në emër të asaj se janë dënuar shumë pak serbë në Kosovë për krime të Luftës, tash të thuhet se shqiptarët kanë njëfarë predispozite që t'i fajësojnë të gjithë serbët, rrjedhimisht asnjë serb nuk është fajtor. Po e përsëris, nuk janë të gjithë shqiptarët njësoj, nuk janë as të gjithë serbët njësoj.

Atëherë, kur mungojnë proceset gjyqësore, ka fajësime kolektive. Unë jam kundër fajësimeve kolektive, po pikërisht për atë arsye na lejoni që t'i diferencojmë njerëzit me emra e mbiemra. E në këtë rast nuk e keni një dëshmitar, nuk i keni as dy dëshmitarë, po i keni 20 sosh. E vërteta nuk është zyrtare shtetërore, e vërteta është njerëzore, qytetare, popullore. Janë këta 20 dëshmitarë, jo tri institucionet që i përmendi kryeministri, janë 20 dëshmitarë. Dhe, përderisa këta dëshmitarë kanë dalë publikisht, jo me fytyra të mbuluara, po me emër e mbiemër, integritetin e tyre, dinjitetin e tyre e kanë vënë në pikëpyetje publikisht edhe dëshmitarët, ky duhet të shkarkohet. Nuk janë dëshmitarë që janë frikësuar, janë dëshmitarë që kanë konsideruar që është diçka jetike.

Ne e dimë çfarë shteti të dobët kemi. Ata dëshmitarë janë të rrezikuar sot. Ata kanë rrezikuar me dëshminë e tyre. Prandaj, është e domosdoshme që ky fillimisht të pezullohej, e sot unë e mbështes mocionin, që ai të shkarkohet.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Myfera Shinik.)

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka kryeministri i Republikës së Kosovës. Urdhëroni!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar koleg,

I nderuar zoti Kurti,

Diskutimi për ministrin Rikalo, ose interpelancën, po zgjerohet edhe në aspekte të tjera. Nëse mund të jap disa sqarime lidhur me tragjikën.

Tragjikja nuk është barazim. Historia jonë është tragjike me serbët, por në këtë tragjike ne kemi qenë viktimë me Serbinë dhe s'kam aluduar asnjëherë. Nëse dikush ka menduar që po dua të barazoj diçka, më falni, po e korrigjoj veten atëherë. S'kam menduar në barazim, por e vërteta është e vërtetë, kemi qenë viktimë dhe nuk besoj që ndokujt i ka shkuar mendja te barazimi me këtë.

Ana tjetër e programit qeverisës dhe një votë "jo", ndoshta është pak e habitshme, por ne jemi qeveri më heterogjene dhe në disa raste ne s'po mund ta plotësojmë, ta quaj ashtu, pikëpamjet e secilit anëtar të Kabinetit qeverisës. Po votojmë në shumicë, mund të ndodhë ndonjëherë që s'akomodohemi në pikëpamje të dikujt. Pra, edhe kjo mund të jetë edhe e keqe edhe e mirë për interesat e vendit. Mund të jetë edhe ajo që po thoni ju, por mund të jetë edhe diçka tjetër.

Për këtë arsye qeverisja dhe marrja e vendimeve në Qeveri, kuptohet që jo çdoherë e ka shumicën. Është një... për secilin po flas. Edhe ka raste që abstenojnë, ose votojnë kundër. Plot tema që lidhen me këto që u thanë sot, unë ju thash edhe në fillim të fjalës sime, e vërteta është shërim, shëron çdo gjë. Por, në etapën ku jemi sot edhe kërkesat që vijnë për interpelancë për mua janë diçka e rregullt dhe e vlefshme dhe e respektova kërkesën dhe çdo gjë që u shkrua.

Ajo që unë e tërhoqa vërejtjen më herët është një kujdes yni, si të zgjedhur, pra që ne mos ta kryejmë detyrën e tjetërkujt. Vërtet, është në nderin tonë ndoshta, e të gjithë neve, që të mos gabojmë në hapa, të mos gabojmë në etapa. Për këtë arsye mbaj ato qëndrimet që mbajta. Tani ekziston një... si ta quajmë ashtu, një dilemë publike, meqë po flasim për 20 dëshmitarë, bashkëqytetarë tonë, në mos tjetër taksapagues të këtij vendi, ata janë edhe vëllezërit dhe motrat tona, personi ministri Rikalo siç e dimë, nuk është së pari herë person publik. Domethënë, ka ekzistuar në medie, ka ekzistuar si emër, ka ekzistuar në shoqërinë tonë.

Disa dyshime të bazuara për mënyrën e aktivizimit të këtij rasti dhe disa dyshime të tjera, të cilat mua nuk me pengojnë me besua në të vërtetën, cilado qoftë ndonjëherë, po na bëjnë të kujdesshëm në hapa dhe në veprime. Kjo nuk nënkupton që ne po dëshirojmë ta tjetërsojmë, as të vërtetën, as që po duam t'i ikim të vërtetës, për këtë të jeni më se të sigurt.

Për marrëdhëniet me Serbinë dhe me Beogradin edhe Lista serbe në koalicion. Shikoni, diçka mendoj se pajtohem të gjithë. Betimi kur është dhënë i Qeverisë, është dhënë në këtë sallë dhe është dhënë me këtë Kushtetutë, me të cilën gjithnjë jemi ulur në këto ulëse, ose jemi bashkë në këtë Parlament. Pos atij betimi, ju kam thënë edhe herën para kësaj, më besoni nuk kam ndonjë

marrëveshje tjetër, që ka të bëjë me kurrgjë prej temave që janë përmendur këtu. Është e pastër, bile është propozim-marrëveshje për bashkëqeverisje, të cilën nuk kemi pasur rast as me e nënshkrua ndonjëherë, pra ju kam treguar.

E ndryshe, tani ne do të përballemi me pikëpamjet e njëri-tjetrit dhe këto pikëpamje nuk është se, të paktën prej anës së Qeverisë dhe prej grupeve parlamentare me të cilët unë komunikoj e janë pjesëmarrës në qeverisje, kurrkush nuk po synon të ikë nga përgjegjësia në këtë rast. Vetëm se ne duhet të jemi të kujdesshëm, besoj të gjithë ne, edhe unë, edhe ju dhe secili, në hapa, qysh po i marrim veprimet e si pasojmë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti, replikë!

ALBIN KURTI: Faleminderit!

Te faqja 10, te fqinjët, kemi vetëm dialogun me Serbinë. Pra, fqinjët e Kosovës janë reduktuar te dialogu me Serbinë. Kjo, për bindjen time, është padrejtësia e parë.

Po e dyta, për të cilën fola më herët, është se kur flitet për të kaluarën me Serbinë, të thuhet vetëm një fjali “Kemi një histori tragjike të marrëdhënieve të ndërsjella”, për bindjen time të fuqishme, është gabim. Kjo është shprehje e vetë-censurës. Ne të gjithë e dimë, se nuk është e vërtetë. Nuk mund të thuhet vetëm “kemi një histori tragjike të marrëdhënieve të ndërsjella”, sepse nëse krejt çfarë kemi të themi për të kaluarën tonë, që kemi qenë në luftë e nën okupim me Serbinë, se “është një histori tragjike e marrëdhënieve të ndërsjella”, unë besoj se kjo ka pasoja pastaj në veprimet, qëndrimet që merren, ose nuk merren. Pra, unë po bazohem në tekst. Unë besoj që ju mendoni ndryshe, por ajo ka më pak rëndësi, ajo që është e rëndësishme është çfarë po shkruan këtu. E unë po them, që në Republikën e Kosovës kemi shumë tekste të këtilla. Kemi pafund shprehje të këtilla që janë shprehje e vetë-censurës sonë, mirëpo viktimat e vetë-censurës sonë jemi vetë ne. Në njëfarë mënyre ne jemi dyfish viktimë, viktimë edhe të Serbisë edhe të vetë-censurës sonë.

Nuk mund të dalin qëndrime dhe veprime të duhura në raport me Serbinë, si njëri prej fqinjëve tanë, përderisa ne kemi një vetë-censurë të tillë, e cila përbën parim programor të Qeverisë. Kjo ishte ajo që desha të them.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, urdhëroni!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: ...gati në dokumentin që e kam lëshuar unë, “...e ndërsjella” nuk figuron. Tashti, ose është një dokument tjetër, por nuk do të duhej të figurojë. Nëse figuron “e ndërsjellë” ju siguroj, ka njerëz edhe këtu që po dëgjojnë, staf ose të tjerë, që

nuk do të duhej të figurojë. Mirëpo, nëse është ashtu, ju keni të drejtë. Pra, nuk është e ndërsjellë tragjikja. Historia është tragjike dhe dihet për kë. Pra, këtu keni të drejtë nëse është ashtu.

Qëllimi nuk është nëse, prapë po dua të them diçka që mendoj se është e vlefshme, ne jemi në Kosovë me plot ngecje, kemi ngecur në plotë drejtime në vendin tonë, edhe me kapacitet jo aq të avancuar në zbatim, qoftë në shtrirjen e sovranitetit tonë, të integritetit territorial dhe plotë temave tjera. Një qasje serioze në dhënien e besimit të ndërsjellë dhe në marrjen e besimit për integrimin e vendit mund të jetë interesi i kësaj shoqërie, pra mund të jetë interesi ynë si Kosovë. Shumica, ose në tërësi, kujdesi nuk i dedikohet vetëm përkëdheljes ndaj një fqinji, ose nuk është qëllimi aty sa është qëllimi që njerëzit e këtij vendi, mundësisht të gjithë, t'i bëjmë me e përmbyllë në Kosovën në planin e brendshëm, se Kosova ka mbetur e papërmbyllur në planin e brendshëm në plotë tema, për fat të keq.

Ne brezi që jemi tani do të vazhdojmë çdoherë të përballemi me obligimet e demokracisë, me gara zgjedhore, me çdo gjë, por do të ishte mirë që çdo gjeneratë, të paktën çdo mandat, ose çdo ekip qeverisës, të avancojë në përmbylljen e Kosovës në planin e brendshëm. Qëllimi dhe misioni im është ta përmbyll Kosovën në planin e brendshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Naser Rugova është paraqitur nga LDK-ja.

NASER RUGOVA: Faleminderit, kryesues!

Zoti kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mbase e potencova edhe dje nga foltorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ne jemi të zgjedhurit e Kosovës dhe jemi ligjvënës. Duhet të jemi të kujdesshëm nga foltorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës mos të kalojmë në role të tjera, në role të hetuesve dhe të prokurorëve, por ta bëjmë punën tonë si të zgjedhurit e popullit.

Në këtë kontekst, mos të tentohet që kërkesa për interpelancë nga ana e Grupit Parlamentar të hidhet tani në drejtime stratosferike apo para historie. Po flasim për një temë konkrete, për një shqetësim që e kanë ngritur banorët e Lagjes Dardania, në të cilën lagje jetoj për më tepër se dy dekada edhe vet.

Në këtë kuptim, askush nuk ka tendenca, as personale, as politike apo ndonjë tendencë tjetër, por është momentum i fundit, po i drejtohem kryeministrit të vendit po edhe të gjithë kolegëve deputetë, që të instalojmë standarde të ndërtimit të institucioneve me njerëz kredibil me kredo politike, morale dhe profesionale e në radhë të parë me duar të pastra. Pa dashur të prejudiojmë dhe të ndërhyjmë në gjyqësor, që është tejet e papranueshme për deklaratimet e disa deputetëve, që po marrin edhe rol të prokurorëve dhe të gjykatësve, ne duhet të jemi të kujdesshëm.

Zoti Rikalo, jeni ministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ish- fqinjët tuaj kanë ngritur shqetësime dhe nuk janë dy ose tre, por janë rreth 20. Në këtë kuptim, unë kërkoj që edhe ju personalisht ta merrni fjalën dhe të sqaroheni, sepse kjo interpelancë nuk ka të bëjë për ta linçuar një individ, një ministër të Qeverisë absolutisht, aq më pak një pjesëtar të një komuniteti tjetër, sepse dihet koncepti politik, baza ideologjike dhe orientimi qytetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës si partia më e vjetër në këto troje dhe si parti që për më tepër se gati dy dekada e gjysmë kemi ofruar dialog, tolerancë dhe mirëkuptim për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në këtë kuptim, dua të tërheq një paralele edhe të disa kolegëve të grupacioneve tjera politike. Është përgjakur Sheshi Ibrahim Rugova dhe Skënderbeu pas një deklarate tejet të papërgjegjshme dhe të rëndë të ish-ministrit Jabllanoviq, ai u shkarkua. Andaj, është filluar procedura nga Prokuroria e shtetit, unë e kuptoj kryeministrin e vendit që ka bërë pyetje në institucionet zyrtare, por përgjigja nga ato institucione për gjendjen aktuale për momentumin kur është formuar kjo qeveri dhe për momentumin kur janë deklaruar banorët e Lagjes Dardania ka dallim substancial. T'i lejojmë organet e hetuesisë, Prokurorinë dhe Gjyqësinë ta bëjnë punën e vet, por ministër Rikalo, thjesht pas të gjitha këtyre debateve ka qenë e rrugës që ju vet t'i lëshoni rrugë procesit të organeve të drejtësisë dhe thjesht, kryeministri Haradinaj ta emërojë një ministër tjetër.

Me mbarimin e kësaj procedure ligjore, atëherë janë çështje tjera. Tek e fundit ju jeni koalicion qeverisës, e keni një mazhorancë çfarë e keni, është çështje e juaja dhe është ekskluzivisht e drejtë e kryeministrit të emërojë ministra kë të dojë ai dhe kjo nuk është çështje e opozitës.

Zoti kryeministër, është mirë që sot jeni këtu dhe kërkoj nga ju, që për të gjitha temat që kërkohen nga grupet parlamentare opozitare, të ulemi bashkë edhe kur kritikohemi, edhe kur bëjmë garë politike, edhe kur kemi dallime serioze konceptuale, programore, në qeverisje, në projeksione buxhetore, në politika sektoriale, t'i diskutojmë. T'i diskutojmë këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse na presin vendime jashtëzakonisht sensitive, mbase para përfundimit të këtij viti kalendarik. Dhe kërkoj, sepse dje ishte një seancë që nuk kishte të bëjë me temën për çka ishte në rendin e ditës.

Andaj, kërkoj nga të gjithë kolegët të fokusohen në temë, në pikën e rendit të ditës, në interpelancën që e ka kërkuar grupi parlamentar. Nuk pretendojmë, edhe një herë po e nënvizoj, sepse këtu pat tendenca të tjera që të gjuhen në adresë të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në këtë kuptim të sillemi me përgjegjësi. Unë e thash fjalën time, i bëra dhe kërkesë direkte ministrit Rikalo po edhe kryeministrit Haradinaj.

Uroj që edhe organet e drejtësisë, Gjyqësia dhe Prokuroria ta thonë fjalën e vet ashtu siç u takon, sepse ne si ligjvënës nuk kemi të drejtë, as të ndërhyjmë dhe larg asaj që ta marrim rolin e tyre. Në këtë kuptim, uroj që Kuvendi i Republikës së Kosovës në detyrat e ardhshme, jo vetëm në

këtë mandat po edhe në mandatet e tjera, të mos jetë peng i asnjë grupimi politik, por që mazhoranca edhe historike edhe etnike dhe demografike t'i ndërtojë institucionet, ta thotë fjalën e vet, se vërtet kemi humbur shumë, kemi ngecur shumë dhe është momentum i fundit, që tani pothuajse 18 vjet pas lufte t'i vëmë pikë fjalës "tranzicion" dhe që Kosova të orientohet nga e mbara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Andin Hoti e ka fjalën.

ANDIN HOTI: Më në fund më erdhi radha.

Për që qenka i rëndësishëm kaq shumë ky farë Rikalo po e shoh edhe këtu, se që tre orë jemi duke folur për të. Në fakt, qenka edhe më i rëndësishëm se Programi i Qeverisë dhe më i rëndësishëm se sa qytetari i Kosovës.

Shumë të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

I nderuar kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqenëse është hera e parë që jam në këtë foltore dhe meqenëse është hera e parë që jam deputet në Parlament të Kosovës, më lejoni t'i falënderoj të gjithë qytetarët që më kanë dhënë besimin, që më kanë dhënë përkrahjen, që unë të jem këtu, që bashkë me ta të punojmë në interes të qytetarit. Po më lejoni, që të njëjtit qytetarë, mbi 14 mijë qytetarë që më kanë përkrahur, të ju bëj thirrje juve që t'i kthehemi agjendës tonë politike, që t'i kthehemi asaj për çfarë jemi këtu. T'i kthehemi interesit qytetar, t'i kthehemi ligjeve për të cilat jemi këtu.

Me ju thënë të drejtën, unë kam menduar që kemi me bisedua, kam menduar që do të flasim këtu për ligjet për rininë. Nuk e di a e dini, po rinia në Kosovë është keq. Nuk e di a e dini, po rinia në Kosovë, brendh rrugëve. Nuk e di a e dini, po rinia në Kosovë, sidomos në fshatra, është e papunë, është e pashpresë.

Njëri prej atyre që the "cili ligj", është ligji që është hartuar në mandatin e kaluar, i cilin ua mohon të drejtën studentëve, ua mohon të drejtën të rinjve të punësohen, për shkak se ua mohon të drejtën e përvojës së punës pa e kryer fakultetin. Ky për mua është një ligj absurd.

KRYESUESI: Andin, futu në temë se kemi tjetër temë.

ANDIN HOTI: Unë kam menduar, se do të vijmë këtu dhe të bisedojmë për gjendjen e bujqësisë. Unë jam prej komunës së Rahovecit, unë jam prej Krushës dhe e dimë se si është bujqësia në Kosovë. Nuk e di nëse e keni parë, në Podujevë, në Krushë, Në Mamushë e në shumë vende

kanë filluar t'i gjuajnë specat, kanë filluar t'i gjuajnë agroproduktet, sepse nuk po kanë llogari të punojnë për to. Nuk po kanë llogari, nuk po kanë përfitim për to.

Prandaj, besoj që është më mirë ne të bisedojmë për ato, se sa të merremi me Rikalon këtu dhe të merremi me çështje të tjera, për të cilat jeni duke u marrë sot.

Një bujk në Krushë, një bujk në Kosovë, nuk mund të aplikojë për grande pa pasur nja 5 ekspertë anash, e të dinë se si bëhet një aplikim me gjithë atë burokraci që është krijuar në dokumente, që as unë s'di si të aplikohet, është goxha problem. Prandaj, është mirë t'i bisedojmë bashkë të gjitha këto dhe me të gjitha këto bashkë me t'i gjejmë lehtësime sa më të mira për qytetarin e Kosovës.

Në kohë të fushatës e kam thënë që është mirë të krijohen edhe ekipe mobile, të cilat i asistojnë sidomos bujqve në formimin dhe plotësimin e këtyre dokumenteve për grande dhe subvencione. Prandaj, është mirë me bisedua këtë edhe këtu.

Kam menduar që do të bisedojmë edhe për çështjen e të zhdukurve, për të cilën së pari dua ta falënderoj kryeministrin Haradinaj, që dje për ata edhe është vonuar në seancë, bashkë me mua ka qenë në Qeveri të Kosovës, në mbledhje të Qeverisë së Kosovës, që për mua ishte hera e parë në një mbledhje të Qeverisë së Kosovës, ku është diskutuar forma dhe mënyra se si mund të ndodhë me e zgjidhë problemin e të zhdukurve të Kosovës.

Ndoshta edhe keni harruar, por janë mbi 1 600 familje që ende sot vuajnë, nuk mund të flenë mirë, njëra prej tyre jam edhe unë, sepse nuk e dimë si e kemi fatin e familjarëve tanë. Është mirë të bisedojmë edhe për këtë bashkë, nuk po e akuzoj asnjë parti të veçantë politike, edhe timen, edhe aty ku jam unë. Është mirë të bisedojmë dhe të bëhemi bashkë dhe ta shohim mundësinë, se si mundemi në dialogun me Serbinë me e kushtëzua ose edhe me e kërkuar çështjen e fatit të të zhdukurve. Kjo plagë, ky proces duhet me u krye.

Mund të flas pak, por nuk do të flas shumë edhe për ligjin absurd për dëshmorët e Kosovës që është bërë. Kjo ia kushtëzon një prindi, një familjari të vendos se cilin djalë ose cilën vajzë e ka pasur më të mirë e ta marrë pensionin veç për njërin prej tyre e jo për të dy. Kjo nuk është normale. Këtë unë për vete nuk e konsideroj normale.

Është mirë të bisedojmë, nuk e di nëse e dini, por sipas meje është e vetmja kategori në Kosovë që nuk është shpërblyer dhe nuk është folur asnjëherë - nënat shqiptare. A e dini sakrificën e nënave shqiptare, çka kanë bërë jo vetëm gjatë luftës në Kosovë, jo vetëm tash pas 18 vjetësh, po qe njëqind vjet e më herët.

Nuk e di pse është kaq e vështirë, Avdullahu është ekonomist, këtu kemi dhe të tjerë ekonomistë si Bedri Hamza, pse të mos bëhemi bashkë ne, tek e fundit jemi shqiptarë të gjithë, dhe ta krijojmë, ta gjejmë një formulë a një mundësi të buxhetit, të ndarjes së buxhetit pikërisht për nënat shqiptare, për shtimin e natalitetit në Kosovë.

Të gjendet një mundësi, jo me ato 50 euro, me 50 euro të kryhet, jo. Të gjendet një mundësi t'u ndihmojmë nënave në Kosovë që ato të lindin sa më shumë, që ato të kenë mundësi t'i këqyrin fëmijët e vet, të kenë mundësi t'i rritin fëmijët e vet në kushte normale dhe jo me kushte të rënda.

Nuk kam dëgjuar as më herët, pse nuk e fillojmë bashkëpunimin me Shqipërinë? Ne e dimë që të njëjtë i kemi, e kemi të njëjtën gjuhë, e dimë që i kemi përafërsisht të njëjtat probleme, e dimë që i kemi përafërsisht të njëjtat ligje edhe në raport me integrimin evropian, shumë thjesht mund t'i marrim, veç t'i kopjojmë prej tyre, dhe vazhdojmë të mos humbim kohë ne kot. Nuk e di pse nuk e thellojmë bashkëpunimin me Shqipërinë edhe në raport parlamentar, edhe në aspekt të Qeverisë.

Dje rastësisht në televizor i pashë disa sportistë që ishin mbi 15 vjeç, jo më shumë, dhe kishin ankesa për kushtet e rënda që i kanë në Kosovë, e ata sportistë të njëjtit kanë fituar medalje të arta, të njëjtit janë kampion bote sot.

Është mirë ndoshta të bisedojmë ne qysh të gjejmë mënyrën t'u ndihmohet atyre sportistëve, qysh ta gjejmë mënyrë të mos na i marrin të tjerët. Sepse kur janë të mirë e kur po fitojnë, janë diplomatë, janë përfaqësues të Kosovës, e të tjera.

Është mirë t'i falënderojmë, unë ju thashë se është hera e parë që jam në Parlamentin e Kosovës, dje i mora për herë të parë disa dokumente, dy prej tyre kanë një ndihmë financiare e Gjermanisë që i është bërë Kosovës. Nuk e kam lexuar se e mora dje, por e pashë që janë mbi 17 ose 20 milionë euro. Unë nuk e pashë askënd që e falënderoi Gjermaninë, nuk e pashë askënd që i falënderoi shtetet mike për ndihmën që janë duke na dhënë. Është mirë ta falënderojmë edhe Gjermaninë për atë ndihmë që na e ka dhënë. Nuk po flas për IPA, se e di që Avdullahu ka bërë hajgare se IPA-n e voton gjithqysh, unë besoj që po, se nuk ka logjikë ndryshe.

E kemi diasporën. Ne diasporës para nuk mund t'i dërgojmë, se kanë boll ata. Ne çka mund të bëjmë është t'ua lehtësojmë hyrjen në kufij që të mos presin edhe nga 9 orë, 10 orë, nga 7 orë. Është mirë të gjendet formula, formula ka sa të duash, të krijohen sportele të reja, kufij të rinj e të tjera, veç është mirë të bisedohet për këto gjëra, jo për gjëra të tjera.

I kemi disa ndërmarrje publike që janë para falimentimit, është ndërmarrja e Hekurudhave, Posta, e të tjera, është mirë t'i këqyrim edhe ato pak, t'i kthejmë sytë kah ato çka mund të bëhet për to.

Dje kam qenë këtu dhe ika menjëherë. A e dini pse ika? Sepse nuk munda të duroj që programet politike, programet e fushatave të komunave lokale që po i dëgjoj çdo ditë, dje u shpalosën këtu. Ne këtu nuk besoj që jem për programe politike të fushatës, jemi për gjëra të tjera, jemi për ligje, jemi për interesin e qytetarit.

Të akuzosh në mënyrë të ulët dhe të përdorësh fjalë banale, unë kam qenë deri sot veç qytetar, nuk kam qenë në Parlament dhe e di çka kanë folur, prandaj po ju foli si shok më shumë se sa si kolegë. Askujt nuk janë duke i pëlqyer këto banalitete që përdoren këtu në Parlamentin e Kosovës, krejt i dinë, krejt dimë të shajmë, krejt dimë qysh akuzohet, është mirë t'i largojmë këto, jo t'i shtojmë.

Unë, për fat të mirë, nuk jam i martuar, as nuk kam fëmijë, veç nëse do të kisha pasur fëmijë, nuk do të dija si t'i them fëmijës tim “mos shaj”, babit, kur ai thotë po edhe institucioni më i lartë shtetëror po shan, pse unë jo! Është duke u instaluar një edukatë shumë e keqe në Parlament të Kosovës, e cila po ndikon dhe po e dëmton qytetarin e Kosovës, dhe jo juve. Është mirë nganjëherë ju të mos bëheni, se unë e di kur ta krye fjalimin kolegët e mi do të më thonë: “Bravo, mirë ke folur”, por këta janë kolegët e mi. Është mirë nganjëherë të mos bëhemi shokë mes veti, por të bëhemi shok edhe me qytetarin dhe të dimë çka po mendon qytetari për ne, e jo ne.

Për Rikalon nuk më takon, në fakt, të flas mua, zoti Kurti tha që serbët nuk janë të gjithë fajtorë. Zoti Kurti, për mua po, janë fajtorë përderisa nuk ndihen së paku keq për atë çka ka ndodhur në Kosovë, përderisa nuk ndihen keq për masakrën e Krushës, Gjakovës, e tjera.

Ndoshta Rikalo, nuk ka bërë asgjë por unë nuk e kam dëgjuar duke thënë asnjëherë që ndihem keq çka ka bërë Serbia në Kosovë, unë nuk e kam dëgjuar. Unë nuk e kam dëgjuar Rikalon asnjëherë duke thënë që po shkoj në Serbi dhe po flas me këndo qoftë atje, të zbulohet fati i të zhdukurve. Për mua është çdo serb është fajtor derisa nuk zgjidhet kjo çështje.

Tash po dua të tregoj një përvojë timen personale pikërisht për Rikalon.

Me kryeministrin Haradinaj për herë të parë jam takuar në një dasmë para dy jave dhe i thashë: “Kryeministër, e pata goxha të vështirë ta votoj jo vetëm Rikalon, por edhe një nënkryetar tjetër që ishte”. Tha: “Andin, a po mendon që unë e kam pasur lehtë”. Edhe në ato momente m'u kujtuan dy vëllezërit e kryeministrit. Besoni që nuk e ka jo ky lehtë, por as unë, goxha vështirë e kemi pasur, po nuk kemi çka të bëjmë, nuk e kemi bërë ne, është një Kushtetutë e Kosovës, është një Kosovë që nuk e kemi krijuar veç ne, por të gjithë bashkë.

Kryeministri atë natë më tha dhe më qetësoi se, për besë unë dëgjova diku se do të dalë në protesta dikush dhe desha të dal, por kryeministri atë natë tha që unë menjëherë në momentin që

e kam kuptuar e kam thirrur AKI-në, e kam thirrur Policinë e Kosovës dhe të tjerë dhe i kam pyetur, po nuk kishte asnjë dokument për atë që akuzohet Rikalo, për atë çka flitet.

Unë nuk po e shfajësoj Rikalon, unë veç u bëj thirrje qytetarëve të Kosovës, atyre që kanë dëshmi që ato t'i deponojnë në prokurori të Kosovës, jo këtu, si sallë gjyqi po më duket nganjëherë Parlamenti.

Edhe atë, nuk ju siguroj, veç jam i bindur që kryeministri në momentin e parë që do të ketë fakte që Rikalo ka bërë vepra të tilla jo vetëm ta shkarkojë, por do të sigurohet që të mos dalë prej burgut kurrë më.

Unë edhe një herë ju bëj thirrje për unitet. Ne të gjithë jemi qytetarë të Republikës së Kosovës, të gjithë e kemi një qëllim, të gjithë i shpалosim do programe në fushatë, veç në forma të ndryshme, se janë të njëjta: është zhvillimi ekonomik, arsimit, rinia, veç në mënyra të ndryshme i shpалosim, të gjithë i themi të njëjtat. Të bëhemi bashkë dhe të punojmë për interesin e qytetarit, të bëhemi bashkë të merremi me qytetarin, e jo me vetveten dhe jo me debate koti.

Ju ftoj që të përdoret politika si shkencë, e jo vetëm si art, ju ftoj të përdoret politika edhe në interes të qytetarit, e jo vetëm në interes të partive politike dhe të subjektit tuaj ku jeni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zotit Hotit ia ka përmendur emrin Andini, do replikë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Unë, në fakt, e vlerësoj fjalën e deputetit Andin Hoti, është deputet i ri, sigurisht ka shumë për të mësuar, sikurse që kemi mësuar të gjithë në moshën e tij kur kemi qenë dhe kam respekt të veçantë për familjen e tij. Sigurisht, të gjithëve na ka mësuar jeta në kontekste të ndryshme.

Të kisha lutur shumë, unë e kam fjalën, e kam minutazhën time. Unë besoj që vetë deputeti Hoti duhet të insistojë në mbajtjen e standardeve të larta për zyrtarë publikë. Ministri Rikalo është i pafajshëm, në këtë moment që po flasim është i pafajshëm, askush s'mund të thotë që është sot fajtor. Se parimi bazë i drejtësisë është ky, atë që po kërkujmë ne është që ministri të shkarkohet derisa të qartësohen të gjitha këto akuza publike, as akuza unanime, as me dokumente të ndryshme: njerëz që flasin, 20 persona që e akuzojnë publikisht këtë ministër. Është i pafajshëm ndërkohë që ne po flasim dhe e respektojmë plotësisht këtë.

Andin, unë kur deklarohe publikisht në këtë foltore asnjëherë nuk bëjë hajgare, unë me seriozitetin më të madh u drejtohem deputetëve, sepse i respektoj, edhe qytetarët e vendit.

Kur kam deklaruar dje për marrëveshje IPA, ia kam bërë me dije kryeministrit Haradinaj se të gjitha marrëveshje me interes të qytetarëve të Kosovës duhet të votohen me votat e deputetëve të LDK-së, me votat e deputetëve të “Vetëvendosjes”, me votat e deputetëve të PDK-së, të partisë tënde. I kam kërkuar që të mos e injorojë opozitën, sepse do të ketë nevojë për këtë, sa herë që bëjmë fjalë për marrëveshje që janë në interes nacional, unë nuk bëjë hajgare në foltore. Faleminderit! Mbetemi që edhe ti, edhe unë të mësojmë shumë prej debatit publik, në veçanti ti si deputet më i ri.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Slavko Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani zamenice premijera,

Poštovani Vladi kabinetu,

Uvaženi gospodine ministre Rikalo,

Uvaženi narodni poslanici,

Poštovani građani,

Na samom početku želeo bi da izrazim nezadovoljstvo i žaljenje zato što u prethodnom sazivu Skupštine korištena kao instrument da se sprovodi institucionalno nasilje i o malovažanja pre svega srpski politički predstavnika ovde u Skupštini i od strane pojedinih poslanika i poslanička grupa. A veoma mi je žao da i u ovom sazivu pojedine poslaničke grupe i poslanici koriste Skupštinu kako bi od njih stvorili pre svega instrument kako bi i dalje sprovodili represiju na srpskim političkim predstavnicima koji su zastupljeni ovde u institucijama u Prištini i žele da od Skupštine stvore Policiju Kosova, Sud Kosova i Tužilaštvo Kosova. A svi oni su se jasno deklarirali da ne postoji ni najmanja moguće indicija da je gospodin Nenad Rikalo za vreme oružanih sukoba 99. godine počinio bilo kakav zločin ili kako vi to govorite, aktivnosti nasilja nad građanima Prištine.

Slušam ovih dana kako konstantno kroz medije govorite da je gospodin Rikalo neko koje konfliktna ličnost, ali ja hoću da vam kažem da postoji jedna izreka kod srpskog naroda, koji je tradicionalno prisutna kod nas, a inače je univerzalna a mi smo prošli kroz genocide, prošli smo kroz konflikte, bili smo pod otomanskim carstvom i konstanto smo bili pod represijom. Taj izreka kaže „kadija te tuži, kadija te sudi“, i upravo su neki poslanici i neke poslaničke grupe u prethodnom periodu kroz medije pokušavali da tuže gospodina Rikala, a danas ovde u Skupštini sa skupštinskom govornicom govorite neistine i pokušavate da ga na neki način osudite.

Mi smo izašli iz institucionalne krize koja trajala nekoliko meseci, samim formiranjem Vlade i konstituisanjem skupštine, ali mi je stvarno teško da poverujem da neko koje do juče bio u vlasi, a danas u opoziciji, nema konkretna rešenja za naše građane koji se suočavaju sa problemima. I stvarno mi je teško da poverujem da neko putem medija i institucija pokušava da stvori atmosferu linča na gospodinom Nenadom Rikalom.

Očigledno da ste pokušavali da stvorite kroz medije jednu nacionalnu euforiju, ali u tome niste uspeli, jer građani pre svega nisu verovali i građani nisu poveravali u argumente koje ste iznosili ako je zaista nisu imali nikakvu podlogu.

To je politički mentalitet koji je prisutan kod pojedinih poslanike i poslaničke grupa i taj politički mentalitet je uvek prisutan kada politiku želite da upotrebite protiv nekog kako bi prekrili svoj neuspeh i kako bih zaobišli probleme građana koji su suočavaju sa ekonomskim problemima, svakodnevnim problemima i to je politički mentalitet koji jednostavno, pokušavate jednostavno kroz politiku pronađete žrtvu kako bi opravdali svoje političke neuspehe.

Vidi se taj nedostatak vizije demokratije, vidi se i oseća da jednostavno vršite permanentno pritisak na nezavisne institucije, permanentni pritisak pre svega na tužilaštvo i na policiju i vidi se i oseća taj pritisak koji konstantno vršite na političkim predstavnicima Srba ovde u Prištini.

Mi smo stvarno kao Srpska lista u prethodnom bili zaista konstruktivni, bili smo neko koje gradio partnerski odnos sa svima, ne samo sa PDK-a ili LDK, neko sa svima smo bili spremni da gradimo taj partnerski odnos.

Ali zaista hoću da vam danas poručim da toj represiji trebamo da stanimo na put i da prestanete sa takvim stvarima.

Mislím da je pravo vreme da na neki način pokažete najpre elementarnu demokratiju, a zatim da pokažete da ne smeteni na koji način da osuđujete nevine ljude.

Ja stvarno hoću da vam kažem da se stvorila jedna atmosfera gde ja imam utisak i moje kolege i u opšte kolege Albanci sa kojima sam ja razgovarao na prethodni nekoliko dana, da se stvori utisak da oni koji su gospodina Nenada Rikala proterali 1999. Godine iz njegove Prištine sa svojom porodicom, da su sada pokušali opet da ga proteraju inicijativom ove interpelacije.

Ja hoću da vam kažem da se raspitate malo kod ozbiljnih i iskrenih građana Prištine da čujete šta one misle stvarno i šta znaju o porodici Rikalo, jer porodica Rikalo je poštena i časna porodica, porodica koja ima pre svega obraz i porodica ako se malo raspitate koja je imala najbolje odnose upravo sa Albancima u Prištini i pre rata i sa vreme rata i nakon rata do dana današnjih.

Zato gospodine Rikalo imate punu podršku Srpske liste, imate punu podršku srpskih političkih predstavnika, srpskog naroda, imate podršku da znate i Albanskog naroda i Albanskih političkih predstavnika da nastavite sa funkcionalizacijom i funkcionisanje vašeg kabineta i ministarstva. A svim poslanicima poručujem da zaista nema smisla da gubimo vreme na ovakve interpelacije, nema smisla da gubimo vreme na ovakve stvari i sigurno da trebamo da se okrenemo našem glavnom i ključnom cilju, a to je pomirenje naših naroda na ovim prostorijama.

Za sam kraj ću gospodu Rikalu da kažem postoji ono jedna pesma koja kaže “Digni ruku, digni oba dve, digni ruke od svega, imaš kartu, nemaš kartu ni do Prištine”, ja vam kažem da vi imate kartu do Prištine i želim da obnovite Prištinu vašem prisustvom i želim vam sve najbolje u daljem radu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rasim Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Personalisht nuk më ka rënë ta dëgjoj më herët emrin e zotit Nenad Rikalo, përveç momentit kur Lista serbe e kishte propozuar për ministër të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Por, kur çështja “Rikalo” u bë temë këto ditë, mësuam se ministri Nenad Rikalo paska qenë njeri publik dhe i angazhuar në shumë aktivitete publike, bile edhe me disa kolegë deputetë që sot janë këtu.

Pyetja ime e thjeshtë është: Pse nuk u ngrit nga askush kjo çështje derisa zoti Rikalo nuk u zgjodh ministër? Sidoqoftë, kërkesa, edhe pse me vonesë mbetet legjitime dhe ne nuk e kundërshtojmë.

Unë nuk dua dhe as që kam të drejtë të paragjykoj se deklaratat e qytetarëve janë të vërteta apo të pavërteta. Askush në këtë vend nuk ka të drejtë të mbajë dikë në cilindo institucion që është i përfshirë në torturat e qytetarëve, apo çfarëdo aktiviteti kriminal, sikur që askush në këtë vend nuk ka të drejtë t’i organizojë gjyq kujtdo qoftë pa fakte dhe argumente.

Prandaj, në këtë rast institucionet përkatëse të drejtësisë duhet të merren me vërtetësinë e deklaratave të disa qytetarëve.

Unë jam njëri nga njerëzit e Kosovës i burgosur e i dënuar politikisht dhe i maltretuar nga regjimet e asaj kohe, por unë sot nuk ushqej ndjenjën e urrejtjes ndaj qytetarëve serbë, të cilët nuk ishin pjesë e krimeve të luftës në Kosovë.

Krejt në fund, kërkesa ime është që të mos trajtohet politikisht kjo temë, por me vërtetësinë e deklaratave të disa qytetarëve të merren institucionet e hetuesit dhe të drejtësisë.

Cilado përgjigje që vjen nga institucionet tona kredibile të thirrura për këtë rast për mua është e pranueshme dhe e besueshme.

Prandaj, kjo vlen edhe për Parlamentin, edhe për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Së pari, Rasim ty asnjë serb nuk të ka dënuar më '81, krejt shqiptarët të kanë dënuar, kështu që korrigoje pak fjalorin tënd kur të flasësh, dhe trego me emra.

Unë dola këtu t'i them dy llafe, që së pari është turp për Parlamentin tonë që po përzihemi në çështjet e drejtësisë, e para.

E dyta, më vjen mirë që ambasadat më duket sot e kanë pushim, e s'e kanë dëgjuar këtë interpelancë e të na thërrasin në Dragodan e të thonë 'çka doni të flitni', se nuk kishim guxuar hiç të flasim se kur u arrestua Ramush Haradinaj, shumica prej ish-deputetëve, le që janë gëzuar, por kanë thënë 'mos u përzini në çështjet e Hagës'.

Kur u bë debat për rastin "Kiçina", i di me emër e mbiemër të cilët deputetë janë ngrit këtu edhe kanë thënë mos u përzini në rastin "Kiçina", nga i cili tash e 16 vjet Arsim e Burim Ramadani po mbahen padrejtësisht dhe pafajësisht në burgjet e Kosovës.

Ne kemi njerëz të krisur që publikisht në televizion e kanë akuzuar gruan e Rexhep Selimit dhe kanë thanë që gruaja e Rexhepit, një luftëtare e jashtëzakonshme në luftë, me krejt familjen që ka ardhur nga Gjermani, ky i krisur doli në televizor edhe tha më ka rreh thupër në burg.

Një tjetër u qua atje thoshte "në bazë të dëshmimeve të Milosheviqit, Milaim Zeka e ka vrarë Ahmet Krasniqin". E hajde tash në bazë të këtyre akuzave ne po mbajmë këtu çdo ditë debate e seanca, e po themi "hajde a t'i akuzojmë a të mos i akuzojmë".

Po të kishin dashur deputetët e këtij Parlamenti të Kosovës ta aprovonin Ligjin e lustrimit, nuk do të ishte bërë kryeprokuror Hilmi Zhitia, që ia ka arrestua e ia ka dënuar babën Liburn Aliut, Ali Aliun. Nuk do të ishte bërë kryeprokuror Flamur Kelmendi edhe pas lufte, që e ka dënuar të madhin Ramadan Shala, se ti edhe Liburni jeni të dytë si vëllezër, jua kanë vënë emrat ty Liburn dhe Liburn Shalës, e që ka arrestuar dhe e ka dënuar familjen time. E ata djem të tyre, të Serbisë, të argatëve të Serbisë, që na kanë dënuar, ata kanë hapur medime, ata kanë hapur portale e po na dënojnë çdo ditë nëpër portalet e tyre e nëpër televizione, e nëpër redaksi, sepse shumica e ju deputetëve këtu keni portale private. Çdo parti politike këtu keni portale private, televizione private, e njerëz gazetarë të shitur që për 100 dollarë ta shkatërrojnë familjen, ta shkatërrojnë dinjitetin, ta shkatërrojnë personalitetin tënd.

Prandaj, hajde të debatojnë ajo që neve na takon, hajde t'i hapim dosjet, hajde ta bëjmë lustrimin, hajde të këqyrim kush është u bë argat e Serbisë, hajde të këqyrim cilët kriminelë të Serbisë punojnë sot në Policinë e Kosovës. Janë hetuesit kryesorë në krye me çiftin e Fadil Sylefiqit, e plot të tjerë, cilët prokurorët e Serbisë sot punojnë në Prokurori të Kosovës. Këtë duhet ta debatojmë ne, e jo të përzihemi në çështjet e drejtësisë, e jo të vijmë portalet e të na hyjnë neve këtu brenda Parlamentit. Portalet! Na kanë hyrë faqezinjtë brenda këtu dhe ne si deputetë hajde të sjellim ligje për ta disiplinuar këtë vend, sepse ndryshe na rroi dreqi. Hajde të sjellim Ligjin për lustrimin dhe nuk kishim pasur ne nevojë të merremi me zotin ministër.

Në qoftë se ky burrë është fajtor, ose ky mashkull, ky duhet ta marrë dënimin e merituar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Çohu merre fjalën, t'i zbret ai minutat atje. Jepja ti. Kush po do t'ia japë? Dauti po do t'ia japë minutat e vet.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit!

Nuk e di kush është kah shqetësohet për listën e lustrimit, por sido që të jetë shpresoj të ndodhë shpejt. Milaim, krejt minutat që i ka Aleanca i ke në dispozicion.

KRYESUESI: Tetë minuta i ke, Milaim!

MILAIM ZEKA: Unë e dëgjova kryetarin Albin Kurtin që e krahasoi këtë të shkretin me Vasa Çubriloviqin. Merre me mend kush ka qenë Vasa Çubriloviqi, e kush është Rikalo, e para.

E dyta, e th një diçka Albin Kurti shumë me vend. Në qoftë se ne dikush dimë që ka ndodhur në krim dhe nuk e paraqesim, edhe ne jemi bashkëfajtorë. Jam absolutisht për.

Por, të nderuar deputetë,

Le të çohet vetëm dikush le të dalë në këtë foltore prej ju deputetëve dhe le të më tregojë që nuk janë bërë akuza publike vend e pa vend, qoftë për vrasje, qoftë për krim të organizuar, qoftë për uzurpime, qoftë për çdo gjë. Në qoftë se ne shkojmë sipas logjikës të këtyre portaleve, sot po shkruan portali serb i përkthyer në gjuhën shqipe "Insajderi" po thotë - "pasi ne folëm diçka, Prokuroria e inicioi çështjen".

A e dini or të nderuar deputetë, që këtu prokurorët tanë bëhen kaps prej gazetarëve rrugaçë? Po çfarë prokurori i hamamit është ai që del atje e dridhet si pulë e ndukur prej një gazetari laper, rrugaç, i cili ka qenë babë e babagysh spiun i Serbisë. Babë e babagysh, Vehbi Kajtazi! Ai tjetri, Pajtim Ulluri ka qenë i dyshuar e i hetuar për lidhjet e tij me ISIS-in, pasi familjari i tij

është vrarë me ISIS-in në Siri. Del e na përgojon të gjithëve dhe ne i rrahim shuplakë. Të mos i rrahim shuplakë të keqes.

Prandaj, jorastësisht Bundestagu Gjerman ka sjellë ligje për t'i disiplinuar portalet, për t'i disiplinuar mediat, për t'i disiplinuar fyerjet e sharjet. Mosni, sepse në qoftë se ne nuk marrim vendime për ta disiplinuar jetën kulturore, shoqërore, njerëzore në këtë vend, ne më mirë të mos dalim, jo në rrugë, por para fëmijëve tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: AAK-ja i ka edhe tre minuta, a është dikush i AAK-së, Shkumbini e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: I nderuar kryesues!

Kryeministër,

Faleminderit që patët durimin bashkë me Kabinetin ta dëgjoni këtu. Fajin e kanë qeveritë e kaluara, se Pallatin e Drejtësisë e kanë zhvendosur përtej Hajvalisë dhe njerëzit e këtij vendi po përtojnë të shkojnë edhe te Prokuroria, edhe te gjyqësia, për t'i deponuar ato shkresa që i kanë. E kanë gjetur më afër këtu të vijnë e të hyjnë në Parlament për të bërë gjyqe, e thashë edhe dje, në Qeveri.

Unë dëgjova fjalë më herët, thotë “pse po e marrin barrën kryeministri dhe Qeveria”. Njëkohësisht janë të njëjtit njerëz që kërkojnë interpelancë prej kryeministrit dhe Qeverisë për të bërë gjyq këtu. U kam thanë edhe dje, i 22-ti përfundon. Mos u merrni me fushata zgjedhore dhe t'i nënçmoni njerëzit e këtij vendi. Kushdo që është, kryeministri Haradinaj nuk e ka bërë Qeverinë vetëm Aleancën, por edhe ata të Aleancës, por edhe ata të tjerë, nëse janë ministra, të gjithë paditni. A keni dokumentacion, shkoni shkruani dy letra, se po më duket në legjislaturat e mëhershme vetëm i kanë marrë të shkruara dhe kanë pasur të vijnë për t'i lexuar. Le të punojnë për secilin rast, drejtësia është për të gjithë.

Unë dëgjova edhe fjalë tjera, thotë “çdo qytetar serb që e ka moshën mbi 36 vjet, kur duhet të punësohet diku duhet të verifikohet”. Nëse është kriminel duhet të verifikohet, jo vetëm kur të punësohet, por kudo që jeton, po jo të vendosen standarde të dyfishta mbi një popullatë. Do të thotë, vetëm për ata vlen, por edhe për qytetarët e këtij vendi, çdo njëri që e ka bërë një faj le të gjykohet, por le të drejtohen te organet e drejtësisë. Vijnë këtu për interpelancë e flasin diçka tjetër, merren me takimet Thaçi-Daçiq, 2013. Askush para Albin Kurtit nuk e ka takuar Daçiqin. Ka qenë në grupin e studentëve që kanë bisedua bashkë me Lidhjen Demokratike me inicimin e Shën Egjidos gjatë vitit '98 në fillim për lirim të objekteve shkollore dhe fatmirësisht atij ia kanë pranuar më së pari atëherë. Është liruar Fakulteti Teknik. Do të thotë kanë marrë pjesë, i kanë takuar, sigurisht po i vjen inati që nuk po mund të mbërrijë vetë, por kur të vijë në Qeveri le t'ia shkelë, rruga për Nish - autostrada po flitet që do të ndërtohet se duhet të lidhet rajoni, e në këtë rast të mos bëjmë tema politike. Urdhëroni, Pallati i Drejtësisë ju pret, kushdo që ka le të deponojë çka të dojë. Dëshmitarët le të shkojnë, le të deklarohen atje.

Po edhe në aspektin Rikalo, jam jurist, ju kam thënë dje, e shoh se shumë qytetarë serbë sot nuk po kthehen në Kosovës për veprimet e bëra. Ky njeri është deklaruar se u kthye menjëherë pas luftës. Nuk po flas për pafajësinë ose fajësinë e tij. Edhe ka bashkëpunuar me shumë njerëz këtu në shoqërinë civile dhe ka marrë rrogë prej institucioneve të Republikës së Kosovës. U gjet rasti që në fushatë zgjedhore të marrim dhe të krijojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Donika Bujupi-Kada.

DONIKA KADA-BUJUPI: Faleminderit, kryesues!

Në fakt të gjithë ata që sot po e bëjnë avokatin e Rikalos, në vitin 2015 kanë qenë bashkë me ne në protestat kundër Jablanoviqit për një deklaratë të tij.

Sot këtë interpelancë e kemi thirrur, jo për shkak të deklaratave, por për shkak të supozimeve për vepra kriminale gjatë luftës në Kosovë.

Prandaj, nuk është në rregull të ngutemi dhe ta bëjmë avokatin, sepse, me gjithë faktin se kryeministri doli këtu dhe tha se “e kemi verifikua nëpërmjet tri institucioneve relevante”, ndodhën zhvillimet e reja dhe erdhën edhe 20 dëshmitarë shtesë, të cilët dëshmuan për krime jo të lehta, por krime të rënda të dhunimeve, të kërcënimeve fizike, të rrahjeve brutale dhe të plaçkitjes, që kanë ndodhë deklarohet në këto dëshmi të 20 qytetarëve të “Dardanisë” gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë që institucionet e Republikës së Kosovës kanë dështuar në grumbullimin e fakteve dhe argumenteve për krimet e luftës të kryera në Kosovë gjatë luftës së fundit.

Janë 20 mijë gra të dhunuara, e sa raste të ngritura. Sa kriminel sot përndiqen ose emrat e sa kriminelëve janë sot në kufijtë e Kosovës kur ata futen dhe dalin nga Republika pa u verifikuar dhe pa u ndalë asnjëherë. Besoj që shumë pak, fare pak, për të mos thënë asnjë.

Janë 10 mijë viktima civile të vrarë dhe sa raste hetohen, ose sa aktakuza janë ngritë, ose sa kriminelë e vuajnë burgun për këto vrasje?

Janë mbi 200 mijë prona të shkatërruara dhe kush ka ngrehur padi për këto prona, ose kush është duke u ndjekë për këto krime? Por, kryeministër, kjo nuk do të thotë që ne duhet t'i mohojmë krimet e kryera për shkak se kemi dështuar për t'i ofruar faktet, apo jo?

Është e njëjta me rastin e ministrit tuaj, të cilin ne po besojmë që e keni emëruar dhe deputetët e kanë votuar pa e ditur historinë e tij dhe pa i ditur veprimet e tij politike dhe kriminale në të kaluarën. Mirëpo, kjo po ashtu nuk ju jep të drejtën që ju të vazhdoni ta mbani ministër edhe tani pas 20 deklaratave të 20 dëshmitarëve për krimet e supozuara.

Prandaj, ne ju thërrasim - shkarkojeni Rikalon! Shkarkoni Rikalon, jo pse është serbë, jo pse është i komunitetit serb, por sepse 20 qytetarë shqiptarë e kanë denoncuar dhe ngrenë dyshimet e bazuara që ky ka kryer krime ndaj tyre. Shkarkojeni dhe zëvendësojeni me një ministër tjetër, i cili nuk ka keqtrajtuar shqiptarë dhe i cili nuk ka bërë krime.

Nëse jo dhe nëse ju vazhdoni ta mbron, atëherë jeni përgjegjës për protestat dhe për proceset politike që do të pasojnë. Për më keq, ata që e mbrojnë krimin do të jenë bashkëfajtorë kur ky krim eventualisht pa dashur të paragjykoj të vërtetohet nga 20 qytetarë të Republikës së Kosovës të etnisë shqiptare, të cilët edhe sot banojnë në “Dardani”.

Nuk është e drejtë që këtu në Parlament të dalin deputetë dhe të kërkojnë vërtetësinë e deklaratave të qytetarëve shqiptarë. Nëse ju po dyshoni, atëherë cili është motivi, cili do të ishte motivi i një gruaje, e cila publikisht del në televizor dhe flet për dhunën, të cilën serbët, në këtë rast ministri juaj e ka ushtruar ndaj saj. Prandaj, edhe një herë ju thërrasim që ta shkarkoni, ta dëgjoni zërin e qytetarëve dhe zërin e këtij Kuvendi, në mënyrë që të mos na përsëriten situata siç kanë ndodhur në vitin 2015, protesta në të cilat edhe ju personalisht keni qenë pjesëmarrës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Përshëndetje,

Kryesues dhe kolegë të nderuar,

Përveç që ndoshta pak ose shumë po dilet nga tema, për të cilën kemi ardhur të diskutojmë sot këtë pasdite, besoj se po bëhet një çështje tjetër, që është një përzierje e dy koncepteve ose, thënë më mirë, dy standardeve tërësisht të ndara: në njërin anë kemi standardin e përgjegjësisë ose gjykimit, që ndodh në një instancë gjyqësore për kryerjen e një vepre penale. Aty ne të gjithë si deputetë duhet të kemi shumë kujdes kur deklarohe mi që të mos interpretohet ose që të mos merret si ndikim në një pushtet që është edhe me Kushtetutë i pavarur dhe i ndarë nga ky institucion.

Pra, të kemi kujdes kur deklarohe mi qoftë për raste në të kaluarën, qoftë për ato që janë aktive aktualisht. Mirëpo, në anën tjetër, çka është me rëndësi dhe çka është në kompetencën tonë është çështja e kërimit të përgjegjësisë morale ose, thënë më mirë, përgjegjësisë politike. Unë besoj që kemi të gjithë të drejtën që këtë përgjegjësi ta kërkojmë jo vetëm nga ministri Rikalo, për të cilin jemi mbledhur sot këtu, por nga të gjithë ne si anëtarë të Parlamentit, por edhe nga ata që shërbejnë në ekzekutiv. Tash ne, si qytetarë dhe si deputetë, po edhe si përfaqësues të popullit

duhet ta pyesim veten: a dëshirojmë që standardi ynë për të qenë edhe për të shërbyer për këtë popull në kuadër të ekzekutivit të jetë ai që, në fakt, vetëm kërkohet të mos ketë ndonjë aktakuzë aktive edhe të mos ketë ndonjë vepër penale për të cilën je gjykuar.

Vaj halli për neve nëse e lëshojmë standardin aq ulët. Unë besoj se të gjithë dëshirojmë që standardi të jetë goxha më i lartë, të jetë aq i lartë sa që ministrat tanë të merren me punët që i kanë ditore, e të mos e kalojnë kohën e tyre duke u marrë në pyetje qoftë në prokurori, apo në ndonjë organ tjetër. Kështu që unë besoj që në këto instanca kur bëhen aktakuza, jo thashetheme të ndryshme nëpër portale, por kur bëhen akuza publike serioze nga qytetarët e këtij vendi, për vepra penale jashtëzakonisht të rënda që ndërlidhen me një periudhë shumë traumatike për qytetarët tanë, atëherë të kihet shumë kujdes si procedohet tutje dhe të jepet përgjegjësi politike dhe morale së paku derisa të dalë në shesh e vërteta.

Unë besoj që përgjegjësia e parë bie mbi ministrin që të kërkojë nga kryeministri që ta lirojë ose ta pezullojë së paku përkohësisht nga detyra, derisa të qartësohet e vërteta lidhur me këtë. Por nëse këtë nuk e bën ministri, atëherë natyrisht kjo përgjegjësi, se më herët u fol për barrën e të provuarit, këtu bie përgjegjësia e barrës edhe barra te kryeministri që të veprojë. Sepse, besoj se qytetarët meritojnë shumë më mirë se sa të kenë ministra, prapë po them që enden korridoreve të prokurorisë dhe janë në krye të detyrës.

Tash, këtu po kthehem te një çështje që e kemi thënë edhe më herët. Problemi qëndron se si të shkarkohet dikush në një qeveri që është ndërtuar rreth tyre dhe është njëfarë mënyrë kushtëzohet ekzistenca e qeverisë nga pjesëmarrja e Listës serbe në këtë qeveri. Pikërisht këto kanë qenë edhe arsyet pse kam ngritur shqetësimin tim në fillim, por sidoqoftë, po them prapë, përgjegjësia politike bie fillimisht mbi ministrin, e pastaj mbi kryeministrin dhe njëkohësisht nëse ata nuk janë në gjendje ta bëjnë, t'i përgjigjen kësaj përgjegjësie politike dhe morale, atëherë ne jemi të detyruar që ta votojmë edhe mocionin e sotëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani Grupi Parlamentar i PDK-së, respektivisht zoti Beqa ia ka dhënë dy minuta zotit Haradinaj për të diskutuar.

DAUT HARADINAJ: E kërkova fjalën më herët, pata një gjysmë replike me Donikën, kur po i sulmon komunitetet. Duhet ruajtur mos po i hidhërohet nëna e vet dhe s'po e bën kurrkush këtu avokatin e kurrkujt, por janë organet e drejtësisë që do ta thonë fjalën e vet. Jo vetëm për këtë rast, por për të gjitha rastet.

Kështu që të mos na shesin moral fort se i njohim mirë.

KRYESUESI: Faleminderit! Emrin tënd s'e ka përmendur, jo "Vetëvendosja" s'është Donika. Donika mundet të flasë, jo ti. Për replikë, të drejtën për të diskutuar e ke sa të duash, por mos e

merr... Mirë, mirë, po jo, s'e ka përmendur kurrkush "Vetëvendosjen". E përmendi Donikën, ani de, merri minutat e partisë sa të duash, thuaj çka të duash, por kërkoje replikën si duhet.

GLAUK KONJUFGA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Dëgjova shumë deputetë, sidomos të AAK-së, Rasimin, Shkumbinin, Dautin tash së fundi, me një margaritar, të cilët po e shpjegojnë në mënyrë të jashtëzakonshme mbrojtjen e komunitetit serb, thuajse "Vetëvendosja" këtu sot ka ardhur, apo opozita për të sulmuar komunitetet e tjera, e ju paskeni ardhur që t'i mbron.

Pavarësisht, cilin komunitet, Daut, ne e dimë këtu kush çka ka thënë për komunitetet në Kosovë. Krejt e dimë, secili çka ka thënë. Dikush bile edhe ka thënë edhe shumë fjalë të rënda, e është dashur në televizion të kërkojë falje. Krejt i dimë, secili çka ka thënë, e si është detyruar t'i përpijë fjalët e veta. Mirëpo, kur dëgjoj sikur ju që bëni e si Shkumbini që s'ka fije turpi, thuajse opozita paska shkuar i ka organizuar familjet e Dardanisë të dalin e të thonë që ministri këtu, të cilin e kemi ulur, është i akuzuar se ka dhunuar banorët e Dardanisë, se ka plaçkitur dhe se ka qenë në krye të disa bandave që kanë ushtruar dhunë në Dardani. A opozita ka dalë e i ka organizuar ata njerëz, a?

Si s'keni fije turpit, së pari duhet pasur respekt për ato familje dhe s'duhet të flisni në këso mënyre. Së pari duhet thënë: ngadalë, disa familje të qytetit të Prishtinës paskan dalë dhe po thonë që në fotografi është ky që na ka dhunuar, kaq. Pra, veç për këtë duhet pasur respekt edhe të zhvillohet debati ashtu qysh duhet. E tash, të dalim te debati. Unë po dua ta mbroj Parlamentin e Kosovës. Këtu u bë sulm edhe kundër Parlamentit të Kosovës me disa primitivizma, të cilat nuk i kanë hije kësaj foltoreje. Me çfarë primitivizma? Për shembull: "Ky nuk është gjyq, këto tema nuk diskutohen këtu". O, zotërinj, kjo është republikë parlamentare, republika e mbikëqyr qeverinë, njëri prej zyrtarëve më të lartë të qeverisë është vënë në spikamë të disa familjeve të kryeqytetit që ka ushtruar dhunë gjatë viteve '98-'99. Edhe të mos kishte qenë zoti Rikalo pjesë e qeverisë, edhe të mos kishte qenë ministër, madje, veç njeri i thjeshtë të kishte qenë, ne ishte dashur këtu të mbajmë debat. E lëre më që është ministër, ministër në Qeveri. Më falni, por kjo është serioze. Kjo nuk diskutohet në gjykatë, o zonja dhe zotërinj! Kjo diskutohet në Parlament të republikës, këtu diskutohet, se këtu del përpara Qeveria, këtu jep llogari Qeveria, edhe njëri prej ministrave, ne nuk po flasim për të gjithë, ata në Dardani nuk janë ngritur të thonë 21 ministra të Qeverisë Haradinaj kanë problem me këtë punë. Një, ky është Rikalo dhe ne pa dyshim që shumë mirë që po debatojmë, edhe duhet të diskutojmë këtu.

Se këtë nuk duhet të diskutojmë, por ta çojmë në prokurori, kjo është e turpshme, Shkumbin. Në prokurori këto familje, mbaje në mend, këto i kanë dërguar, edhe pse është larg në Hajvali, që po thua ti, larg qenka, këta nuk kanë përtuar, Shkumbin, të shkojnë, i kanë deponuar, nuk e di a e di, i kanë deponuar, Shkumbin. E, prokuroria nuk është marrë me këtë çështje, duhet të merret. Dhe, ne po e ngremë shqetësimin tonë kështu: nëse Parlamenti e mbikëqyr Qeverinë, nëse Qeveria

duhet të vijë këtu për të na dhënë llogari, është ngritur një problem. Problemi është ky: disa qytetarë të Kosovës po e akuzojnë ministrin e Qeverisë për dhunë. Por, është, unë mendoj, një problem tjetër pse ju detyroheni të bëheni avokat i Rikalos, është një problem tjetër kund dhe dua ta shpjegoj këtu pse.

Kjo Qeveri është një Qeveri, e cila për shkak të konstelacionit të numrave e imponon peshën absolute të individit. Individit në këtë qeveri është absolut. Nëse hidhërohet një individ, menjëherë ia nisnin të lëkundën themelet e Qeverisë, prandaj shkarkimi i Nenad Rikalos, shkarkimi eventual i Nenad Rikalos e rrezikon vetë themelin e kësaj qeverie. Ky është problemi, pse s'po e thoni në mënyrë të sinqertë, pse s'po e thoni në mënyrë të hapur. O, ju nuk jeni duke e mbrojtur Rikalosin pse doni e pse keni qejf, shumica jeni prej familjeve që kanë dhënë për Kosovën, familjeve patriotike që s'kanë kursyer asgjë për këndë vend. Shumica prej juve, edhe atje të AAK-së, edhe të "Nismës", edhe të PDK-së që po i shoh, me shumicë jeni prej atyre familjeve, po detyroheni ta mbronin për shkak të pushtetit, jo pse e doni këtë!

A besoni, të mos kishit qenë në pushtet, i kishit thënë të njëjtat fjalë që po i them unë. Pse? Pse nuk është që po spekuloj, po ju kam parë vetë. A kemi qenë bashkë që kemi rrëzuar Jablanoviçin, a kemi qenë bashkë? Po ai për një fjalë goje është rrëzuar, tash ky ka akuzë shumë më të rëndë. Ky ka akuzë për krime lufte, jo aktakuzë, por akuzë, domethënë prej qytetarëve, se aktakuzë është kur të bëhet atje në gjyqësi, ne nuk merremi me atë punë.

Kështu që kaq për këtë çështje, ne duhet të debatojmë a s' duhet të debatojmë dhe pse po mbrohet Nenad Rikalo këtu.

KRYESUESI: Zakonisht, veç Ramushi mund të flasë si përfaqësues i Qeverisë sa herë do, AAK-ja i ka shpenzuar minutat. Prit de, ngadalë s'po dua ta ndal fjalën. I kanë të pavarurit 9 minuta, ata pa grup që janë, në qoftë se këta jua japin ndonjë minutë, mund ta merrni ose dikush tjetër.

Veç të deklaroheni, unë nuk mundem. Zoti Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Po i dëgjoj mendimet e të gjithëve, faleminderit për mendimet, edhe Glauk, nëse bën me ty. Shiko, nëse e merr pozicionin tim mbrojtje të zotit Rikalo, ke të drejtë të gjykosh ashtu. Pozicioni im është pak më i qartë, besoj. Shpjegova procesin si e kam trajtuar këtë temë deri sot, nëse ti thua mbrojtje dhe po e mbroj, ndoshta je duke prejjudikuar se qenkam vënë në mbrojtje të një ngjarje. Unë ju kisha lutur pa marrë parasysh çka i thoni njëri-tjetrit si deputet, ruajeni substancën e asaj pse kemi ardhur këtu, se unë kam pranuar dhënien llogari para Parlamentit, edhe njëkohësisht e kam respektuar sot kërkesën e një grupi parlamentar për këtë temë.

Është paragjykim i hershëm të thuhet se po mbrojmë këndo, kushdo qoftë, edhe ka edhe shumë më shumë elemente që na obligojnë të shkojmë prej hapi në hap, pse po them prej hapi në hap? Po ju them të drejtën, unë kam qenë në një proces gjyqësor, Glauk, kam pasur shumë dëshmitarë të rrejshëm, besoni kam pasur disa prej tyre jo veç të kombësive të tjera, për këtë arsye ju kisha lutur, tash ne mund të kalojmë ndonjëherë në ndonjë etapë tjetër, jo gjithë kohën kështu. E kuptoj edhe procesin, jo, jo, nuk ka lidhje ajo punë, unë s'kam ardhur për ata, më falni. Unë jam veç në funksion të një bashkëbisedimi me deputetët, dhe sido që ju duket diskutimi i njëri-tjetrit, mendoj se Qeveria sot jo vetëm që e ka respektuar kërkesën për interpelancë, por është e gatshme të respektojë në vazhdimësi çdo obligim që i del edhe në këtë temë, edhe në tema të tjera.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Tema luftë dhe çdo gjë që ka të bëjë me kohën e luftës është një temë e cila është e ngarkuar me emocione të forta, por më lejoni të kthehem pak te paraqitja e zotit Kurti.

Kjo temë, zoti Kurti, ty ta ofron platformën e duhur për të recituar në mënyrën teatrale propagandën tënde patriotike, por pasi bërë paralele me Çubriloviqin, desha ta rikujtoj se koha e Çubriloviqëve në Kosovë ka vdekur dhe se kjo kohë tashmë ka marrë vulën e gjakut. Se sa i dobët është ky vend, nuk je ti Profeti që e jep lajmin e madh. Çdo vend që kalon nëpër proceset që ka kaluar Kosova i duhet kohë për t'u konsoliduar dhe marrja e vendimeve emocionale nuk i kontribuon forcimit të shtetit, por përkundrazi, e dëmton dhe e zbeh atë.

Sa i përket tentimit tënd për t'i shpallur dëshmitarët në fjalë si persona të rrezikuar, është thjesht diçka jomorale nga ana jote. Nëse thua "janë të rrezikuar", atëherë trego nga kush rrezikohen dëshmitarët në fjalë. Nga ti, zoti Kurti, sot para skenave teatrale që bërë, kisha pasur shumë dëshirë të dëgjoj për bashkëpunimin tuaj me Rikalon në të kaluarën, sepse është folur gjerë e gjatë këto ditë që ju keni pasur një bashkëpunim shumë të ngushtë, kur dihet se zoti Rikalo ka qenë një person publik në Kosovë.

Të nderuar, ne të gjithë jemi dëshmitarë të proceseve të një drejtësie selektive të bazuar në akuza të pabazuara, mbi të cilat kemi parë dënime të shumta. Dënime kundër të cilave shumë nga ne e kemi ngritur zërin edhe këtu në Parlament. Edhe sot kemi zyrtarë të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët janë mbrapa grilave në bazë të një urrejtjeje euforike dhe shumë nga ne e kemi dënuar këtë qasje selektive të drejtësisë, këtë qasje të padrejtë.

Sa i përket rastit Rikalo, e përgëzoi kryeministrin Haradinaj, i cili mori hapat e duhur për të kërkuar informata nga institucionet përkatëse dhe për të marrë një vendim. Në anën tjetër, kemi deklarata se zoti Rikalo ka qenë i involvuar në dhunë kundër shqiptarëve. Është për të ardhur keq në qoftë se këto akuza kanë bazë dhe tash e 17 vjet askush nuk e ka ngritur një akuzë të tillë kundër zotit Rikalo. Nuk më takon të akuzoj askënd, sepse deri sot nuk paska denoncuar këtë rast, por sinqerisht është për të ardhur keq në rast se shqiptarët kanë informata të tilla dhe nuk e kanë parë dhe nuk e shohin të udhës që ta bëjnë deklarinimin e tyre, derisa një i tillë ta marrë një post qeveritar.

Të gjithë ne jemi për hetim të të gjitha akuzave dhe në rast se gjendet qoftë edhe vetëm një fakt, ne do të bëhemi bashkë për të marrë vendimin për shkarkim. Por ne duhet të jemi kundër një drejtësie të bazuar në thashetheme apo të ngjashme. Ata, të cilët deklarojnë se zoti Rikalo ka qenë i përfshirë në krimet kundër shqiptarëve le të ofrojnë dëshmitë e tyre. Unë i inkurajoj që ata të ofrojnë dëshmitë, të cilat i kanë tek organet kompetente dhe të kontribuojnë në zbardhjen objektive të këtij rasti.

Mendimi im si qytetar i këtij vendi, dhe si deputete e Partisë Demokratike të Kosovës, është se asnjë qytetar i këtij vendi, pa dallim etnik, gjinor, fetar e tjera, nuk duhet të bie pre e përndjekjeve personale politike. Apeloj që ne të gjithë të kontribuojmë që institucionet tona ta bëjnë punën e tyre në bazë të ligjit dhe të bazuar vetëm në fakte. Para faktit dhe argumentit të gjithë duhet t'i ngremë duart lart. Askush, qoftë Rikalo apo edhe nga komunitetet e tjera, duke filluar nga komuniteti shumicë, në rast të implikimeve në krime lufte nuk e ka vendin në Qeveri dhe në këtë pikë besoj se jemi të gjithë të një mendimi. Prandaj, të trajtojmë me gjakftohtësi dhe të presim rezultatet e hetimeve nga ato institucione që kanë përgjegjësinë e tyre për këtë rast.

Megjithëqë deri sot qytetarët shqiptarë nuk kanë bërë asnjë kallëzim penal, megjithatë ne jemi që këta qytetarë të ofrojnë sa më shpejt faktet që posedojnë dhe pasi këto të faktohen, ne duhet të jemi në vendin adekuat.

Ftoj qytetarët e Kosovës që jo vetëm për këtë rast, por për çdo kënd që kanë fakte të lajmërohen tek organet kompetente, pavarësisht që tani pas 17 vjetëve është vështirë ndoshta edhe të gjenden gjurmë, fakte, të cilat janë relevante, ndërsa qytetarëve të Dardanisë unë u jap fjalën time publike që në qoftë se vetëm një argument vërtetohet se zoti Rikalo ka bërë keqtrajtimin e qytetarëve shqiptarë, unë do të jem e para ajo e cila do ta ngre zërin dhe do të kërkoj shkarkimin e tij.

Dua të lidhem pak edhe me dy koleget e mia nga “Vetëvendosja”, njëra është Albulena Haxhiu, e cila më befasoi shumë me reagimet e saj në momentin kur në foltore doli Andin Hoti, e cila vazhdimisht gjatë kohës kur ai po fliste, kjo bënte zhurmë dhe thjesht ndërhynte në fjalimin e tij. Ndërsa, për çudi menjëherë pas Andinit doli, do të thotë deputeti i Listës serbe, zoti Simiq, ndërsa Albulena nuk bëri asnjë zë dhe e dëgjoji me shumë vëmendje.

Gjithashtu, Donika Kadaj-Bujupi edhe kjo bëri shumë pyetje pse kriminelët serbë jetojnë të lirë, pse e kalojnë kufirin, pse nuk kemi asnjë dëshmi, ose thjesht nuk kemi asnjë emër të atyre që kanë bërë krime? Përgjigjja ime shumë e shkurt është për ty, Donika, sepse ju jeni lodhur e krejt energjinë, e cila është dashur të shfrytëzohet në të mirë të këtij vendi, jeni duke e harxhuar për të ndotur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe duke u marrë me atë se çfarë ka bërë SHIK-u. Sa herë në këtë Parlament keni thënë se serbët kanë bërë krime? Asnjëherë. Jeni marrë gjithmonë me SHIK-un dhe me bëmat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

KRYESUESI: Deputetët pa grup parlamentar i kanë 9 minuta, disa minuta ia kanë dhënë Shkumbin Demaliajt. Prit, Shkumbin, zotit Labinot Tahiri për replikë.

LABINOT TAHIRI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Ju përshëndes të gjithëve, nuk kam kundër-replikë, por për mendimin tim është më mirë të bazohemi në pyetjen e Dardan Molliqajt që i bëri më herët kryeministrit për punën e vizave, që demok në afatin tremujor kanë prezantuar dhe kanë garantuar shumë parti politike që do t'i kenë vizat qytetarët e Kosovës. Do të thotë, më mirë në atë pyetje të bazohen të gjithë deputetët, edhe pse shpresoj shumë se zoti kryeministër do të arrijë atë me ministrat e tij, se sa në punën dhe çështjen e zotit Rikalo.

Kam qenë organizator në protestën në Ferizaj bashkë me qytetarët e mi për shkarkimin e Jablanoviqit dhe dihet se është shkarkuar. Unë mendoj dhe ju garantoj që nëse diçka gjendet për ato akuza ndaj Rikalos, mendoj se kryeministri pa një pa dy do ta shkarkojë, por prapë do të jem një organizator i tillë siç kam qenë në Ferizaj, kundër Rikalos për ta shkarkuar. Mirëpo këtu na shkoi dita duke folur për Rikalon, derisa para se të bëhej ministër kurrë s'kisha dëgjuar për të, edhe pse për shumë keqberës në Kosovë kam lexuar dhe i di emrat e tyre.

Tjetra, nëse ia keni mësyre që ta rrëzoni Ramush Haradinaj, e keni të kotë, më vjen keq nëse dikush prej deputetëve si nga ana e LDK-së dhe e "Vetëvendosjes" që ta rrëzojë, për arsye se deri dje i keni dhënë pipëza e gaz të gjuajë këtu, edhe për hir të asaj që ka menduar që është e keqe për Kosovën ish-Qeveria që ka qenë, iu ka bashkangjitur atij bashkëpunimi me ju. Unë mendoj që nuk keni mundësi ta rrëzoni, se është duke punuar më mirë se sa herëve të kaluara në Kosovë që ka punuar ndonjë qeveri, dhe duhet të besojmë. Mbi të gjitha, kaq shumë e keni dashur, para 6 muajve shkonin edhe në Francë që të bëni fotografi, e të rrini me të, faktikisht paskan qenë fotografi vetëm për fushatë elektorale.

Unë nuk jam as PDK, as "Vetëvendosje", as LDK. Unë jam në AKR, të gjitha partitë politike më kanë bërë ftesë të jem anëtar i tyre, por unë jam me Behgjet Pacollin. Edhe dje është folur nga

një ish-ministre që është demok jo e dinjitetshme që zoti Pacolli t'i ketë me dy deputetë tërë ato ministri. Është e rëndësishme të jesh i zoti, të formosh qeveri dhe të mos humbë shteti miliona, se sa ministri i kemi e sa i marrin e i japin, nuk është shumë e rëndësishme. Kështu që sot ky debat po më duket i kotë, ndërsa është shumë i favorshëm për ato familje që kanë ngritur shqetësim për zotin Rikalo.

Pra, edhe një herë po e potencoj që, në rast se diçka hetuesia vendos që i ka bërë ato krime gjatë asaj periudhe, unë zotohem që do të jam i pari në protesta për ta rrëzuar ose për ta shkarkuar zotin Rikalo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shkumbin, e ke fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryesues!

Desha të them se Grupi i Aleancës nuk është duke e bërë avokatin e askujt, por menduam se na u harxhuan minutat edhe deshën që të na sulmonin në fund. Nuk ndjehem i turpëruar nga njerëzit që bukën e hanë me turp, edhe në rast se është në pyetje pushteti, unë nuk e di pse ekzistojnë si parti politike.

Një parti politike krijohet për të ardhur në pushtet, kanë vakt, por me këto mend jo. Edhe po ju kallëzoj prej këtu që askush më s'është duke i marrë seriozisht. Rrezikshmëria e atyre qytetarëve nga Rikalo nuk mund të jetë më e madhe se rrezikshmëria e Albin Kurtit, flas nga deklaratat e zotit Rikalo, thotë kam luajtur basketboll me të pasluftës. S'di qysh s'qenka qenë i rrezikuar Albin Kurti duke luajtur bashkë basketboll, e tash gjoja po na u dhimbkan ata qytetarë! Jemi për ta rregulluar çështjen e secilit element, kushdo që ka bërë më të voglin krim, se lëre më krime lufte, le të drejtohet, thashë edhe një herë te Pallati i Drejtësisë, se po marrin kohë. Faleminderit!

KRYESUESI: Veç diçka, domethënë Lëvizja "Vetëvendosje" i ka edhe 12 minuta e 45 sekonda, sa të duash mund të flasësh. A po do të flasësh? Zotit Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Vetëm për këtë çështjen lidhur me këto gënjeshtër që janë ngritur shumë kohëve të fundit për të zhvendosur vëmendjen prej akuzave të banorëve të Dardanisë. Tash Rikaloja qenka shok i "Vetëvendosjes", për këtë desha të sqaroj një gjë. Këto jo veç që janë mashtrime, por këto janë insinuata të ulëta, të cilat dëshirojnë ta zhvendosin vëmendjen e opinionit prej asaj çka është e vërteta dhe thelbi i problemit që e kemi këtu. Thelbi i problemit është një pjesë e qytetarëve të Kosovës e kanë akuzuar ministrin për krime lufte, kaq.

Hajde tash, po e zëmë si të vërtetë gënjeshtërën e Shkumbinit. Domethënë, gënjeshtërën e Shkumbinit tash po e marrim variantin tjetër, sikur të ishte e vërtetë. Zotëri i nderuar, a më e rëndësishme qenka që Rikalo paska qenë shok i Albinut, apo që është ministër i Qeverisë së Kosovës i akuzuar për krime lufte? Këtë po dua të di. Tash, shikoni tash, sa interesant, jo nuk

është problemi që ministri i Republikës së Kosovës është i akuzuar për krime lufte, problemi i vërtetë që ai para 15 vjetëve ka qenë shok i Albin Kurtit, ky është problemi i vërtetë i Kosovës. Shihe ti, shiko, po interesant! Jo që tash e kemi të ulur aty, shiko ku është i ulur, është ministër i Republikës së Kosovës, por që para 15 vjetëve, më duket që në një konferencë diku ia ka pas dhënë dorën Albin Kurtit! E kjo është më e rëndësishme e më problematike për Republikën e Kosovës. Shiko në ç' gjendje keni ardhur!

KRYESUESI: Në secilin variant Konventa e Gjenevës e vitit '49 e shpjegon shumë mirë çka është krim lufte dhe në qoftë se dikush e ka shkelur Konventën mbi krimet e luftës të vitit '49 të Gjenevës, do të japë llogari o sot, o nesër, kështu që s'kemi nevojë të ngutemi fort. Kur thuhet t'i kemi institucionet në Kosovë, duhet t'i mbrojmë, duhet t'u japim punë, besa, edhe atyre, jo veç vetit. Tash fjalën e ka? Lëvizja "Vetëvendosje", kush e do? Rexhep Selimi, i keni 11 minuta.

REXHEP SELIMI: Atëherë, po mendoj që vetëm sot çka u fol këtu do të ishte e mjaftueshme që zoti Haradinaj ta merrte një vendim shumë të rëndësishëm, të cilin, dorën në zemër, unë e pres. Nuk e di pse, por e kam njëfarë besimi që Ramushi do ta shkarkojë Rikalon.

Nuk e di pse e kam, sepse nuk besoj që do të vazhdojë edhe më tutje të bashkëqeverisë me një person... Unë nuk e di, e kam njëfarë besimi që s'ka për të duruar Ramushi më, por po mendoj që prej 2015 deri më 2017 i kemi dy raste që ndoshta kanë protagonistë që vijnë prej të njëjtit subjekt politik, por nuk e kanë, si të thuash, peshën e njëjtë, e në këtë rast shumë më e rëndë është pesha që bie mbi Rikalon se sa mbi Jablanoviçin, të cilin nuk po dua as ta shfaqë tash. Por, unë besoj që, thashë besoj që do ta shkarkojë, sepse pres shkarkimin e Rikalos edhe sikur asgjë të mos ishte folur deri sot.

Por, sido që të jetë, ndoshta qeveria nuk na beson neve, ndoshta edhe mund të mos u besojë deputetëve, por në mes të Rikalos dhe qytetarëve shqiptarë të Dardanisë duhet t'u besojë qytetarëve, të cilët po ofrojnë dëshmi të pakontestueshme. Normalisht që ne s'po kërkojmë nga askush që t'ia bëjë gjyqin Rikalos këtu në Parlament, por kërkojmë që gjyqi Rikalos t'i bëhet në gjykatore atje, në Pallatin e Drejtësisë. Normalisht që nuk e kisha pritur që as avokatin t'ia bëjmë këtu, por zoti Haradinaj, miku im i shtrenjtë, tha që unë nuk mund të jem gjykatës, por besoj që ai do të duhej të ishte kryeministër, sepse mandati i tij ia lejon, kompetencat e tij ia lejojnë, fuqia dhe forca e tij ia mundëson që të shkarkojë një ministër. Aq më tepër nëse me subjektin e tij nuk paska marrëveshje tjetër përveç asaj që është thënë këtu në Parlamentin e Kosovës, përveç betimit të tij. Atëherë, e paska shumë lehtë, unë nuk e kuptoj insistimin që të mbrohet zoti Rikalo, e aq më tepër insistimin që të pastrohet zoti Rikalo këtu para Parlamentit të Kosovës.

Unë normalisht që votën time nuk e kam bashkuar me deputetët që e kanë votuar zotin Haradinaj për kryeministër, respektivisht Qeverinë e Kosovës. Unë votën time në këtë rast nuk e kam bashkuar as me Listën serbe, por një gjë po ju premtoj, unë nuk do ta bashkoj votën time me

Listën serbe as kur këta ta kërkojnë shkarkimin e Haradinajt. Unë nuk do të bëhem bashkë me ta as këta kur t'ia kërkojnë zotit Haradinaj së paku ta shkarkojnë. Prapë, do t'i dal në krah zotit Haradinaj, por jo përballë Parlamentit të Kosovës, jo përballë qytetarëve të Kosovës, po përballë Serbisë.

Kjo qeveri po duket që ka një bazë të gjerë, por një të ardhme të shkurtër, për shkak se, ndoshta baza e gjerë janë subjektet politike që janë në të, por e ardhmja është shumë e shkurtër për shkak se është e varur mbi ata që nuk e duan as Haradinajn, as Kosovën, as Parlamentin e as institucionet e Kosovës siç është Lista serbe. Më lejoni që edhe njëherë të sjell në kujtimet tuaja deklaratën e Vuçiqit, kur pati thënë që Lista serbe ndërmjet dy të këqijave është dashur ta zgjedhë Haradinajn, e jo Kurtin. Ju kujtohet besoj kjo. Të dyve na panë të këqij, por në fund e zgjodhi Haradinaj, ose Listës serbe ia preferoi ta mbështesë Qeverinë Haradinaj, e jo Qeverinë Kurti. E, sot unë po i them Haradinajt, bëje ti një zgjidhje tjetër ndërmjet këtij dhe neve, po zgjidhna neve mor burrë, se ne jemi miqtë tuaj, e jo Lista serbe.

KRYESUESI: A është thirrje për të hyrë në koalicion, Rexhë, a qysh është? Zoti Selimi po i kërkon 30 sekonda.

REXHEP SELIMI: Dëgjova që the, a është kjo një kërkesë për koalicion. Jo! Kjo është një kërkesë që Qeveria e Kosovës të jetë në anën e interesave të Kosovës dhe të jetë faqebardhë përballë opozitës, jo koalicion. Kështu është. Kaq!

KRYESUESI: Veç, s'bëre kurrfarë replike! Fjalën e ka Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot s'e kam pasur ndërmend të diskutoj për këtë interpelancë, po ju them shumë sinqerisht, pikërisht pse ministri është i minoritetit serb e kam pasur pak problem të diskutoj. Po, që në fillim po dua të them, kushdo prej nesh këtu i papërgjegjshëm, që pretendon të bëjë gjueti të shtrigave, qoftë ndaj njëri-tjetrit, e më shumë ndaj minoritetit serb, është e papranueshme. Por, debati deri tash mua më detyroi t'i them disa fjalë e t'i pyes kolegët e mi, sidomos ata që kanë dy mandate e më shumë, se disa të rinjve që kanë ardhur e flasin u falet, se ndoshta mësohen ndër kohë, por deputetët që i kanë së paku dy mandate e lëshojnë debatin në këtë nivel, mua më vjen turp.

Çka është kjo hipokrizi? Çka ka nevojë këtu të hyjnë nëna, baba, daja, halla e tezja? Këtu është e qartë. Njëzet e më shumë qytetarë të Republikës së Kosovës kanë dhënë dëshmi, dyshim për ministrin në fjalë. Në procedurë të rregullt, bazuar në Kushtetutën e vendit, është ngritur një interpelancë dhe po kërkohet të shkarkohet ministri derisa organet e drejtësisë të marrin vendim.

Askush nuk guxon të thotë, as s'po thotë, që ministri është apo nuk është fajtor. Por, zoti kryeministër, ju jeni shembulli konkret që kur ka ngritur padi cilado prokurori ti ke qenë i gatshëm edhe prej rolit të kryeministrit të japësh dorëheqje e të shkosh e t'i përgjigjesh drejtësisë, e në fund të dalësh i fajshëm apo i pafajshëm. Kemi pasur kënaqësinë që ke dalë i pafajshëm.

Çka është sot kjo, ky debat, që ne t'i shqetësojmë ata që kanë bërë ankesë e padi, e qytetarët në përgjithësi, me nivelin e debatit që e bëjmë ne sot këtu. Ju, personalisht, si kryeministër. Në qoftë se vërtet ministri është i pafajshëm duhet gjetur fuqinë për të dalë para nesh e të thuash, se ke përgjegjësi institucionale. Edhe ata qytetarë që po të gjykojnë janë tuat, ti do të punosh për ata qytetarë, se lëre më për të gjithë Kosovën. Duhet të dalësh e të thuash, 'po unë tërhiqem', si kryeministri yt, qe tërhequr ky. Edhe secili duhet të mësohet, të bëhet model këtu, të tërhiqet kur të keni akuza ose dyshime. Dil zotëri, thuaj: "Po, po tërhiqem, unë ia jap fjalën drejtësisë, kur ajo të vendosë, unë do të vij prapë këtu", ose ju zoti kryeministër i thoni ministrit tuaj. Por, shaka nuk ka këtu!

Kemi dyshime dhe s'po dua të diskutoj nëse janë të shqiptarëve a të serbëve, sepse ne nuk kemi më frikë prej minoritetit serb, përkundrazi kemi shumë respekt dhe u kemi ofruar shumë më shumë se sa çdo shtet demokratik në Evropë. Edhe një herë po them, nuk ka "gjueti të shtrigave". Unë për vete nuk kisha lejuar, e as s'do të lejoj, por ka dyshime. Drejtësia merret me to.

Ne politikisht kërkojmë sot, zoti ministër, ti këtu para nesh të thuash "unë dorëhiqem", derisa gjykata apo organet e drejtësisë të vendosin për fajësinë apo pafajësinë dhe të na shpëtosh neve shumicën këtu, që e bëjmë hipokritin e demagogun e faqen e zezë, e s'dimë as çka jemi duke thënë. Por, ju lutem juve, zoti kryeministër, edhe një herë po ta përsëris, nuk po ta bëj atë analogjinë që e keni pas bërë në mandatin e kaluar e jeni bërë përrallë duke kërkuar ta shkarkoni ministrin, nuk po e bëj atë, se po bie edhe unë pastaj në nivel të debatit. Por, po kërkoj nga ju që ta jepni shembullin tuaj personal. Ti prej nivelit të kryeministrit ke dhënë dorëheqje. Edhe ai zotëria duhet të shkojë atje. Faleminderit!

KRYESUESI: Bilall Sherifi dhe Enver Hoti kanë kërkuar të flasin. Deputetëve pa grup ua kanë dhënë disa minuta, unë nuk e di... Atëherë, Emilija Rexhepi e ka kërkuar fjalën, meqenëse ajo është pa grup.

EMILIJ REXHEPI: Zahvaljujem se gospodine predsedavajući!

Poštovani kolege poslanici,

Ne želimo da zalazimo u naš pravosudni sistem. Premijer nam je jako dobro objasnio. Ne želimo da zalazimo ni na koji način Srpska lista štiti Nenada Rikala, to je njihova apsolutna stvar. Po meni, svako ko je kriv treba da snosi odgovornost i da bude kažnjen, bez obzira dali je on Srbin,

Albanac, Bošnjak, ili bilo ko drugi, ali se to treba dokazati pa onda odgovarati. Žrtva ne poznaje ni veru, ni naciju, ona je samo žrtva.

Ja ministra za Poljoprivredu znam 25 godina, još iz vremena dok smo igrali košarku. Ja za "Baškimi" iz Prizrena, on za "Signal" iz Prištine. Jako dobro ga znam od perioda od posle rata, od 2002-e do 2006-e godine, kada smo radili u civilnom sektoru i realizovali mnoge multietničke zajedničke projekte, kada niko oda vas Srba nije hteo da uključi severni deo naše zemlje i integraciju kosovskih Srba tamo. Takođe znam ga iz perioda dok je bio i član Centralne izborne komisije. Proveo je dosta dugo vremena i bio je javna ličnost.

Kolege poslanici,

Imamo milion drugih jako bitnih obaveza kao Parlament i posvetimo se njima, jer smo zato dobili poverenje naroda. A pravosudnim organima ostavimo da oni odrade svoj deo posla. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Cili nga ju dy deputetë e doni fjalën? Tash, zgjidhni! Bilall, a do të flasësh? Zoti Sherifi, minutat e deputetëve pa grup. Kanë mbetur 3 minuta e 50 sekonda.

BILALL SHERIFI: Shpresoj të mund të përmblihem për një minutë.

Kolegët nga opozita e ngrehën një hipotezë dhe pastaj morën pjesë secili me fjalën e tyre në funksion të forcimit të asaj hipoteze dhe në fund erdhën me konkluzion.

Pra, konkluzioni nga hipotezat e tyre ishte se ne nuk mund ta shkarkojmë kolegun, ministrin Rikalo, sepse Qeveria varet nga vota e tyre. Pra, e kanë ditur që ne apo kryeministri Haradinaj nuk mund ta shkarkojë, prandaj kanë thirrur mocion.

Tash, unë pyes, nuk po bëj konkluzion, as nuk po shtroj një hipotezë, por po i pyes: A do të thotë kjo, që sikur të kishim pasur vota mjaftueshëm pa Listën serbe ju nuk do ta shtronit fare çështjen "Rikalo" në Parlament? A po i bie kjo që e keni shfrytëzuar tërë këtë situatë, këtë ngjarje, për të bërë fushatë në Parlamentin e Kosovës?

Unë fjalën time në cilësinë e shefit të Grupit të "Nismës", si përfaqësues i Nismës" e thashë. Askush nuk guxon të kërkojë nga njerëzit të heshtin tash, sepse kanë heshtur 17 vjet. Por, kushdo që flet, pse flasim tash? Duhet t'ia lëmë që kjo çështje të zgjidhet nëpërmjet sistemit të drejtësisë. Ajo që po kërkojmë sot është që zoti Haradinaj si kryeministër e ka kryer punën e vet nga momenti kur janë ngrehur dyshimet. Tash e tutje gjithçka që vërtetohet apo nuk vërtetohet nuk është më në duart e Qeverisë, por është në duart e sistemit të drejtësisë. Nëse, do të ishte në duart të Qeverisë do të ishte për t'u shqetësuar, por jo për faktin se është në duart e sistemit të drejtësisë. E ashtu qysh e kemi, të mirë e të keq, të gjithë kemi kontribuar që ta kemi në atë gjendje që është sot.

KRYESUESI: Zoti Ali Lajçi e ka fjalën. Ali, 6 minuta e 23 sekonda i keni.

ALI LAJÇI: Të nderuar deputetë,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Shikoni, nuk do ta kisha trajtuar këtë temë për shkaqe se kemi të bëjmë me motivin thjesht politik, por mbase procedurat dhe Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës e arsyeton një thirrje të tillë të seancës, prandaj ne jemi këtu dhe askush nuk ka të drejtë të thotë se nuk është dashur ta debatojmë këtë, se për këtë s’kemi nevojë të flasim.

Edhe kjo seancë ka karakter politik, ju lutem, sepse gjenocidi, krimet mbi popullin e Kosovës nuk janë bërë krejt edhe për shkaqe penale, juridike e të tjera, por së pari për shkaqe politike, për shkaqe statusore, për shkaqe të një gjenocidi, të cilin faktikisht ajo e ka bërë. Dhe, në këtë rast, ne nuk duam ta fajësojmë një njeri që është këtu para nesh, por ka një vazhdimësi historike, politike, madje edhe te kontingjenteve të cilat gjenden në Republikën e Kosovës si deputetë, që e vazhdojnë programin e Serbisë brenda Kuvendit.

Dhe shikoni këtu, nuk e kemi ndërmend ta bëjmë këtë bisedë për ta rrëzuar Ramush Haradinajn prej pozicionit të kryeministrit. Askush dhe as unë s’do ta lejoja veten në qoftë e është ai mendim, dhe unë s’besoj. Por, ka një mendim pak më shumë, ka një çështje pak më të ndjeshme, ka një sensibilitet më të madh te qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët, ju lutem shumë, ka ndodhur një gjenocid për të cilin edhe komisioni i Republikës së Kosovës nuk ka deponuar të dhëna, nuk i ka hyrë të bëjë grumbullimin e tyre, qofshin të natyrave njerëzore, që ka shumë rëndësi, ekonomike e të tjera, dhe ka heshtur që disa vjet mund të themi. Ne duhet ta themi qartë, duhet përgjegjësia e institucioneve të Republikës së Kosovës, jo vetëm në këtë segment, por në të gjitha, e cila ka munguar gjatë tërë kësaj kohe, prej se e kemi shpallur pavarësinë e Republikës së Kosovës dhe vazhdon të mungojë.

Në këtë rast, unë do të kërkoja që, thjesht, pa ngarkesë, kryeministri është i zgjedhur dhe këta janë dikasterë politike. Ky e ka emërtuar stafin e vet dhe ky një kandidat, një, njërin prej anëtarëve të Qeverisë duhet ta shkarkojë dhe pastaj gjatë procesit gjyqësor në qoftë se nuk do të vërtetohet fajësia, e që lënda sigurisht duhet të punohet prej Prokurorisë, atëherë ta rikthejnë, nuk bëhet kiameti. Madje-madje, jap një propozim që do të ishte shumë më i lehtë sikur ministri të dalë i përgjegjshëm e të japë dorëheqje vetë, derisa të kryhen të gjitha procedurat juridike që ne po thirrremi në to. Prandaj, dy janë këto opsione. Ta shikojmë edhe një përgjegjësi.

Kur ndodhi “Jablanoviqi”, ju lutem, pati një protestë mjaft vullkanike, sepse u prek në thelb identiteti dhe u prekën në thelb qytetarët e Kosovës. Sigurisht se edhe tash preken. Ne nuk jemi për t’u ngutur, sepse edhe ajo ndodh, por atëherë nuk dha dikush përgjegjësi. Përkundër një proteste shumë të madhe, në të cilën diku nja 70-80 policë të cilët u lënduan rëndë, mandej diku

afro 100 protestues dhe madje askush nuk dha përgjegjësi, as kryeministri i asaj kohe. Po të ishim shtet juridik, do të duhej të bëhej kallëzimi penal për dëmtimin e qytetarëve dhe moskryerjen e funksionit në nivel të duhur të kryeministrit.

Prandaj, ju lutem, zoti Haradinaj, pavarësisht konsideratave, ta ruajmë dinjitetin e qytetarëve të Republikës, të mos na prekë dikush në dell dhe në dinjitet. Të shkarkohet një anëtar i Qeverisë, ose të japë vetë dorëheqje, nuk bëhet kiameti, derisa të vërtetohet nëpërmjet organeve të drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Akuzat e banorëve të lagjes “Dardania” janë shumë serioze dhe shumë shqetësuese. Konsideroj se është mirë që sot ne po debatojmë në institucionin më të lartë të këtij vendi, në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

U tha edhe këtu nga shumë deputetë, ne nuk është mirë ndoshta ta politizojmë, por nëse zoti Rikalo ka qenë i përfshirë në ato të bëma, ose akuzat apo deklaratat e qytetarëve të “Dardanisë” konfirmohen nga organet përkatëse si hetuesia, Prokuroria, dhe gjykatat, atëherë ndoshta është më mirë që zoti ministër vetë të kërkojë dorëheqje, që të mos krijojmë këtu situata.

Unë do të kërkoja prej zotit kryeministër që të kërkojë nga organet përkatëse, zoti kryeministër e tha që i ka marrë informatat e duhura në kohën e duhur nga institucionet përkatëse, por edhe sot në këtë kohë kur ne sot po diskutojmë në Parlamentin e Republikës së Kosovës, të kërkojë nga Shërbimi Informativ i Kosovës, nga hetuesia, Policia, Prokuroria, nëse kemi pas dorëzimit të dëshmive të qytetarëve ndonjë argument të ri që kanë iniciuar diçka më shumë organet përkatëse dhe në bazë të tyre t’i marrë edhe veprimet e duhura.

Ne këtu sot ndoshta po i keqpërdorim, se kjo është me të vërtetë shqetësuese, është shumë e ndjeshme, jo vetëm për ne si deputetë, por për të gjithë qytetarët e Kosovës, nëse kanë ndodhur në lagjen “Dardania” veprimet e ministrit në fjalë në kohën e luftës, atëherë atyre normalisht që nuk ua shëron zemrën me shkarkim, por ua shëron zemrën me vendime të Gjykatës edhe që ta secili ta marrë për veprën e vet dënimin e merituar. Por, nuk është mirë tash kur ne e dimë që jemi në fushata të zgjedhjeve lokale, është mirë që ata që duan të merren me zgjedhje lokale të shkojnë atje në komunat përkatëse dhe t’i shpalosin platformat e veta, e jo ta keqpërdorim Parlamentin sot për një gjë të tillë, se është shumë e ndjeshme që të përdoret për vota.

Ne e dimë kush ka bërë krime në Kosovë, ka bërë Serbia, dhe ne normalisht që duhet ta akuzojmë Serbinë dhe njerëzit përgjegjës se kanë qenë edhe aparat shtetëror, po edhe personat përkatës. Pushtetet janë të ndara. Ne duhet ta kemi të qartë që kemi tri pushtete në këtë vend. Të mos i përsëris, e kemi edhe Legjislativin, edhe Ekzekutivin, edhe Gjyqësorin. Secili e kryen punën e vet dhe nuk ka interferim që kryeministri mund, përveç mekanizmave që mund ta bëjë shkarkimin, po edhe mund të kërkojë që me urgjencë t'i jepen informata shitesë po qe se ka.

Unë e kam një pyetje, tash po shoh unë shumë këtu, ndoshta edhe patriotë të vonuar, por ndoshta edhe s'janë të vonuar, është çështje e tyre, por e kam një pyetje në këtë rast për zotin Konjufca. Nëse dëshiron të përgjigjet, pyetja është: Në bazë të deklarimeve që i ka bërë zoti Rikalo, paraprakisht ka thënë që 'unë kam punuar', edhe ju thatë të gjithë këtu që ka punuar në institucione të ndryshme, në organizata të ndryshme, në OJQ të ndryshme, ka punuar në KQZ dhe ka punuar në institucionet e Republikës së Kosovës. Por, në të njëjtën kohë, në vitin 2002, zoti Rikalo deklaroi, edhe të tjerët deklarojnë, që ka qenë në OJQ-në KAN, aty ku kanë qenë edhe dy udhëheqës apo anëtarë të Lëvizjes "Vetëvendosje", zoti Kurti dhe Ahmeti.

Është mirë që nëse këta e kanë ditur edhe atëherë që ky ka bërë të bëma, se këtu flitet për vitin 2002, e lufta ka qenë në '98-ën, atëherë pse nuk i kanë deklaruar këto, por të na humbin kohë neve tash 17 vjet më vonë, por të deklarojnë që "një njeri që punon në OJQ-në KAN, e ne e kemi bashkëpunëtor, është kriminel i luftës, i ka maltretuar njerëzit atje", dhe të shkojnë te organet përkatëse, por tash 17 më vonë kur po u duhet një gjë e tillë po e kërkojnë.

Asnjë deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk e pashë që sot e mori në mbrojtje Rikalon, as kryeministri Haradinaj. Ne po e themi të gjithë të njëjtën këtu, por po e themi në nuanca të ndryshme dhe në forma të ndryshme. Po duam t'i vërtetojmë këto deklarata të qytetarëve të "Dardanisë", të cilat për mua janë shumë serioze, edhe një herë po e përsëris, dhe shumë shqetësuese.

Andaj, këtë mund, jo Parlamenti se s'jemi në Prokurori, as gjykatë nuk jemi, as AKI nuk jemi ne, ne kemi instrumente që e kontrollojmë Qeverinë për punën e vet, e kontrollojmë zbatueshmërinë e ligjeve, por të njëjtën kohë mendoj që kryeministri me urgjencë duhet t'i marrë veprimet e duhura në harmonizim me ligjin, por jo për dëshira politike të individëve të caktuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Simiq e ka fjalën.

IGOR SIMIĆ: Poštovani,

Najnoviji i neosnovani napadi na ministra Nenada Rikala imaju samo jedan cilj, a to je napad na Vladu, koja je formirana pre mesec dana. Na žalost, za svrhu ima sticanje jevtinih političkih poena kojima pribegava opozicija uoči predstojećih lokalnih izbora.

Nije ovde reč o gospodinu Rikalu, čija je biografija besprekorna u čemu se slažu i Srbi i Albanci, već o pokušaju destabilizacije Vlade koja želi da rešava probleme na Kosovu. Podsetiću vas, ovaj napad bez osnova, hteli to vi ili ne, stvara atmosferu linča usled koje neko želi da profitira ne shvatajući da na taj način urušava među etničke odnose u ovom društvu.

Ovo je moj prvi mandat u Skupštini, i sada shvatam zašto je ovo društvo tu gde jeste. Pojedine kolege su u toku jučerašnjeg dana više pomenule Srpsku listu nego program vlade koji je bio na raspravi. Ja razumem kolege iz opozicije koji žele da iskoriste skupštinsku govornicu za svoju kampanju, ali zahtevam da to ne činite tako što ćete napadati Srpsku listu i srpske...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hvala! Tash Liburn Aliu, e ke 1 minutë e gjysmë.

LIBURN ALIU: Unë jam prej lagjes “Ulpiana”, afër lagjes “Dardania”. Kam dashur të flas pak më gjatë, por më mbet kohë e shkurtër. Dua vetëm ta përmend që vitet e ‘90-ta kanë qenë vite jashtëzakonisht të tmerrshme për këto dy lagje, duke pasur parasysh përndjekjen e nxënësve të shkollave dhe të rinjve, që është bërë nëpër ato lagje.

Është në kujtesën e secilit banor të lagjes edhe ‘99-ta, po edhe vitet e ‘90-ta në përgjithësi, kur të rinjtë shqiptarë janë rrahur nga grupe të ndryshme, sidomos nxënësit e shkollave. Ky debat, unë mendoj që zotit Haradinaj ia lehtëson punën për shkarkimin e zotit Rikalo. Prandaj, le të shfrytëzohet ky debat për ta shkarkuar zotin Rikalo, sepse mendoj që është më e mira dhe më e duhura për Kosovën, për vendin tonë sot.

Atë që po ashtu desha ta them është, “... ka qenë Rikalo figurë publike deri tash”. Nuk ka qenë ndonjë figurë publike, tash u pa, tash u pa Rikalo. Dhe, unë mendoj që po ashtu për zotin Rikalo nuk besoj që institucionet e sigurisë së Kosovës nuk kanë asnjë informacion. Unë madje mendoj që shumë shpejt do të dalin edhe informacione tjera dhe kjo do t’i kushtojë zotit Haradinaj. Pse të mos e shkarkojë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Konsideroj që deputetët e kanë dhënë verdiktin e tyre. Tani e drejta e kryeministrit është për ta bërë një ekspozitë të vetin, në qoftë se dëshiron, mbi bazën e diskutimeve dhe qëndrimeve të Qeverisë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Ishte një diskutim i gjatë dhe besoj se secili prej jush i keni dhënë pikëpamjet tuaja. Nuk janë pikëpamje që s’i kemi dëgjuar të gjithë, besoj se i kanë dëgjuar edhe qytetarët, edhe ne.

Unë në ekspozenë time ditën e parë kur fola e pata një fjalë dhe në fund thashë që s'kam fjalë tjetër. Unë në respektim të seancës e dhashë një mendim në fillim të seancës. Nuk kam fjalë tjetër. Ju falënderoj për krejt çka dëgjuam sot.

KRYESUESI: Zoti Hoti, e keni fjalën si propozues i interpelancës. Pesë minuta i keni kohë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë i falënderoj deputetët për opinionet që dhanë. Një numër i tyre dolën komplet jashtë teme.

Ju garantoj një gjë, që ka plot tema të cilat Lidhja Demokratike mund t'i ngrejë këtu për qëllime për të arritur objektiva politike, por jo për këtë temë. Unë edhe një herë po them, ministri Rikalo është i pafajshëm derisa nuk vërtetohen akuzat ndaj tij, por nëse ka një deklaram publik për një ministër të Qeverisë, që i ka shkelur edhe rregullat e komunikacionit, kryeministri duhet të merret seriozisht sesi të veprohet, e lëre më për akuza publike për maltretime të qytetarëve gjatë vitit '98-'99.

Unë i ftoj deputetët e opozitës dhe të pozitës, disa prej deputetëve të pozitës u shprehën në favor të mocionit, të cilin e kemi paraqitur si Lidhje Demokratike, që ta votojmë këtë mocion për shkarkimin e ministrit Rikalo dhe t'i ftojmë institucionet e rendit që në përputhje me Ligjin dhe Kushtetutën ta kryejnë detyrën e tyre dhe të zbardhet sa më parë çështja për ministrin Rikalo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, në sallë janë 78 deputetë. Do të futemi për t'i votuar propozimet ose rekomandimet e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike. Ju lus që t'i zini vendet!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në bazë të nenit 44, pika 4, të Rregullores së Kuvendit ka propozuar për miratim tekstin e mocionit prej dy pikash. Kërkohet deklarimi me votim për miratimin e tekstit të mocionit të propozuar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tani!

Faleminderit! Është kryer votimi me elektronikë, kërkoj që deputetët që s'ishin në sallë, e që u futën tash, t'i numëroj sa janë. A të "Vetëvendosjes"? Janë... s'prish punë.

Regjia, përsërite edhe një herë...! Kanë votuar 67 deputetë, plus Aida pa kartelë, 67. Për kanë votuar 26 deputetë, plus Aida pa kartelë, që bëjnë 27 deputetë. Kundër kanë votuar 40 deputetë dhe një ka abstenuar.

Konstatohet se Kuvendi nuk e miratoi tekstin e mocionit të propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në lidhje me akuzat publike të shfaqura ndaj ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance dhe fillojmë seancën e re. Mirupafshim!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë